



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Histori”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.asoc.dr. Selim Bezeraj

Prof.asoc.dr. Alba Osman

Tetor/2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Histori” ofruar nga Universiteti i Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Historisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Histori”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.1225, Datë 03.09.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.183, datë 14.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike /4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (Shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	PAE/PAK V.a 2023-2024:10 PAE /6 PAK V.a 2022-2023:11 PAE /4 PAK V.a 2021-2022: 12 PAE/ 4 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2023-2024: 15 studentë V.a 2022-2023: 6 studentë V.a 2021-2022: 13 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Histori” ofrohet nga Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës. Programi është hapur me VKM Nr. 1225, datë 03.09.2008, dhe është i nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ai zhvillohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, për një periudhë dyvjeçare (4 semestra) dhe realizohet me 120 kredite ECTS.

Ky program synon të përgatisë specialistë të fushës së historisë përmes një qasjeje ndërdisiplinore që kombinon teorinë me praktikën. Kurrikula përfshin lëndë të formimit të përgjithshëm, karakterizues dhe plotësues, duke ofruar njohuri të avancuara për të analizuar, krahasuar dhe argumentuar të dhënat në fushën e studimeve historike. Programi synon të zhvillojë kompetenca specifike të lëndës, si dhe kompetenca për jetën njëkohësisht, duke i aftësuar studentët për të operuar në fushën e studimeve të historisë së Shqipërisë dhe me gjerë. Përmes praktikave të integruara me institucione të ndryshme, studentët fitojnë përvojë konkrete pune dhe aplikojnë njohuritë e marra gjatë studimeve.

Të diplomuarit e këtij programi mund të angazhohen në pozicione si historianë, kërkues të rinj, diplomatë etj. Gjithashtu, ata kanë mundësi të vijojnë studimet në nivel doktorature, duke u specializuar më tej në studime historike, të shkencave politike, albanologjike etj.

Aktualisht, programi po i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar përmbushjen e standardeve akademike dhe përputhshmërinë me kërkesat bashkëkohore të tregut të punës.

Handwritten signature in blue ink, with a circular stamp containing the number 3 below it.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacione të mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof.asoc.dr. Selim Bezeraj, dhe Prof.as.dr. Alba Osmani. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga koordinatori teknik e ASCAL Msc Alma Arapi.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë kësaj vizite, të zhvilluar në datat 3 dhe 4 Prill 2025 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të konsoliduar të Masterit të Shkencave në “Histori”, si edhe ofron sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për arritje të mëtejshme profesionale, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të profesionistëve.

GVJ vlerëson se programi Master i Shkencave në “Histori” ofrohet me një nivel të mirë cilësie dhe pasqyron përkushtimin e institucionit për të ndërtuar një program të qëndrueshëm dhe të krahasueshëm me praktikën më të mira ndërkombëtare. Grupi thekson disa arritje të rëndësishme të institucionit dhe ofron disa rekomandime që synojnë përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së programit, për të formuar profesionistë të nivelit të lartë.

Universiteti i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 22.09.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 129 / 22 Prot, datë 22.09.2025. Universiteti i Tiranës, njofton në ASCAL më datë 07.10.2025, Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku



shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Histori”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi Master i Shkencave në “Histori” ofrohet nga Universiteti i Tiranës (më tej UT), një institucion publik i arsimit të lartë që garanton programe në të tre ciklet e studimit. Kjo qasje gjithëpërfshirëse i mundëson studentëve të zhvillojnë kompetenca të gjera, në përputhje me interesat kombëtare, duke reflektuar një angazhim të qartë institucional në zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në funksion të lirisë së ideve, ndërtimit të një shoqërie demokratike dhe forcimit të shtetit të së drejtës. Këto parime udhëheqëse janë të përcaktuara në mënyrë të qartë në Statutin e Universitetit të Tiranës (2018), përkatësisht në Nenin 4 (Vizioni) dhe Nenin 8, pika 2 (Zhvillimi i veprimtarisë). Në përputhje me këtë frymë institucionale, programi i studimit në fjalë mbështet misionin e Universitetit të Tiranës për të qenë një model i arsimit të lartë publik në vend, i bazuar në traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të kombit, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të avancuara ndërkombëtare, veçanërisht ato europiane. Universiteti i Tiranës, sipas Strategjisë së tij të Zhvillimit 2018–2023 dhe 2023–2028, synon të mbetet një institucion lider në përgatitjen akademike rigoroze dhe në kërkimin shkencor, duke qenë zgjedhja e parë për studentët që dëshirojnë të transformojnë jetën e tyre dhe të kontribuojnë në shoqëri. Në këtë kuadër, Departamenti i Historisë luan një rol thelbësor, duke ofruar programe me profil kombëtar që reflektojnë një përkushtim të qëndrueshëm ndaj historisë dhe kulturës shqiptare. Ky përkushtim manifestohet përmes një sërë studimesh historike, artikujsh shkencorë dhe punimesh monografike të botuara nga pedagogët e departamentit, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kombëtare.

	Programi Master i Shkencave në “Histori” është ndërtuar në përputhje të plotë me kornizat ligjore dhe strategjike të institucionit, si dhe me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, e cila thekson rëndësinë e edukimit mbi qytetarinë aktive dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në një kontekst modern. Përmbajtja ndërdisiplinore e programit dhe qasja e tij akademike kontribuojnë në zhvillimin profesional të studentëve, duke siguruar përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me standardet kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë. Struktura e programit reflekton një ekuilibër mes njohurive teorike dhe aftësive praktike, duke e bërë atë një shembull të qasjes institucionale ndaj promovimit të identitetit kombëtar dhe zhvillimit të vlerave akademike. <i>Shtojca 1.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023, 2023-2028)</i> <i>Shtojca I.I Statuti i Universitetit të Tiranës 2018, neni 4: Vizioni, neni 8. Pika 2: Zhvillimi i veprimtarisë.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi Master i Shkencave në “Histori” (më tej MSH-H), i ofruar nga Departamenti i Historisë në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë (më tej FHF) të UT, është konceptuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat strategjike të institucionit. UT ofron programe studimi në përputhje me nivelet 6–8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë përmes tri shtyllave kryesore të arsimit të lartë publik: mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimit ndaj komunitetit, të cilat bashkëveprojnë dhe e pasurojnë njëra-tjetrën në mënyrë të vazhdueshme. Departamenti i Historisë, në harmoni me misionin institucional, zhvillon veprimtarinë e tij akademike duke ofruar gjithashtu programe studimi në të tre ciklet e arsimit të lartë, të ndërtuara sipas niveleve të përcaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe sipas strukturës zyrtare të miratuar për programet e cikleve të I–III. Në këtë kuadër, programi Master i Shkencave në “Histori” synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të analizuar dhe interpretuar zhvillimet historike në një këndvështrim të thelluar teorik dhe metodologjik, si dhe për të kontribuar në trajtimin e temave me natyrë rajonale dhe globale.

	Programi zhvillohet në përputhje me Rregulloren e programit të studimit dhe bazohet në mësimdhënie cilësore dhe kurrikula bashkëkohore, duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm në shoqëri, reformimin e shoqërisë dhe shtetit shqiptar, si dhe në objektivat institucionale për formimin e profesionistëve të angazhuar dhe të përgjegjshëm. Shtojcat 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 5: Misioni. Link: Struktura e programeve të studimit të FHF për të tre ciklet e studimit, https://drive.google.com/file/d/1-OAc3hjmymmCX2eyh64exi0jQYvPKCWx/view Shtojca 2. 3 Rregullore e programit të studimit]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	Referuar dokumenteve strategjike të UT, si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë të studimeve MSH-H është konceptuar dhe riorganizuar në funksion të harmonizimit me misionin, vizionin dhe objektivat afatgjata të institucionit. Një qasje e tillë është reflektuar në përmbajtjen akademike të programit, në strukturën e tij kurrikulare dhe në qasjen shumëdimensionale që i jepet zhvillimit të kompetencave profesionale dhe kërkimore të studentëve. Departamenti ka një vizion të qartë për zhvillimin afatgjatë të studimeve në fushën e shkencave humane dhe historike, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018–2023 dhe 2023–2028. Ky vizion mbështetet gjithashtu në Statutin dhe Rregulloren e UT, të cilat përcaktojnë objektivat strategjike për zhvillimin akademik dhe konsolidimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve. Programi i studimit është përshtatur me drejtimet akademike të Departamentit të Historisë në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë. Emërtimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë ndërtuar në funksion të fushave të studimit dhe orientimeve kërkimore të këtij departamenti, në përputhje me prioritetet institucionale për zhvillimin e arsimit të lartë publik, kërkimin shkencor dhe angazhimin akademik. Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Historisë, si dhe Strategjia e zhvillimit të programit MSH-H janë ndërtuar mbi shtyllat e zhvillimit të kurrikulave bashkëkohore, ndërkombëtarizimin, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe përputhjen me kërkesat e tregut të punës, duke përmbushur

	kështu kriteret e përafrimit të programit me orientimet institucionale dhe zhvillimin e qëndrueshëm të njësisë bazë. Programi respekton gjithashtu kërkesat e përcaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe garanton përgatitjen e studentëve me njohuri dhe aftësi të avancuara për analizën dhe interpretimin e fenomeneve historike, me aplikim të teorive dhe metodave bashkëkohore në shkencat historike. Ai përmbush objektivat për formimin akademik, por gjithashtu siguron një lidhje funksionale me nevojat reale të shoqërisë dhe sfidat e kohës, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës (2018)</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit të Tiranës (2022)</i> <i>Shtojca 1.3 Strategjia e Zhvillimit e Universitetit të Tiranës (2018–2023; 2023–2028)</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.4 Strategjia e zhvillimit e programit “Master Shkencor në Histori”</i>
Krteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Referuar dokumentacionit zyrtar të Universitetit të Tiranës dhe strategjive përkatëse të zhvillimit, konstatohet se programi i ciklit të dytë MSH-H është hartuar dhe ofrohet në përputhje me nevojat për thellim të studimeve akademike dhe kërkimore në fushën e historisë, duke u orientuar drejt përgatitjes së studentëve për nivelin e tretë të studimeve – doktoraturën – si dhe për angazhim profesional në institucione kërkimore dhe publike me profil historik dhe kulturor. Programi është ndërtuar duke pasur parasysh modelet bashkëkohore të ofruara nga universitete të njohura perëndimore dhe është në harmoni me strategjitë kombëtare për zhvillim dhe integrim, si dhe me prirjet globale për edukim cilësor dhe përgatitje të specialistëve të fushave të shkencave humane. Ai synon të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të kapaciteteve njerëzore dhe të formojë profesionistë që mund të kontribuojnë në konsolidimin e institucioneve kërkimore, akademike dhe shtetërore. GVJ konstaton se programi përputhet me prioritetet akademike të Departamentit të Historisë pranë FHF dhe zhvillohet në linjë me objektivat strategjike të institucionit për nxitjen e kërkimit shkencor, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përfshirjen e studentëve në praktika dhe projekte konkrete.

	Profili i diplomantëve të këtij programi është ai i studiuesit të kualifikuar në fushën e studimeve historike, i aftë për të punuar në institucione si Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Instituti për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, Autoriteti për Informimin mbi Dosjet e Sigurimit të Shtetit, Arkivi Qendror i Shtetit, si dhe në struktura të administratës publike, organizata ndërkombëtare dhe institucione të shoqërisë civile. Programi është konceptuar në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, në nivelin 7, dhe ofrohet si një program dyvjeçar me 120 kredite ECTS. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion, ky program paraqitet të jetë një mundësi reale për formim të vazhdueshëm në kuadër të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe synon të ofrojë një platformë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm akademik dhe shkencor të individëve në shkencat historike. <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit të Tiranës (2022)</i> <i>Shtojca 1.3 Strategjia e Zhvillimit e Universitetit të Tiranës (2023–2028)</i> <i>Shtojca 2.1 Vendimi Nr. 44 i Senatit Akademik për hapjen e programit, datë 18.10.2010</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullorja e brendshme e Departamentit të Historisë</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.4 Strategjia e Zhvillimit e Programit “Master Shkencor në Histori” (2020–2024)</i>
Konkluzione	GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, konfirmon se Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Historisë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Programi i studimit Master i Shkencave në “Histori” synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare dhe është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit. Programi i studimit është riorganizuar për t’ju përshtatur më mirë nevojave të tregut të punës, akteve rregullatore dhe planit të zhvillimit të UT. Programi është në harmoni me interesat kombëtare të vendit, duke kontribuar në formësimin e specialistëve të fushës, të aftë të zhvillojnë më tej standardet e

	<i>menaxhimit dhe lidershit në institucionet e vendit dhe më gjerë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësise kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UT, si institucioni i parë i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri, që nga themelimi i tij në vitin 1957, ka ndërtuar një traditë të konsoliduar akademike dhe kërkimore, mbështetur në standardet më të avancuara vendase dhe ndërkombëtare, Në përputhje me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit 2023–2028, institucioni është angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të tij njerëzore dhe infrastrukturore, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm akademik dhe profesional për studentët dhe stafin. GVJ konstaton se Departamenti i Historisë, demonstroi qartësisht kapacitete të plota për ofrimin e programit MSH-H. Departamenti i Historisë për tri vitet akademike ka në përbërjen e tij: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/Grada</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.dr</td><td>4</td><td>2</td><td>3</td><td>2</td><td>4</td><td>4</td></tr><tr><td>Prof.Asc.Dr</td><td>4</td><td></td><td>4</td><td>-</td><td>3</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr/Doc</td><td>4</td><td>2</td><td>4</td><td>2</td><td>3</td><td>1</td></tr><tr><td>Msc</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>Totali</td><td>12</td><td>4</td><td>11</td><td>4</td><td>10</td><td>6</td></tr></table> Përveç personelit bazë, në zbatim të standardeve të përcaktuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, Departamenti bashkëpunon edhe me staf efektiv të njësive të tjera të Universitetit të Tiranës, duke siguruar një ndërthurje të ekspertizave në veprimtari formuese ndërdisiplinare dhe të	Tituj/Grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.dr	4	2	3	2	4	4	Prof.Asc.Dr	4		4	-	3	1	Dr/Doc	4	2	4	2	3	1	Msc							Totali	12	4	11	4	10	6
Tituj/Grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.dr	4	2	3	2	4	4																																											
Prof.Asc.Dr	4		4	-	3	1																																											
Dr/Doc	4	2	4	2	3	1																																											
Msc																																																	
Totali	12	4	11	4	10	6																																											

	përgjithshme. Departamenti respekton kufizimet ligjore në raport me personelin e ftuar, duke mos e tejkaluar përqindjen maksimale të lejuar (30%). Përvoja e gjatë akademike dhe angazhimi i stafit në kualifikime të vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit dëshmojnë për kapacitetet e plota të këtij departamenti për realizimin e suksesshëm të programit të studimit Master i Shkencave në "Histori". Në përmbledhje, GVJ kontaton se UT dhe Departamenti i Historisë përmbushin plotësisht kriterin e kërkuara, duke ofruar përvojë të konsoliduar, staf të kualifikuar dhe burime të përshtatshme për zhvillimin dhe përmbushjen e objektivave të programit MSH-H. <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës 2018</i> <i>Shtojca 1.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2023-2028</i> <i>Shtojca 2.31 Tablea RVB (Personel Akademik Efektiv dhe Personel Akademik me Kontratë, titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (Anekset e RVB: tabela 1 dhe 2; 7)</i> <i>Shtojca 2.20 Plani mësimor MSH Histori (Tabela 12 anekset e RVB)</i> <i>Shtojca 2.21 CV të personelit akademik të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstatohet se programi i studimit MSH – H është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit të Historisë, si njësi kryesore përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e këtij programi. Kjo qasje vjen si rezultat i traditës së konsoliduar akademike të departamentit në fushën e shkencave historike, si dhe nga mbështetja në dokumentet strategjike dhe rregulloren e UT. Në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (VKM Nr. 310, datë 11.05.2022), programi i studimit klasifikohet në fushën e shkencave humane, në përputhje të drejtpërdrejtë me profilin akademik të Departamentit të Historisë. Programi është ndërtuar mbi parime të përcaktuara nga kuadri ligjor për arsimin e lartë dhe zhvillohet në përputhje me objektivat strategjike të institucionit për unifikimin e standardeve akademike me ato evropiane, siç përcaktohet edhe në Kartën e Bolonjës. Ai është

	organizuar në një strukturë lëndore që vlerësohet me kredite ECTS dhe është miratuar në çdo nivel institucional përkatës si departament, dekanat, senat, bord administrimi. Trupa akademike me kompetenca të thelluara në fushën e historisë dhe disiplinat e afërta me të, garanton që procesi mësimor dhe kërkimi shkencor të jenë tërësisht në përputhje me misionin dhe fushën akademike të njësisë përgjegjëse. <i>Shtojca 1.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2023-2028</i> <i>Shtojca 2.3. Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Shtojca 2.20 Plan i miratuar mësimor i Programit të Studimit</i> <i>Shtojca 2.4 Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Historisë (2020-2024)</i> <i>Shtojca 4.3. Rregullore e Programit të Studimit</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit MSH – H është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit të Historisë, i cili është njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e tij. Ky departament është i specializuar në fushën e shkencave historike dhe përfaqëson njësinë akademike dhe kërkimore me kompetencë të plotë për mbështetjen shkencore dhe pedagogjike të këtij programi të ciklit të dytë. GVJ konstaton se programi MSH-H përputhet me objektivat e programit, të cilat synojnë pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara në fushën e studimeve të historisë, duke u dhënë atyre aftësi për analizën kritike të fenomeneve historike dhe konteksteve shoqërore, politike dhe kulturore. Programi mbështetet në rregulloren e vetë programit të studimit [2.3], rregulloren e brendshme të Departamentit të Historisë [2.2], dhe planin e miratuar mësimor [2.20], ku përshkruhet qartë përputhja e tij me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. Nëpërmjet lëndëve të ofruara dhe objektivave të tij, programi siguron formim teorik dhe metodologjik në përputhje me standardet akademike dhe kërkimore të fushës së historisë. Në këtë kontekst, fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit janë tërësisht të harmonizuara me profilin akademik të njësisë bazë, duke garantuar cilësi dhe koherencë në përmbajtjen dhe realizimin e tij akademik. <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Programit të Studimit</i>

	<i>Shtojca 2.2 Rregullore e brendshme e Departamentit të Historisë</i> <i>Shtojca 2.20 Plani i miratuar mësimor i Programit të Studimit</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	NA
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Mbështetur në të dhënat e marra nga RVB, dokumentat e dorëzuara në ASCAL si dhe takimet e realizuara në institucion, programi i studimit MSh-H zhvillohet në përputhje me profilin akademik dhe profesional të FHF dhe Departamentit të Historisë. Në mbështetje të zhvillimit profesional të studentëve të diplomuar dhe në funksion të krijimit të urave të qëndrueshme ndërmjet arsimit dhe tregut të punës, Departamenti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh publike dhe kërkimore si Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK), Muzeu Kombëtar “Shtëpia me Gjethe”, Drejtoria e Përgjithshme të Arkivave, Bashkia e Tiranës etj. Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve synohet përfshirja aktive e studentëve në praktika dhe projekte profesionale që lidhen ngushtë me përmbajtjen e programit të studimit, duke u krijuar atyre mundësi konkrete për aplikimin e njohurive teorike në mjedise pune reale. Për më tepër, UT ka ngritur Qendrën Virtuale të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional dhe Akademik, përmes së cilës ofrohen në mënyrë të vazhdueshme mundësi për trajnime pasuniversitare dhe përforcim të mëtejshëm të kompetencave të të diplomuarve. Këto iniciativa kontribuojnë në rritjen e përgatitjes së studentëve për të përballuar kërkesat e tregut të punës, në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026 dhe kërkesat e këtij kriteri. <i>Shtojca 2.31 Tabela e RVB/ Seksioni 3 I marrëveshjeve të FHF-së</i> <i>Link: <u>Qendër Virtuale e zhvillimit profesional dhe trajnimit - UNIVERSITETI I TIRANËS</u></i>

Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve të mësipërme, vlerësojmë se programi MSH-H është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe asaj bazë, duke reflektuar një përputhje të mirë midis fushës së studimit dhe ekspertizës së stafit akademik. Institucioni demonstroi përvojë të konsoliduar dhe burime të përshtatshme akademike, ndërsa programi është strukturuar në përputhje me praktikën kombëtare dhe evropiane. Gjithashtu, përfshirja e mekanizmave të trajnimit dhe bashkëpunimit me punëdhënësit për studentët e diplomuar është një aspekt pozitiv që forcon lidhjen e programit me tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkit të shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UT dhe FHF tregojnë një strukturë të qartë organizative dhe një ndarje të mirëpërcaktuar të përgjegjësi ndërmjet njësive akademike dhe administrative, në funksion të mbarëvajtjes së programit të studimit MSH-H. Departamenti i Historisë, si njësi bazë, është përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e programit, në përputhje me Statutin e UT (2018), Rregulloren e UT-së (2022) dhe rregulloret e brendshme të fakultetit dhe departamentit. Ndarja e detyrave mes personelit akademik dhe administrativ bëhet në fillim të çdo viti akademik, duke u bazuar në planin mësimor të miratuar dhe programet përkatëse të lëndëve. Mekanizmat e brendshëm të bashkëpunimit mes njësive janë të institucionalizuara dhe garantohen përmes strukturave si Senati, Këshilli i Fakultetit dhe grupet përgjegjëse për programet e studimit. Në këtë drejtim, analiza vjetore e punës përfshin edhe raportet individuale të stafit akademik, vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, si dhe rekomandime për përmirësim. Gjithashtu, FHF dhe Departamenti i Historisë përfshijnë një qasje gjithëpërfshirëse në planifikimin strategjik, duke integruar komunitetin akademik dhe studentët në auditore,

	laboratorë, biblioteka dhe aktivitete kërkimore, çka kontribuon në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të programit. <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës 2018</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit të Tiranës, 2022</i> <i>Shtojca 2.17.1 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2021-2022.</i> <i>Shtojca 2.17.2 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2022-2023 Shtojca 2.17.3 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2023-2024 Shtojca 2.10. Politikat e vlerësimit akademik të stafit të mesimdhënis Shtojca 2.10. 1 Raporti i vlerësimit të performancës së personelit akademik.</i> <i>Shtojca 2.20 Plan i mesimor i programit të studimit i lidhur me personelin akademik (Tabela 12 anekset e RVB)</i> <i>Link: Struktura organizative e FHF 2024:</i> <i>https://www.flf.edu.al/organigrami/Struktura_e_programeve_të_studimit_të_FHF_për_të_tre_ciklet_e_studimit</i> <i>https://ëë.fuf.edu.al/?s=cikli+i+studimit</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e brendshme e Departamentit të Historisë</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se UT, përmes strukturave të FHF, dhe të Departamentit të Historisë, dëshmon një angazhim të qëndrueshëm në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve bashkëpunuese me institucione homologe dhe aktorë të rëndësishëm të tregut të punës në funksion të zhvillimit të komponentit mësimor dhe formues të programit të studimit MSH-H. Marrëveshjet e nënshkruara me institucione shtetërore dhe kërkimore si DPA, ISKK, AIDSSH etj, të përmendura edhe në kriteret e mësipërme, janë vendosur jo vetëm për realizimin e praktikave profesionale, por edhe në funksion të aktiviteteve të përbashkëta akademike dhe shkencore, si konferenca, seminare dhe leksione të hapura. Raportet vjetore të Departamentit të Historisë për periudhën 2021–2024 evidentojnë qartësisht rolin e këtyre bashkëpunimeve në realizimin e synimeve akademike të programit. Këto dokumente paraqesin shembuj konkretë të përfshirjes së studentëve në aktivitete kërkimore, shkencore dhe ndërvepruese me institucionet partnere, duke i ekspozuar ata

	ndaj përvojave reale të fushës dhe duke forcuar kapacitetet e tyre profesionale. Aktivitetet që burojnë nga këto marrëveshje shërbejnë si instrumente konkrete për zhvillimin e kompetencave të studentëve dhe për forcimin e lidhjes midis arsimit dhe tregut të punës. <i>Shtojca 2.17.1 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2021-2022</i> <i>Shtojca 2.17.2 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2022-2023</i> <i>Shtojca 2.17.3 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2023-2024</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Në përmbushje të këtij kriteri, Departamenti i Historisë i kushton një vëmendje të veçantë bashkëpunimit me një rrjet të gjerë institucionesh, që shërbejnë si hapësira për realizimin e praktikave profesionale të studentëve dhe për angazhimin e stafit akademik në projekte kërkimore e bashkëpunime shkencore. Departamenti i Historisë vë në dispozicion të studentëve një listë të gjerë institucionesh të arsimit parauniversitar në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u mundësuar atyre të realizojnë praktikën profesionale në përputhje me objektivat e formimit të programit. Këto praktika janë të mbikëqyrura nga punëdhënësit të përcaktuar dhe nga mentorë akademikë, ndërsa studentët përgatitin raporte individuale dhe plotësojnë formularë vlerësimi që dëshmojnë mbi përmbajtjen dhe cilësinë e eksperiencës së fituar. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe raportet vjetore të Departamentit (2021–2024), si dhe nga praktikat e konstatuara nga studnetët, rezulton se bashkëpunimet përfshijnë një gamë të gjerë institucionesh publike dhe jopublike si: si DPA, ISKK, AIDSSH etj. Nga ana tjetër, Departamenti angazhohet në zbatimin e projekteve të bashkëpunimit me institucione përkatëse si “Oral History – Pandemia COVID”, “Digital Humanities”, “History Lab”, shkolla verore, të cilat i ofrojnë studentëve mundësi të drejtpërdrejta për përfshirje në veprimtari kërkimore dhe formuese me vlerë akademike. Në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit dhe qasjet bashkëkohore të integritetit të arsimit të lartë me tregun e punës dhe kërkimin shkencor, bashkëpunimet e nënshkruara dhe aktivizimi i tyre në mënyrë konkrete për realizimin e praktikave

	dhe kërkimeve përfaqësojnë një praktikë të mirë, që ndihmon në përgatitjen gjithëpërfshirëse të studentëve dhe në fuqizimin e kapaciteteve kërkimore të stafit akademik. <i>Shtojca 1.21. Politikat e mbështetjes për studentët</i> <i>Shtojca 2.12. Procedure për mbështetjen, zhvillimin dhe përmirësimin e programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Historisë, si njësi përgjegjëse për realizimin e programit të studimit MSH-H, ka krijuar dhe funksionalizuar një praktikë të rregullt raportimi analitik mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Këto analiza pasqyrohen në raportet vjetore të punës së departamentit (2021–2024), të cilat përbëjnë dokumentacion zyrtar të mbledhur në mënyrë sistematike dhe të orientuar drejt monitorimit të ndikimit të bashkëpunimeve në zhvillimin e programit. Nga takimi me stafin akademik rezultoi se përmes këtyre raporteve, bëhet një vlerësim i kontributit që kanë sjellë partneritetet institucionale në aspekte të ndryshme të formimit akademik, siç janë: praktikat profesionale, përfshirja e studentëve në projekte kërkimore, shkëmbimet akademike, organizimi i aktiviteteve me karakter shkencor. <i>Shtojca 2.17. Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2021-2022, Shtojca 2.17.2 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2022-2023 Shtojca 2.17.3 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2023-2024</i>
Konkluzione	Departamenti i Historisë në UT demonstroi një angazhim të strukturuar dhe efektiv në sigurimin e bashkëpunimeve institucionale, duke garantuar që programi MSH – H mbështetet nga marrëveshje konkrete me institucione akademike dhe kërkimore. Institucioni ka krijuar një rrjet të gjerë partneritësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilat ndihmojnë në realizimin e praktikave profesionale, kërkimin shkencor dhe mobilitetin e stafit dhe studentëve. Për më tepër, mekanizmat e raportimit dhe vlerësimit të përfitimeve nga këto bashkëpunime janë të konsoliduara, duke siguruar përmirësim të vazhdueshëm dhe përputhshmëri me objektivat akademike dhe profesionale të programit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Bazuar në informacionin e ofruar, GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë MSH-H është ndërtuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, konkretisht me nenin 71 pika 2 dhe 3, ku përcaktohet qartë që elementet e programeve të studimit duhet të specifikohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe rregullore të brendshme të institucionit. Për më tepër, në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, programi përfshin të gjitha elementet e kërkuara për strukturën e tij, si më poshtë: • kreditet sipas ECTS, • kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, • objektivat formues dhe kompetencat profesionale, • veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit, • planin mësimor dhe syllabuset, • kuotat dhe grupet mësimore, • diplomën dhe suplementin. Institucioni ka paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit evidenca dokumentare që dëshmojnë se programi përmban të gjithë elementet përbërës të strukturës së kërkuar. Këto elemente janë të vlerësuara në kredite dhe janë ndërtuar në përputhje me Sistemin ECTS, duke respektuar ngarkesën standarde të punës për çdo kredit dhe shpërndarjen në semestra, siç e përcakton ligji shqiptar dhe aktet nënligjore përkatëse.

	<i>Shtojca 2.20 Plani i miratuar mesimor i Programit te Studimit/ Plani mesimor i ndare sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9))/ Ngarkesa totale ne auditor e studenteve per Format e mesimdhenies ne programin e studimit, per secilin program (Tabela 13))/ Formate kontrollit te njohurive (Tabela 15)</i> <i>Shtojca 2.20. I Programet mesimore te lendeve per programin e studimit</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e programit te studimit</i> <i>Shtojca 2.22 Modeli i Diplomes MSH-H</i> <i>Shtojca 2.23 Model suplementi i Diplomes MSH-H</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Referuar të dhënave të paraqitura nga institucioni, si dhe takimeve në institucion, GJV vlerëson se programi MSH-H formon studentët me njohuri të thelluara dhe aftësi të përparura në fushën e studimeve historike, duke ofruar një bazë teorike dhe praktike për studentët që duan të zhvillojnë ose riorientojnë karrierën drejt kërkimit shkencor, mësimdhënies, por edhe në fusha të tjera ku kërkohen aftësi në analizën e ngjarjeve historike. Programi është konceptuar për të zhvilluar të kuptuarit kritik të teorive dhe metodologjive në historinë mesjetare, moderne dhe bashkëkohore, si dhe për të pajisur studentët me kompetenca të avancuara në zgjidhjen e problemeve komplekse në kontekste akademike dhe profesionale. Lëndët e programit ofrojnë dije ndërdisiplinare të integruara me metodologji hulumtimi, detyra kursi dhe praktika mësimore që ndihmojnë në zhvillimin e shprehive analitike dhe kërkimore të studentëve. Një nga elementët më të rëndësishëm të programit, veç metodave të integruara të mësimdhënies është edhe praktika mësimore e detyrueshme, e cila zhvillohet në institucionet me të cilat departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi. Praktika zgjat një muaj dhe vlerësohet me 12 kredite dhe synon përforcimin e aftësive praktike dhe përballjen me problematika reale në fushën e studimeve historike. Për më tepër, studentët inkurajohen të marrin pjesë në veprimtari hulumtuese dhe përfundojnë programin me përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës së diplomës, çka ndihmon në formimin e tyre si profesionistë të aftë për sfida kërkimore dhe

	profesionale të paparashikueshme. Në këtë kuadër, GVJ konstaton se programi adreson në mënyrë të qartë zhvillimin e njohurive dhe kompetencave të avancuara në fushën e studimeve historike, duke kontribuar njëkohësisht në përgatitjen e specialistëve, kërkuesve dhe profesionistëve që mund të punësohen në institucione të ndryshme publike dhe jopublike. <i>Shtojca 2.20 Plani mesimor i miratuar i Programit të Studimit/ Plani mesimor i ndare sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)</i> <i>Shtojca 2.20.1 Programet mesimore të lendeve për programin e studimit</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi MSH-H ka të përcaktuara në mënyrë të qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe për detyrimet përmbyllëse të programit. Plani mesimor i miratuar për programin parashikon 12 kredite për praktikën profesionale, e cila realizohet gjatë semestrit të katërt. Praktika zhvillohet në bashkëpunim me institucione publike me të cilat departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi. Departamenti ka hartuar një rregullore të posaçme, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira në zhvillimin e praktikës mesimore. Gjithashtu, ngarkesa në kredite për detyrimin përmbyllës, përkatësisht punimin dhe mbrojtjen e tezës së diplomës është 18 ECTS, në përputhje të plotë me përcaktimet e VKM nr. 41 (e ndryshuar) për strukturën e programeve të ciklit të dytë të studimeve. Konkreteisht: Lendet bazë (A): 5% - 10 % të totalit të krediteve; Lëndët Krahësuese (B): 50%-60% të totalit të krediteve; Lëndët interdisiplinore/integruese (C): 12%-20% të totalit të krediteve; Lëndët plotësuese (D): 10% të totalit të krediteve; Detyrime përmbyllëse (E): 10-15% të totalit të krediteve. Në këtë kuadër, GVJ konstaton se përmbajtja dhe pesha specifike e krediteve të praktikës dhe e detyrimeve përmbyllëse janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullatat përkatëse, duke siguruar koherencë dhe transparencë në organizimin akademik të programit.

	<i>Shtojca 2.20 Plani mesimor i miratuar Programit te Studimit/ Plani mesimor i ndare sipas Veprimtarive Forrnuese (A-E) (Tabela 9)</i> <i>Shtojca 2.20. I Programet mesimore të lëndëve per programin e studimit</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e programit te studimit</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	NA
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	NA
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit	UT nuk është një institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.



të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bazuar në informacionin e paraqitur nga institucioni, konstatohet se programi i studimit MSH-H është një program unik brenda programeve të ofruara nga UT. dhe nuk ka një ekuivalent tjetër me të njëjtën emërtesë dhe përmbajtje në institucionin ofrues. Referuar strukturës dhe përmbajtjes akademike për programin MSH-H ka IAL të tjerë në Republikën e Shqipërisë që ofrojnë programe të ngjashme. Këto programe janë ndërtuar në përputhje me standardet e përcaktuara në aktet nënligjore dhe ofrojnë një profil të qartë akademik dhe profesional, duke reflektuar përpunshmëri deri në masën 70% me programe të tjera të ngjashme në universitetet shqiptare. <i>Shtojca 2.2. Rregullore e brendshme e departamentit</i> <i>Shtojca 2.3. Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit MSH-H është i kodifikuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, në bazë të VKM nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Udhëzimit nr. 31, datë 15.11.2022 “Për Procedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit”. Deri në hyrjen në fuqi të akteve të reja nënligjore, Kodi i programit përcaktohet sipas VKM 310, pika 2d, sipas së cilës programet e ciklit të dytë “Master Shkencor”, me 120 ECTS, identifikohet me kodin 72MS0220SH. Në përputhje me këtë kuadër rregullator, FHF ka dërguar propozimet për kodifikimin përkatës pranë ministrisë përgjegjëse, brenda afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 31, duke respektuar procedurat e kërkuara. Pavarësisht se të dhënat jepen në RVB, GVJ konstaton se mungon dokumenti mbështetës i Praktikës së kodifikimit të programeve të studimit.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe	Nuk aplikohet për këtë program studimi.

programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, vizitave në institucion dhe RVB-së konstatohet se programi i studimit MSH-H është i organizuar në dy vite akademike (120 ETC), i ndarë në 4 semestra dhe lëndët vlerësohen me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), në përputhje me legjislacionin vendas. Programi synon të ofrojë njohuri dhe të zhvillojë aftësi profesionale dhe kompetenca të nivelit të lartë në fushën e studimeve historike. Kjo arrihet përmes një stafi akademik të kualifikuar dhe praktikave profesionale të realizuara në institucione mbështetëse, për të përgatitur profesionistë të së ardhmes. Programi ka objektiva të qartë për formimin profesional të studentëve, duke përshtatur dijet dhe aftësitë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ngarkesa në kredite është përcaktuar qartë për të gjitha lëndët/modulet, përfshirë praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, duke siguruar një përvojë të plotë arsimore për studentët. Organizimi dhe pranimi i studentëve janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe specifikat përkatëse të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Programi është kodifikuar në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe evropiane, në zbatim të VKM nr.288, datë 11.05.2022 dhe VKM nr.310, datë 11.05.2022, si edhe Udhëzimi Nr.31, datë 15.11.2022.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Njësia

kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në ASCAL, në vizitën që GVJ realizoi në institucion, u konstatua se FHF dhe Departamenti i Historisë si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit MSH-H përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, si dhe për proceset e vlerësimit dhe akreditimit. Departamenti i Historisë, në përputhje me Rregulloren e UT-së dhe Statutin e institucionit (neni 14), është autoriteti drejtues që organizon, koordinon dhe kontrollon në mënyrë kolegjiale të gjitha veprimtaritë akademike, administrative dhe financiare të programit MSH-H. Hartimi i kurrikulave për të gjitha ciklet e studimit realizohet nën drejtimin e kësaj njësie bazë, ndërsa miratimi i strukturës mësimore bëhet çdo fillim viti nga Dekanati i FHF. Stafi akademik i angazhuar në program është si më poshtë:
Departamenti i Historisë për tri vitet akademike ka në përbërjen e tij:

Tituj/Grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.dr	4	2	3	2	4	4
Prof.Asc.Dr	4		4	-	3	1
Dr/Doc	4	2	4	2	3	1
Msc						
Totali	12	4	11	4	10	6

Kjo strukturë siguron një qasje profesionale dhe cilësore të disiplinave të historisë dhe në përputhje me standardet e kërkuara për programet e ciklit të dytë. Funksionimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë është i mbështetur në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në nivel fakulteti, e cila zhvillon vlerësime periodike të programit MSH-H dhe bashkëpunon ngushtë me Departamentin e Historisë, me NJSBC e Universitetit të Tiranës, si dhe me Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Në funksion të përgatitjes për akreditim, janë ngritur grupet e vlerësimit të brendshëm me

	vendime të miratuara nga Dekani i FHF, duke reflektuar një qasje institucionale të mirëkoordinuar. Dokumentacioni i paraqitur, si Statuti i UT, rregulloret përkatëse dhe vendimet e strukturave drejtuese, dëshmon për përputhjen e funksionimit të njësive përkatëse me legjislacionin kombëtar për arsimin e lartë (Ligji nr. 80/2015), si dhe për angazhimin e institucionit në proceset e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit. <i>Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit të Tiranës, 2018, neni 14</i> <i>Shtojca 2.3. Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Shtojca 2.4. Rregullore e brendshme e Departamentit të Historisë</i> <i>Shtojca 2.18. Vendimi i FHF-së për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Shtojca 2.19. Vendimi i Departamentit për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (GVB)</i> <i>Shtojca 2.27. Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së FHF</i> <i>Shtojca Tabela 7. Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre</i> <i>Linku: Struktura organizative e FHF 2024. <u>Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë</u></i> <i>Struktura e programeve të studimit të FHF. Linku nuk është i aksesueshëm</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Historisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit MSH-H, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi në drejtim të organizimit të praktikës profesionale. Në planin mësimor të programit, është parashikuar zhvillimi i praktikës profesionale si pjesë përbërëse e formimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve. Kjo praktikë realizohet në bashkëpunim me institucione që lidhen me fushën e historisë dhe kulturës, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të vendosura nga njësia bazë përgjegjëse për programin. Modalitetet e organizimit dhe vlerësimit të praktikës profesionale janë të përcaktuara në Rregulloren e Departamentit të Historisë, ndërsa bashkëpunimet institucionale janë të dokumentuara në seksionin përkatës të marrëveshjeve me institucione të tjera shtetërore, organizata profesionale dhe

	aktorë të tjerë relevantë për programin e studimit. Bazuar në të dhënat e paraqitura në raportin e vlerësimit të brendshëm, GVJ konstaton se organizimi i praktikës profesionale në programin MSH-H mbështetet në kuadër të qartë institucional dhe në marrëdhënie të konsoliduara bashkëpunimi me aktorë të fushës, duke siguruar përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe të nevojave të programit. <i>Shtojca 2.20. Plani mësimor i miratuar</i> <i>Shtojca 2.5. Rregullore e programit të studimit 2023–2024</i> <i>Shtojca 2.31. Tabela e RVB/ Tabela 5. Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi për praktikat profesionale</i> <i>Shtojca Seksioni 3. Seksioni i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione shtetërore, organizata profesionale dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm për arsimin e lartë</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Historisë ka ngritur një strukturë funksionale për administrimin akademik të programit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe institucionale. GVJ vlerëson se në RVB është dhënë informacion i panevojshëm për strukturën drejtuese dhe organizative të departamentit, megjithatë mes këtij informacioni është përshkruar edhe roli i koordinatorit të programit. Krahas informacionit të RVB, gjatë vizitës në institucion dhe vecanërisht në takimin me stafin akademik dhe studentët, konstatohet përzgjedhja e një pedagogu në rolin e koordinatorit të programit, i cili zgjidhet nga Departamenti dhe është përgjegjës për ndjekjen e funksionimit të procesit mësimor. Koordinator shërben si hallkë lidhëse midis studentëve dhe departamentit, duke përcjellë shqetësimet dhe problematikat që lidhen me ecurinë e programit të studimit. Përgjegjësitë e koordinatorit janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit MSH-H, Kreu III, Neni 9 (Shtojca 2.3), ku parashikohet se ai mbështet planifikimin, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e programit me qëllim përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij. GVJ vlerëson se mekanizmi i koordinimit të programit përmes një pedagogu të caktuar si koordinator është funksional dhe në përputhje me kërkesat për organizimin akademik të ciklit të dytë të studimeve.

	Shtojca 2.3. Rregullore e Programit të Studimit			
Konkluzione	<i>Nga sa më sipër, GVJ vlerëson se programi i studimit MSH-H përmbush plotësisht kërkesat e këtij standardi. Si FHF, po ashtu edhe Departamenti i Historisë, si njësi bazë përgjegjëse, siguron organizimin dhe strukturën akademike në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke angazhuar një staf të kualifikuar akademik dhe ndihmës për realizimin e praktikave dhe veprimtarive mësimore. Institucioni ka caktuar një koordinator të programit, i cili mbikëqyr ecurinë akademike, duke garantuar zhvillimin e programit sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Historisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin MSH-H, disponon dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit, në përputhje me kërkesat ligjore. Rregullorja e programit të studimit, si një nga dokumentet bazë të tij, është hartuar në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 (i ndryshuar), Kreu IV A, pika 5 dhe Kreu IV B, pika 3, si dhe me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar). Ky dokument normativ përcakton misionin dhe objektivat e programit, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të tij, si dhe të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe studentëve. Gjithashtu, plani mësimor i miratuar i programit MSH-H përbën një burim të plotë informacioni mbi përmbajtjen akademike dhe organizimin e brendshëm të programit. Ai pasqyron ndarjen e lëndëve, shpërndarjen e krediteve dhe zhvillimin në kohë të komponentëve përbërës të kurrikulës. Të dy dokumentet, rregullorja dhe plani mësimor, sigurojnë një strukturë të qartë referuese për funksionimin akademik të programit dhe përmbushjen e objektivave të tij, duke përmbajtur

	të gjitha informacionet bazë të kërkuara për një program të ciklit të dytë të studimeve. <i>Shtojca 2.3. Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Shtojca 2.20. Plani mësimor i miratuar i Programit të Studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se programi i studimit MSH-H përmban planin mësimor të strukturuar sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet zyrtare (Udhëzimin nr. 1/14.01.2020; VKM nr. 41/24.01.2018. Ky plan mësimor përfshin informacion të plotë mbi ndarjen e lëndëve sipas semestrave, ngarkesën mësimore të çdo lënde/moduli, orët në auditor dhe jashtë auditorit, si dhe shpërndarjen e krediteve ECTS. Programi është organizuar në katër semestra përgjatë dy viteve akademike dhe përmban një total prej 120 ECTS, ku 1 ECTS përfaqëson 25 orë pune të studentit, dhe çdo vit akademik përbëhet nga 1500 orë pune. Referuar ndarjes së krediteve për çdo lëndë sipas formave të mësimdhënies dhe klasifikimit të tyre, plani parashikon: - 9 lëndë të detyrueshme të trungut të përbashkët; - 3 lëndë me zgjedhje; - praktikë mësimore; - detyrimet per. Lëndët janë të ndara në pesë grupe formuese, nga të cilat: a) Lëndët bazë përlllogariten të kenë 12 ECTS (10%), b) Lëndët karakterizuese: 60 ECTS (50%), c) Lëndët ndërdisiplinore/integruese dhe me zgjedhje: 18 ECTS (20%), d) Lëndët plotësuese: 12 ECTS (10%) dhe, e) Detyrime përmbyllëse: 18 ECTS (15%). Për secilën lëndë ofrohet syllabus i detajuar që përfshin emërtimin, semestrin, pedagogun përgjegjës, qëllimet mësimore, përmbajtjen teorike dhe praktike, ngarkesën orare brenda dhe jashtë auditorit, si dhe format e mësimdhënies dhe vlerësimit, duke garantuar transparencë dhe përputhje me kuadrin ligjor. GVJ konstaton se struktura e planit mësimor garanton zhvillimin e programit në mënyrë të organizuar dhe në përputhje me objektivat e formimit akademik dhe profesional të studentëve.

SB.
[Signature]

	Shtojca 2.20. Plani mësimor i miratuar i Programit të Studimit Shtojca 2.31. Tabela e RVB/ Tabela 9. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)/ Tabela 13. Ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies në programin e studimit
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Ky program studimi përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 (i ndryshuar), Kreu IV A, pika 5 dhe Kreu IV B, pika 3, si dhe me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar). Këto të dhëna janë të detajuara në Rregulloren e Programit të Studimit, e cila përshkruan rregullat për: • Pranimin e studentëve në program, sipas kushteve të përcaktuara për ciklin e dytë të studimeve, • Mundësinë e transferimit të studimeve nga programe të tjera të ngjashme në IAL brenda apo jashtë vendit, • Ekuivalentimin e krediteve dhe njohurive të fituara më parë, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe me kërkesat e programit. Për më tepër, Departamenti i Historisë, në bashkëpunim me strukturat e FHF dhe UT-së, bën publike kriteret dhe kuotat e pranimit në programin MSH-H në faqet zyrtare të institucionit, duke siguruar transparencë dhe akses të gjerë për kandidatët e interesuar. GVJ konstaton se këto masa garantojnë qartësi dhe funksionalitet në menaxhimin e pranimeve dhe të proceseve të mobilitetit studentor, duke kontribuar në realizimin e objektivave të programit. Shtojca 2.3. Rregullore e Programit të Studimit
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikë, seminar apo orë të laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të	Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga GVJ, programi i studimit MSH-H përmban informacionet e nevojshme për secilën lëndë, përfshirë syllabuset e detajuara, të cilat përmbajnë të dhëna mbi praktikën, seminarin dhe orët brenda dhe jashtë auditorit. Këto janë në përputhje me formatet e miratuara sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe ndryshimeve përkatëse. Në dokumentacionin e paraqitur (referuar pikës [2.20.1] të

programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	informacionit), konfirmohet se programet mësimore të lëndëve janë pjesë integrale e përmbajtjes së programit dhe përmbajnë komponentët formues në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor. Kjo mbështet transparencën dhe funksionalitetin akademik të programit të studimit, duke siguruar informim të plotë për studentët dhe aktorët përkatës. <i>Shtojca 2.20.1 Programet mesimore të lëndëve për programin e studimit</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programi i studimit MSH-H pasqyron një angazhim për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së tij akademike. Sipas informacionit të ofruar në RVB, përmbajtja e programit përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe ndryshimet përkatëse arkivohen çdo vit. Ky proces i përditësimit sistematik sugjeron një përkujdesje institucionale për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së programit, përfshirë edhe dokumentet mësimore si programet lëndore (syllabuset). Megjithatë në dokumentacionin e paraqitur nuk jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë përshkrime të detajuara të kësaj procedure, GVJ e konsultoi këtë fakt me stafin akademik dhe studentët për të krijuar një ide më të qartë rreth përmbushjes së këtij kriteri. Programi i studimit përmban informacionet e duhura, të cilat mbështeten edhe nga dokumentacioni i nxjerrë nga departamenti. <i>Shtojca 2.1. Vendimi i SA Nr. 44 për hapjen e programit të studimit (18.10.2010)</i> <i>Shtojca 2.3. Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Shtojca 2.12. Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të kurrikulave</i> <i>Shtojca 2.20. Programet e lëndëve për programin e studimit</i>
Konkluzione	<i>Për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ i është referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe takimeve të realizuara në institucion. Në lidhje me organizimin e veprimtarisë mësimore, këkimore-shkencore dhe administrative, Departamenti i Historisë mbështetet në Ligjin Nr.80, datë 22.07.2015, "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të", VKM nr.41, datë</i>

SB.
[Signature]

	24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL". Programi MSH-H ofron të gjithë informacionin e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, duke respektuar si aspektet ligjore edhe rregulloret e brendshme të institucionit mbi kriteret e pranimit dhe transferimet e studentëve. Referuar programeve lëndore, GVJ sugjeron që syllabuset që nuk kanë literaturë bazë të viteve të fundit të shikohet mundësia për përditësimin e vazhdueshëm të literaturës me botimet më të reja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, konstatohet se plani mësimor i programit të studimit MSH-H, si dhe programet lëndore të strukturuar sipas tipeve të veprimtarive, dëshmojnë për një ndërtim të qëndrueshëm të dijeve dhe koherencë të brendshme të përmbajtjes akademike. Kurrikula e programit kontribuon drejtpërdrejt në thellimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për t'u specializuar si studiues dhe ekspert në fushën e historisë. Gjithashtu, plani mësimor karakterizohet nga një larmi lëndësh, të cilat janë orientuar me kujdes nga njohuritë më të përgjithshme drejt atyre më të specializuara, duke pasur si synim përgatitjen për njohjen dhe trajtimin e ngjarjeve historike. Sa më sipër, GVJ konstaton se programi i studimit MSH-H përmbush kërkesat e këtij kriteri, duke ofruar një strukturë të ndërtuar në funksion të thellimit akademik dhe përgatitjes profesionale të studentëve për studime të mëtejshme dhe/ose përfshirje në tregun e punës. <i>Shtojca 2.20. Plan i mësimor i miratuar i programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.20.1 Programet e lëndëve për programin e studimit</i>

Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Plani mësimor i programit të studimit MSH-H përmban 9 lëndë të detyrueshme (të ndara sipas kategorive) dhe 3 lëndë me zgjedhje të detyruar që përzgjidhen nga vetë studenti, një periudhë praktike mësimore, si dhe parashikon mbrojtjen e detyrueshme të tezës së diplomës. Nga takimi i realizuar me studentët u konfirmua se lëndët me zgjedhje zgjidhen nga studenti, në varësi të interesit të tyre. Çdo lëndë përfshin syllabusin përkatës, i cili përmban: emërtimin e lëndës/modulit, vitin dhe semestrin kur zhvillohet, emrin dhe kualifikimin e pedagogut që e zhvillon, rolin e lëndës në formimin teorik dhe praktik të studentit, njohuritë dhe aftësitë që synohet të përvetësohen, temat që trajton, ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë tij. Programi i lëndës hartohet nga titullari përkatës sipas formatit standard të miratuar nga Këshilli Drejtues dhe miratohet nga autoriteti përkatës. Ngarkesa në kredite për secilën lëndë është e përcaktuar. Në funksion të arritjes së objektivave formuese dhe rezultateve të të nxënit, dija ndërtohet në mënyrë koherente dhe logjike: duke filluar me lëndë të formimit të përgjithshëm dhe duke vijuar në mënyrë të strukturuar semestër pas semestri me lëndët e formimit të specializuar. GVJ konstaton se kjo strukturë siguron një progresion akademik të mirëorganizuar, në përputhje me objektivat e programit dhe kërkesat për përgatitjen shkencore të studentëve. <i>Shtojca 2.20. Plani mësimor i miratuar i programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.20.1. Programet e lëndëve për programin e studimit</i> <i>Shtojca 2.31. Tabela e RVB/ Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A–E) (Tabela 9)</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi,	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe në takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion konstatohet se krahas planit mësimor të strukturuar në raport me rregulloret përkatëse, format kryesore të mësimdhënies përfshijnë leksione të integruara me metodologji hulumtimi, detyra kursi, praktikë mësimore dhe kërkim shkencor, i cili kulmon me mbrojtjen e tezës së diplomës. Frekuentimi i seancave të leksioneve është i detyrueshëm të paktën në masën 75% të orëve të mësimit, përveç rasteve të justifikuara me miratimin e përgjegjës të departamentit. Ndërkohë, pjesëmarrja në seminare dhe praktikë mësimore është detyruese. Kohëzgjatja e një seance mësimore

kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	është 50 minuta. Format dhe metodat e mësimdhënies përzgjidhen nga pedagogu, në përputhje me syllabusin e miratuar dhe duke marrë parasysh natyrën e lëndës dhe, kur është e mundur, edhe kërkesat e studentëve. Një konstatim i tillë u pohua edhe në takimin e realizuar nga GVJ me grupin e studentëve. Pedagogu ka detyrimin të paraqesë në fillim të kursit përmbajtjen mësimore, metodologjinë, bibliografinë, mënyrat e vlerësimit dhe detyrimet e tjera të studentëve. Më shumë se gjysma e orëve mësimore u dedikohet punës së pavarur të studentit, sipas përcaktimeve të VKM nr. 41. Veprimtaria mësimore zhvillohet mbi bazën e planeve dhe programeve bashkëkohore, të ndërtuara sipas modeleve të universiteteve analoge në Bashkimin Evropian dhe më gjerë. Kjo dëshmon për përputhshmërinë e strukturës së programit me profilin akademik që synon dhe afërsinë me praktikatat ndërkombëtare të arsimit të lartë në këtë fushë. <i>Shtojca 2.20. Plani mësimor i miratuar i programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.20.1. Programet e lëndëve për programin e studimit</i> <i>Shtojca 2.23. Model i Suplementit të Diplomës MSH-H</i> <i>Shtojca 2.3. Rregullorja e programit të studimit</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Referuar dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton se programi i studimit MSH-H është i organizuar në lëndë dhe module sipas veprimtarive formuese, me orë teorike dhe praktike që kontribuojnë në arritjen e objektivave formues të përcaktuara për ciklin e dytë të studimeve. Lëndët janë të vlerësuara sipas “Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve” (ECTS), çka krijon mundësi reale për transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve brenda dhe jashtë sistemit arsimor shqiptar. Struktura e ndarë në komponentë të formimit teorik dhe praktik siguron përgatitjen e studentëve në përputhje me kërkesat akademike dhe profesionale të fushës së historisë. Ndarja sipas veprimtarive formuese përforcon qartësinë strukturore të programit dhe lehtëson përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të ciklit të dytë të studimeve, duke e bërë programin të krahasueshëm me programe të ngjashme europiane. <i>Shtojca 2.20. Plani mësimor i miratuar i programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.20.1. Programet e lëndëve për programin e studimit</i>

	<i>Shtojca 2.31. Tabela e RVB/ Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A–E) (Tabela 9)</i>
Kriteri 5. Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Gjatë intervistave me drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore, si dhe me stafin akademik, GVJ konstatoi se përditësimi i syllabuseve është një proces i vazhdueshëm, i cili realizohet në përputhje me standardet akademike dhe kërkesat e tregut të punës. Në fillim të çdo viti akademik, titullarët e lëndëve kryejnë një rishikim të materialeve mësimore, duke siguruar që programi të mbetet i përshtatur me tendencat ndërkombëtare dhe zhvillimet teknologjike. Ky përditësim mbështetet nga Departamenti i Historisë, i cili monitoron cilësinë dhe relevancën e përmbajtjes akademike. Për këtë qëllim, institucionet mbështetëse si biblioteka fizike dhe online e FHF, si dhe platformat digjitale, luajnë një rol ndihmës të rëndësishëm. <i>Shtojca 2.2. Rregullore e brendshme e Departamentit</i> <i>Shtojca 2.28. Rregullore e Bibliotekës së FHF</i> <i>Të dhëna të plota për platformat online / strukturën dhe teknologjitë e informacionit / Biblioteka / Biblioteka online/ Tabela 17</i> <i>Shtojca 2.20.1. Programet e lëndëve për programin e studimit</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit MSH-H është ndërtuar mbi një strukturë që ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues, përfshirë edhe disiplina ndërdisiplinore dhe praktike. Kjo strukturë, e reflektuar në planin mësimor, garanton përftimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për të arritur kompetencat e synuara nga programi. Përmbajtja lëndore është ndarë në lëndë bazë për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme, lëndë karakterizuese për përgatitje të specializuar shkencore, lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe grup-lëndë me zgjedhje, si dhe lëndë plotësuese. GVJ konstaton se në të gjitha këto komponentë janë përfshirë kreditet përkatëse dhe formate të ndryshme mësimdhënieje, duke siguruar një balancë mes formimit teorik dhe atij praktik. <i>Shtojca 2.20.1. Programet e lëndëve për programin e studimit</i> <i>Shtojca 2.31. Tabela e RVB/ Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A–E) (Tabela 9)</i>

AB.
[Signature]

	<i>Shtojca 2.20. Plani mësimor i miratuar i programit të studimit</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit MSH-H është konceptuar për të pajisur studentët me njohuri të avancuara teorike dhe metodologjike në fushën e historisë, me fokus në periudha të ndryshme të studimeve historike. Përmbajtja e tij u mundëson studentëve të zotërojnë teknika të thelluara të studimeve historike dhe të ndërtojnë aftësi analitike për të trajtuar tema me natyrë lokale, rajonale dhe globale. Përmes një qasjeje të integruar kërkimore dhe kritike, të diplomuarit arrijnë të zhvillojnë strategji për analizimin objektiv të burimeve dhe për ndërtimin e argumenteve shkencore mbi zhvillime historike, duke qenë të aftë të lidhin të kaluarën me sfidat e së tashmes. Larmia e lëndëve dhe përmbajtja ndërdisiplinore e programit pajisin studentët me aftësi të transferueshme që janë të përshtatshme për kërkesat komplekse të tregut të punës. Programi përgatit të diplomuarit për të ndjekur studimet në nivelin e tretë, si dhe për t'u punësuar në institucione publike dhe private që merren me çështje historike dhe kërkimore, si Akademia e Shkencave, universitetet publike dhe private, institutet kërkimore, arkivat, Autoriteti i Dosjeve, si dhe në organizata të shoqërisë civile apo në administratën publike në nivel qendror dhe lokal. <i>Shtojca 2.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca 1.22 Studimi-i-tregut-të-punës-UT 2022:</i> https://unitir.edu.al/epcontent/uploads/2020/04/Studimi-i-tregut-te-punes_2022-1.pdf <i>Shtojce 2.23 Suplementi i Diplomës MSH-H</i>
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në takimet e realizuara me drejtuesit e institucionit, me stafin akademik, me studentët e programit të studimit, si dhe në shqyrtimin e dokumentacionit të programit të studimit (syllabuseve të lëndëve), vlerëson se përmbajtja e programit të studimit pajis studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale me profilizim në fushën e studimeve historike dhe mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Lëndët, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, ashtu sikundër janë specifikuar në planin pësimor mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet</i>

	dhe kërkimit shkencor. Studimet në këtë program ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale minimumi 2 vite akademike dhe realizohen me 120 kredite, i strukturuar në dy semestra çdo vit, me nga 30 kredite secili semestër. Përveç lëndëve bazë, ofrohen edhe njohuri të thelluara, duke siguruar një përgatitje të mirë në disa drejtime të përshtatshme për nivelin 7 në Kornizën Kombëtare dhe Evropiane të kualifikimeve. Rëndësia e lëndëve metodologjike si dhe ngarkesa me 18 kredite e Mikrotezës së Diplomës aftëson dhe përgatit studentët për vijueshmërinë e mëtejshëm në studime të ciklit të tretë, doktoraturës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Referuar informacionit të RVB, si dhe dokumentacionit të dosjes së akreditimit, të paraqitur në ASCAL, procesi i përmirësimit të programit të studimit është i integruar në praktikat institucionale të vlerësimit dhe vetëvlerësimit. Në veçanti, në analizat vjetore të punës së departamentit, raportet e vetëvlerësimit të programeve dhe ato të vlerësimit të cilësisë nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëjnë një burim të rëndësishëm të të dhënave për identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim. Gjatë realizimit të vizitave në institucion, GVJ konstatoi se zhvillohen takime periodike me aktorë të ndryshëm të përfshirë në realizimin e programit të studimit, përfshirë personelin akademik me kohë të pjesshme, rrjetin ALUMNI, institucionet partnere të praktikave dhe përfaqësues të tregut të punës. Nga këto takime mblidhen sugjerime dhe reflektime të cilat shpërndahen me personelin akademik të angazhuar në program për të orientuar përmirësimet në përmbajtjen e lëndëve dhe për t'i përshtatur me zhvillimet e tregut të punës. Këto të dhëna tregojnë për ekzistencën e një praktike të institucionalizuar reflektimi dhe përmirësimi që mbështetet në konsultim të drejtpërdrejtë me

	aktorët relevantë të tregut të punës dhe të diplomuarit. Bazuar në këto të dhëna, GVJ konstaton se programi i studimit përmbush kërkesat e këtij kriteri. <i>Shtojca 2.17.1 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2021–2022</i> <i>Shtojca 2.17.2 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2022–2023</i> <i>Shtojca 2.17.3 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2023–2024</i> <i>Shtojca 2.31. Tabela e RVB/ Tabela 5</i> <i>Shtojca 2.10 Politikat e vlerësimit akademik të stafit dhe mësimdhënies</i> <i>Shtojca 2.10.1 Raporti i vlerësimit të performancës së personelit akademik</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Gjatë takimeve me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se Departamenti i Historisë ofron mbështetje të vazhdueshme ndaj studentëve. Studentët mbajnë kontakte të rregullta me departamentin dhe kanë hapësira të mirëpërcaktuara për të shprehur mendimet e tyre lidhur me kurrikulën, programet lëndore dhe format e vlerësimit. Stafi akademik konfirmoi se përfshirja e studentëve dhe e të diplomuarve në përmirësimin e programit nxitet nga vetë departamenti, duke u kërkuar sugjerime dhe reflektime që ndihmojnë në rritjen e cilësisë së ofertës akademike. Këto praktika janë të formalizuara në Rregulloren e Brendshme të Departamentit të Historisë, që përcakton mënyrat e përfshirjes dhe bashkëpunimit me studentët për çështje që lidhen me përmbajtjen dhe organizimin e programit të studimit. <i>Shtojca 2.2 Rregullore e brendshme e Departamentit të Historisë</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit të fusha të ndryshme në	Departamenti i Historisë, ndjek zhvillimet më të fundit të legjislacionit që lidhen me fushën përkatëse dhe me tregun e punës, duke i reflektuar ato në strategjinë e vet të zhvillimit. Në këtë kuadër, fokusi kryesor është përshtatja e ofertës akademike në përputhje me propozimet dhe zhvillimet që vijnë nga strukturat e profesionistëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Këto angazhime janë të formalizuara në dokumente institucionale si

bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Rregullorja e Brendshme e Departamentit të Historisë, ku përcaktohen mekanizmat e përshtatjes së programeve të studimit me zhvillimet bashkëkohore në fushën përkatëse. Krahas kësaj, gjatë takimeve të realizuara me përgjegjësen e Departamentit, stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se ky proces mbështetet në projekte kërkimore dhe bashkëpunime institucionale, të cilat kanë ndihmuar në modernizimin e kurrikulës dhe zhvillimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Gjithashtu, projektet Erasmus+ dhe bashkëpunimet me universitete partnere kanë lehtësuar shkëmbimin e praktikave të mira ndërkombëtare dhe integrimin e metodologjive të reja në program. <i>Shtojca 2.2 Rregullore e brendshme e Departamentit të Historisë</i>			
Konkluzione	<i>Departamenti i Historisë, pjesë e FHF, merr në konsideratë propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës për përmirësimin e programit të studimit. Referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit (pjesë e dosjes së akreditimit depozituar në ASCAL), Departamenti konsulton nevojat e programit të studimit MSH - H në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Krahas kësaj, FHF ka struktura të dedikuara si Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Karrierës dhe Doktoraturat, të cilat përfshijnë studentët dhe të diplomuarit në diskutimet për përmirësimin e programit të studimit. GVJ konstatoi gjatë takimit me studenët se Këshillat studentorë në nivel fakulteti dhe institucioni janë aktive në konsultimet për përmirësimin e kurrikulës, duke reflektuar nevojat dhe sugjerimet e tyre në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë	Programi i studimit MSH-H është ndërtuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe të Departamentit të

prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Historisë, duke pasur si synim parësor përgatitjen e specialistëve të aftë në fushën e historisë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në dokumentin Strategjia e zhvillimit të programit MSH-H janë përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat afatmesme dhe afatgjata të programit, të cilat lidhen ngushtë me zhvillimin akademik, kërkimin shkencor dhe përshtatjen me tregun e punës. Programi ndërtohet mbi një kurrikul që bazohet në literaturë shkencore bashkëkohore dhe përvoja evropiane të arsimit të lartë. Objektivat themelore përfshijnë ofrimin e njohurive të avancuara për historinë kombëtare dhe ndërkombëtare, aftësimin për analizën e fenomeneve historike nga një perspektivë e integruar, zhvillimin e moduleve praktike dhe nxitjen e një kërkimi shkencor aktiv nga ana e studentëve. Në aspektin kërkimor, programi synon përfshirjen e studentëve në projekte shkencore në nivel departamenti dhe fakulteti, si dhe publikimin e rezultateve të tyre në mikrotezat përfundimtare. Objektivat e përcaktuara përfshijnë gjithashtu: rritjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare, shkëmbimet akademike dhe integrimin në programet Erasmus+, si dhe krijimin e një rrjeti alumni për mbështetjen profesionale të studentëve të sapodiplomuar. <i>Shtojca 2.4 Strategjia e zhvillimit të programit Master Shkencor në Histori</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, përfshirë Statutin e Universitetit të Tiranës (2018), Rregulloren e UT-së (2022), Rregulloren e brendshme të Departamentit të Historisë, si dhe Rregulloren e programit të studimit, GVJ konstaton se veprimtaria e Departamentit të Historisë zhvillohet në përputhje me parimet e lirisë akademike dhe të autonomisë institucionale. Departamenti i Historisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin MSH-H, administron në mënyrë të rregullt dhe të strukturuar veprimtaritë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, duke respektuar fushën e veçantë të studimit dhe duke mbështetur interesat kërkimore të stafit akademik. Ky organizim bazohet jo vetëm në kuadrin rregullator të brendshëm të UT-së, por edhe në praktikat funksionale të bashkëpunimit dhe ndërveprimit akademik brenda departamentit. Gjatë takimeve të realizuara në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik

	gëzon lirinë për të zhvilluar aktivitetin e tij kërkimor dhe për të përzgjedhur forma dhe metodologji të përshtatshme të mësimdhënies në përputhje me natyrën e lëndëve dhe ekspertizën përkatëse. Gjithashtu, nxitja e kërkimit shkencor dhe koordinimi i aktiviteteve mësimore janë të institucionalizuara në punën e përditshme të departamentit, duke përforcuar misionin e tij akademik dhe shkencor. <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës 2018</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e brendshme e Departamentit të Historisë</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Në përputhje me objektivat e UT, FHF-së dhe të Departamentit të Historisë, programi MSH-H parashikon dhe mbështet një përfshirje aktive të studentëve në aktivitete kërkimore dhe shkencore. Gjatë takimit të GVJ-së me studentët u konstatua se Departamenti i Historisë ndërmerr rregullisht nisma për angazhimin e studentëve në projekte kërkimore dhe konferenca shkencore, përfshirë Konferencën Shkencore Studentore të Fakultetit dhe Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të organizuar nga UT. Studentët marrin pjesë në këto aktivitete si pjesë e Këshillit Studentor ose nën mentorimin e stafit akademik të programit. Përsa i përket angazhimit të studentëve në kërkim shkencor, një pjesë e tyre janë përfshirë në projekte të organizuara në nivel departamenti apo fakulteti, si dhe në zbatim të projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, të tilla si ato në kuadër të Horizon2020, Jean Monnet, ERASMUS+ dhe COST, të financuara nga Bashkimi Evropian. Studentët përfitojnë gjithashtu nga mundësitë e pjesëmarrjes në kurse dhe shkolla verore, si dhe trajnohen për të qenë pjesë aktive e organizimit të aktiviteteve akademike. Departamenti i mbështet studentët edhe në publikime në revista shkencore kombëtare, duke reflektuar një angazhim të qëndrueshëm për të nxitur cilësinë dhe zhvillimin profesional të tyre në fushën e kërkimit. <i>(Linku është i paaksesueshëm)</i> <i>Shtojca 2.31. Tabela e RVB/ Tabela 22</i>

AB.

[Signature]

Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Departamenti organizon çdo vit veprimtari studimore dhe kërkimore, të tilla si konferenca shkencore dhe botimi i revistës “Studime Albanologjike”. Këto aktivitete mbështeten dhe financohen nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, në kuadër të angazhimit institucional për të nxitur kërkimin shkencor dhe zhvillimin akademik të programit të studimit. Financimi institucional përfshin gjithashtu mbështetjen e drejtpërdrejtë për realizimin e konferencës vjetore shkencore të Departamentit si dhe për botimin periodik të revistës së tij shkencore. Gjithashtu, në përputhje me udhëzuesin për procedurat e administrimit të projekteve kërkimore në Universitetin e Tiranës, Departamenti ka të drejtë të administrojë të ardhura nga veprimtari të ndryshme akademike dhe shkencore. Mbështetja financiare për kërkimin shkencor shtrihet edhe përtej aktiviteteve institucionale. Stafit akademik i përfshirë në këtë program përfiton stimuj financiarë për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare apo për publikime në revista shkencore ndërkombëtare me vlerë deri në 40.000 lekë për pedagog; kjo qasje synon të lehtësojë dhe inkurajojë përfshirjen aktive të stafit akademik në kërkimin shkencor dhe prezantimin e rezultateve në nivele të larta ndërkombëtare. Gjatë takimit të GVJ-së me përfaqësuesen e zyrës së projekteve u konstatua edhe për mbështetjen financiare të UT për projekte institucionale, të cilën e ka përfituar edhe Departamenti i Historisë. Këto forma mbështetjeje financiare dëshmojnë për një mekanizëm funksional në përputhje me misionin e programit të studimit për të nxitur kërkimin dhe produktin shkencor, si dhe për të rritur cilësinë akademike të veprimtarive kërkimore që lidhen me programin MSH-H. <i>Shtojca 1.13 Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT</i> <i>Shtojca 2.32 Raport auditi i FHF</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit MSH-H garanton orientimin e studentëve në kërkimin shkencor përmes një strukture të qartë akademike, mbështetjes institucionale dhe integritit të veprimtarive kërkimore në kurrikul. Departamenti i Historisë ka krijuar mekanizma efektivë për nxitjen e kërkimit shkencor, përfshirjen e studentëve në projekte akademike dhe bashkëpunimin me</i>

	<i>institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Përvec të dhënave të pasqyruara në RVB sugjerohet të krijohet një databazë mbi dokumentimin e studentëve të përfshirë në aktivitete të ndryshme shkencore.</i> <i>Financimi i siguruar nga burime institucionale dhe projekte të jashtme ka ndihmuar në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarive studimore dhe shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion, vlerësohet se bashkëpunimi për realizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore të përbashkëta përbën një prioritet strategjik të Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë si dhe Departamentit të Historisë. Kjo qasje përforcohet edhe nëpërmjet frymës së bashkëpunimit të reflektuar në të gjitha nivelet e strukturave të UT-së. Njësia përgjegjëse për ofrimin e këtij programi, Departamenti i Historisë, mbështet grupet lëndore dhe nxit projektet kërkimore-shkencore të reja, si dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për të përmbushur objektivat e programit në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të rritjes së cilësisë akademike. Kjo mbështetje është e dukshme edhe në përfshirjen e studentëve dhe stafit në veprimtari kërkimore të përbashkëta, duke mundësuar zhvillimin e mëtejshëm profesional dhe akademik në përputhje me nevojat bashkëkohore të fushës së historisë dhe me kërkesat e tregut të punës. Referuar RVB mungojnë shtojcat që e mbështesin këtë informacion.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe	Departamenti i Historisë angazhon personelin akademik në mënyrë aktive për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studimeve dhe projekteve kërkimore me karakter shkencor, të iniciuara nga aktorë të ndryshëm të fushës. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, si dhe tabelat përkatëse (Tabela 19 dhe Tabela 22), rezulton se këto veprimtari janë realizuar në

angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	partneritet me institucione të njohura si Fondacioni Konrad Adenauer, AIDSSH, ISKK, DPA, si dhe Muzeu Kombëtar "Shtëpia me Gjethe". Këto bashkëpunime dëshmojnë për një përfshirje të strukturuar të departamentit në rrjete kërkimore dhe përmbushje të objektivave akademike dhe shkencore të programit të studimit. Njësia përgjegjëse demonstroi gjithashtu një përkushtim të qartë për integrimin e studentëve në këto aktivitete, duke i angazhuar ata në projekte konkrete kërkimore dhe duke kontribuar kështu në zhvillimin e tyre profesional dhe akademik. Përfshirja e studentëve në veprimtari të tilla ndihmon në kultivimin e aftësive kërkimore, promovon një qasje bashkëpunuese në procesin e prodhimit të dijes dhe forcon lidhjen ndërmjet mësimdhënies dhe praktikës kërkimore. Një konstatim i tillë pohohet edhe gjatë takimit të GJVJ me studentët. <i>Shtojca 2.31. Tabela e RVB/ Te dhena për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit (tabela 19)/ Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësise, në tre vitet e fundit (Tabela 22)</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në lidhje me këtë kriter, vlerësojmë se Departamenti i Historisë është angazhuar në mënyrë të strukturuar dhe të qëndrueshme në organizimin e veprimtarive akademike dhe kërkimore që kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivave të programit. Këto veprimtari synojnë jo vetëm zhvillimin profesional të stafit akademik, por edhe përfshirjen aktive të studentëve në praktikën kërkimore dhe në rritjen e kompetencave të tyre analitike. Praktika e organizimit të konferencave shkencore, ëorkshopeve tematikë dhe shkollave verore e vjeshtore dëshmon një angazhim të vazhdueshëm për krijimin e një mjedisi akademik që promovon diskutimin shkencor dhe aplikimin e njohurive në kontekste konkrete studimore. Iniciativa si "History Lab", ëorkshop-i mbi historinë gojore gjatë pandemisë Covid-19, ëorkshop-i "Digital Humanities", si dhe programet e shkollave verore dhe vjeshtore që trajtojnë tematika bashkëkohore dhe kritike për historinë shqiptare (si stalinizmi apo nacional-komunizmi), përfaqësojnë forma të avancuara të ndërveprimit midis kërkimit dhe mësimdhënies. Këto aktivitete vlerësohen si të rëndësishme për thellimin e përvojës akademike të studentëve dhe rritjen e cilësisë së

	procesit mësimor, duke kontribuar gjithashtu në formimin e tyre si studiues të rinj në fushën e historisë. Nga raportet vjetore të Departamentit të Historisë për tre vitet e fundit del qartë se këto veprimtari janë jo vetëm të pranishme, por të institucionalizuara dhe pjesë e filozofisë zhvillimore të programit të studimit. <i>Shtojca 2.17.1 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2021–2022</i> <i>Shtojca 2.17.2 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2022–2023</i> <i>Shtojca 2.17.3 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2023–2024</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit MSH-H është ndërtuar mbi baza të qëndrueshme akademike, në përputhje me modelet kurrikulare ndërkombëtare në fushën e shkencave historike dhe humane. Kjo qasje reflekton përpjekjen e njësive përgjegjëse për të përgatitur profesionistë të kualifikuar që plotësojnë kërkesat e tregut të punës, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Plani mësimor i miratuar i programit, si dhe rregullorja përkatëse, tregojnë një ndërthurje të komponentëve teorikë dhe atyre kërkimorë, që synon zhvillimin e kompetencave të avancuara analitike, interpretative dhe metodologjike tek studentët. Kjo i pajis ata me aftësi të aplikueshme jo vetëm në kërkimin akademik, por edhe në profile të tjera profesionale, si në institucione arsimore, kulturore, arkivistike dhe mediatike. Referuar dokumentacionit si dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se programi MSH-H kontribuon në formimin e një profili studiuesi që mund të ndjekë karriera të mëtejshme akademike, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të fushës. Nga ana tjetër, fakti që programi është projektuar në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, rrit potencialin e transferueshmërisë dhe të mobilitetit të studentëve dhe stafit, duke ndikuar pozitivisht në përgatitjen e tyre për një treg pune gjithnjë e më të globalizuar dhe të ndërlidhur. <i>Shtojca 2.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.20 Plani mësimor i programit të studimit</i>

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	NA			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	NA			
Konkluzione	Nga analiza e kryer për secilin kriter rezulton se njësia përgjegjëse për programin e studimit MSH-H demonstroi një funksionim të qëndrueshëm dhe të mirëstrukturuar në drejtim të administrimit akademik dhe kërkimit shkencor. Programi mbështet zhvillimin profesional të stafit dhe angazhimin e studentëve në aktivitete kërkimore, garanton mbështetje financiare për veprimtari shkencore, si dhe ruan një frymë bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm institucionalë. Struktura kurrikulare është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe standardet ndërkombëtare të fushës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga programi i studimit dhe praktikave të zbatuara në kuadër të tij, konstatohet se përdoren metoda të mësimdhënies, të përshtatura me kërkesat bashkëkohore arsimore dhe nevojat e fushës së historisë. Referuar formatit të programeve lëndore, të dhënave të grumbulluara nga takimi me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se programi garanton realizimin e leksioneve, seminareve, punëve, detyrave të kursit, eseve, projekteve dhe praktikave profesionale, si dhe orët e hapura, të cilat janë të miratuara në mënyrë institucionale dhe të përcaktuara qartë në syllabuset e secilës lëndë. Për të përmbushur këto objektiva të lëndës por edhe të programit të studimit, personeli akademik përdor mjete të ndryshme didaktike, duke përfshirë prezantime me power-point, mjete audio-vizive dhe diskutime interaktive, stilet e debatit sipas Karl Popper për të stimuluar përvetësimin e dijeve dhe zhvillimin e mendimit kritik të studentët. Sipas planit mësimor të miratuar, orët mësimore organizohen në leksione në auditor, orë pune të pavarura të studentit dhe orë praktike profesionale. Bazuar në informacionin e RVB, Departamenti i Historisë organizon auditore të hapura me të ftuar të jashtëm, të cilët trajtojnë tema specifike me interes për studentët e programit. Mungon një shtojcë ose link që të mbështesë këtë informacion. Përsa i përket formave të vlerësimit janë gjithashtu të larmishme dhe përfshijnë testime me shkrim dhe me gojë, ese, detyra kursi, punë në grup, projekte, prezantime, praktika dhe tezën e diplomës. Këto metoda përdoren për të vlerësuar përvetësimin e objektivave formues dhe të kompetencave profesionale nga studentët. Për më tepër, programi është i pajisur me infrastrukturë teknologjike për mbështetjen e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, si dhe mjedise për prezantime video dhe projekte në grup.

	<i>Shtojca 4.6. Programet mesimore te lendeve te programit te studimit</i> <i>Shtojca 2.20 Plani i miratuar mesimor i programit te studimit</i> <i>Shtojca 2.31 Tabela e RVB/ Plani mesimor sipas modelit të Tabelës 10</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Siç e theksuam edhe në kriterin pararendës, personeli akademik aplikon një sërë metodash bashkëkohore të mësimdhënies, në përgjigje të nevojave për një proces mesimor sa më efektiv për studentët. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, informacionin e përfshirë në programet mesimore të lëndëve, takimet me stafin akademik dhe studentët rezultojnë se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit aplikon në mënyrë të qëndrueshme një qasje të ndjeshme dhe fleksibël ndaj larmisë dhe nevojave të studentëve. Qysh në fazën e planifikimit të programit të lëndës, pedagogët marrin në konsideratë një sërë metodash alternative të përcjelljes së informacionit, të cilat synojnë të sigurojnë përfshirjen aktive të studentëve, pavarësisht nga dallimet që mund të ekzistojnë mes tyre për sa i përket përvojave, mënyrave të të nxënies apo nevojave individuale. Kjo përjasje e diferencuar mbështetet në përdorimin e metodave interaktive të mësimdhënies, të cilat shoqërohen me përdorimin e mjeteve mbështetëse të teknologjisë së informacionit. Këto mjete ndihmojnë në realizimin e prezantimeve më cilësore dhe e bëjnë mjedisin mesimor më gjithëpërfshirës dhe funksional. <i>Shtojca 2.20.1 Programet mesimore të lëndëve të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies.	FHF ka vendosur në qendër të strategjisë së tij zhvillimore rritjen e kompetencave didaktike të stafit akademik në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së procesit mesimor. Institucioni ka ngritur një qendër virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional, e cila ofron një platformë të strukturuar për zhvillimin profesional të stafit akademik. Përdorimi i saj tregon një qasje institucionale për të integruar

	teknologjinë në përmirësimin e praktikave pedagogjike dhe për të forcuar mbështetjen e personelit nëpërmjet formave të aksesueshme dhe të vazhdueshme të zhvillimit profesional. Strategjia e zhvillimit të Fakultetit thekson rëndësinë e metodave inovative në mësimdhënie dhe ka çuar në ngritjen e një infrastrukture të posaçme informatike dhe teknologjike në mbështetje të procesit mësimor. Kjo infrastrukturë synon të krijojë kushte cilësore për aplikimin e metodave pedagogjike të larmishme dhe fleksibile, të cilat janë të integruara në programet mësimore të lëndëve. Mjediset, platformat online, struktura teknologjike dhe bibliotekat (fizike dhe online), të përshkruara në dokumentacionin përkatës, përbëjnë elementë thelbësorë që kontribuojnë në realizimin me sukses të objektivave formuese të programit dhe në zhvillimin e kompetencave të studentëve për të qenë konkurrues në tregun e punës. Këto elementë janë të lidhura ngushtë me mbështetjen që u ofrohet pedagogëve, luajnë një rol të rëndësishëm në realizimin e progresit cilësor të programit të studimit. Në përfundim, GVJ konstaton se mbështetja institucionale ndaj personelit akademik në aspektin didaktik është e dukshme dhe në përputhje me standardin përkatës. Ajo shfaqet si në nivel strategjik, ashtu edhe në veprimtari konkrete, të strukturuar dhe të dokumentuara. <i>Shtojca 2.4 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.31 Tabela e RVB/ Te dhëna të plota për platformat on-line / Struktura e teknologjisë së informacionit / Biblioteka / Biblioteka online, etj (Tabela 17)] / [Te dhëna për infrastrukturën. Mjediset e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë / Njësitë Bazë (Tabela 16)]</i> <i>Qendra virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional:</i> <i><u>https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional</u></i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të	GVJ konstaton se Departamenti i Historisë i kushton vëmendje të veçantë garantimit të cilësisë së mësimdhënies përmes përzgjedhjes dhe angazhimit të personelit akademik me profil dhe specializim të përshtatshëm për programin. Në funksion të kësaj, në fillim të çdo viti akademik realizohet planifikimi i lëndëve dhe i ngarkesës mësimore, në mënyrë që

SB.
[Signature]

ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	të sigurohet përputhshmëria ndërmjet përmbajtjes së lëndëve dhe kompetencave profesionale të stafit të angazhuar në program. Nga të dhënat e raportuara, vërehet se personeli akademik zbaton metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe zhvillon diskutime me në qendër studentin, duke stimuluar mendimin kritik, krijues dhe aftësinë për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme. Nga ana tjetër, departamenti siguron udhëheqjen dhe mbështetjen e vazhdueshme të stafit, duke krijuar një klimë akademike që favorizon zhvillimin e praktikave bashkëkohore të mësimdhënies dhe arritjen e objektivave të programit. Gjatë takimeve në institucion, por edhe referuar tabelave të angazhimit të PAE, GVJ konstaton angazhimin e një asistent lektori në programin e MSH-H. Gjatë pyetjeve të ngritura në takim me stafin akademik u konfirmua angazhimi si asistent lektor i tij, në mbështetje të realizimit të seminarëve të titullarit të lëndës (Prof.dr). <i>Shtojca 1.1 Statutit të Universitetit të Tiranës 2018, neni 74</i> <i>Shtojca 2.21 CV e personelit akademik dhe ndihmes akademik per programin e studimit</i> <i>Shtojca 2.31 Tabela e RVB/ Plani mesimor i lidhur me personelin akademik perkates (Tabelat 12))</i> <i>Shtojca 2.20.1 Programet mesimore te lendeve te program it te studimit</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga verifikimet e bëra përmes evidencave dhe vizitës së zhvilluar në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Historisë realizon një proces të rregullt vlerësimi dhe përmirësimi të metodave të mësimdhënies, duke përfshirë stafin akademik dhe studentët në këtë proces. Ky proces bazohet në të dhënat që burojnë nga raportet periodike të cilësisë së mësimdhënies, të hartuara mbi bazën e pyetësorëve të plotësuar nga studentët dhe të përpunuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Një pohim i tillë konfirmohet edhe nga përfaqësuesja e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Karrierës dhe doktoraturave. Sipas saj, rezultatet, rekomandimet dhe pikat e dobëta të identifikuar nga studentët u bëhen të ditura përgjegjësve të departamenteve, duke mundësuar diskutime reflektuese dhe

	konstruktive mbi përmirësimet që duhen ndërmarrë. Por, nga takimi me stafin akademik rezulton se ata nuk vihen në dijeni rreth informacionit që merret nga pyetësorët. Një qasje e tillë mund të ndikojë në ngadalësimin e përmirësimit të procesit të mësimdhënies ose elementëve të tjerë, të evidentuar nga studentët. Megjithatë, përveç monitorimit institucional, praktikat e punës në departament parashikojnë edhe forma komunikimi të drejtpërdrejtë pedagog–student, përmes të cilave pedagogët u kërkojnë studentëve që të shprehen lirshëm dhe në mënyrë anonime mbi pikat e forta dhe të dobëta të lëndës, si dhe mbi performancën e vetë pedagogut në mësimdhënie. <i>GVJ rekomandon që Departamenti i Historisë të jetë më transparent në transmetimin e të dhënave të grumbulluara nga pyetësorët me studentët.</i> <i>Shtojca 1.12 Paketa e Instrumentave të Cilësisë</i> <i>Shtojca 2.17.1 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2021–2022</i> <i>Shtojca 2.17.1 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2022–2023</i> <i>Shtojca 2.17.1 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2023–2024</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e	Institucioni ka ngritur dhe aktivizuar struktura të dedikuara për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, të cilat funksionojnë në bashkërendim me Departamentin e Historisë. Në qendër të praktikës pedagogjike që zbatohet në program qëndron përdorimi i metodave interaktive e diskutimeve me në qendër studentin, si dhe theksi i veçantë mbi nxitjen e punës individuale të studentëve përmes rasteve studimore, eseve dhe detyrave të strukturuar sipas lëndëve. Planet mësimore të lëndëve të programit përmbajnë ndarje të qartë të orëve të leksioneve dhe seminareve, ku i jepet përparësi sa të kuptuarit teorik aq edhe hulumtimit të pavarur. Këto forma përbëjnë një ndërthurje midis përçimit të dijes dhe nxitjes së autonomisë në të nxënë. Bazuar në informacionin e marrë nga RVB por edhe nga takimet e realizuara në institucion, pedagogët caktojnë orare të rregullta konsultimi jashtë orarit mësimor, në mbështetje të nevojave akademike dhe organizative të studentëve. Gjithashtu, GVJ konstaton se në mbështetje të zhvillimit profesional të stafit, institucioni ofron

aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	mundësi trajnimi përmes Qendrës Virtuale të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional, e cila u mundëson pedagogëve përmirësimin e aftësive didaktike dhe njohjen me metoda të reja të mësimdhënies, në përputhje me qëllimet e përmirësimit të cilësisë. Shtojca 2.20.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Link- Mundësi dhe hapësira trajnimi për personelin akademik nëpërmjet Qendrës Virtuale të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional			
Konkluzione	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve të realizuara në institucion, vlerëson se programi i studimit përmbush në mënyrë të kënaqshme standardet e cilësisë në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit. Metodatat e përdorura janë të larmishme dhe të përshtatura me nevojat dhe diversitetin e studentëve, duke integruar forma tradicionale dhe inovative të mësimdhënies, si dhe përdorimin e mjeteve audio-vizuale dhe teknologjive të informacionit. Institucioni garanton mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin profesional të stafit akademik, duke organizuar trajnime dhe duke përdorur platforma digjitale që ndihmojnë në përmirësimin e kompetencave didaktike. Personeli akademik është kompetent dhe i angazhuar në procesin mësimor, duke nxitur mendimin kritik dhe autonominë e studentëve, ndërsa marrëdhëniet mes pedagogëve dhe studentëve karakterizohen nga bashkëpunimi dhe respekti i ndërsjellë. Procesi i vlerësimit dhe përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies zhvillohet në mënyrë periodike dhe përfshin në mënyrë aktive studentët. FHF përdor mekanizma të ndryshëm të mbledhjes së feedback-ut nga ana e studentëve, por Departamenti i Historisë jo gjithmonë i bën transparente këto të dhëna. Për këtë arsye, GVJ rekomandon një angazhim më të madh në këtë drejtim, duke e vënë theksin te ndryshimi dhe përmirësimi i vazhduar i procesit të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Bazuar në informacionin e marrë nga takimet e realizuara në institucion, si dhe dokumentacionin e ofruar nga programi i studimit, GVJ konstaton se kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret përkatëse të Universitetit të Tiranës, FHF, si dhe në rregulloren specifike të programit të studimit. Këto rregullore përfshijnë elementë të ndryshëm të procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provime të ndërmjetme dhe përfundimtare. Mënyrat e vlerësimit janë të detajuara në programet mësimore të çdo lënde dhe studentët njihen me to që prej fillimit të vitit akademik. Ky sistem siguron transparencë dhe qartësi për studentët lidhur me mënyrën e vlerësimit dhe kriteret e përdorura gjatë procesit mësimor. <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2022</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e brendshme e Departamentit të Historisë</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Programit të Studimit MSH-I-1</i> <i>Shtojca 2.20.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Departamenti i Historisë ndjek një procedurë informimi të rregullt ndaj studentëve. Ata informohen çdo fillim viti akademik rreth lëndës/modulit lidhur me temat, metodologjinë, metodat e vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe shkencore, si dhe literaturën e përdorur. Ky informacion jepet nga titullari i lëndës/modulit në orën e parë të mësimdhënies dhe përfshin elementë të rëndësishëm si përqindjen e vlerësimeve të ndryshme (kolokiume, seminare, projekte, detyra, etj.), të cilat janë gjithashtu të paraqitura në syllabuset përkatëse. <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Programit të Studimit (MSH-H)</i> <i>Shtojca 2.20.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i>

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe analizës së kryer, GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma të larmishme. Një qasje e tillë bazohet në dispozitat përkatëse të Rregullores së UT (<i>Shtojca 1.2</i>), Rregullores së Departamentit të Historisë (<i>Shtojca 2.3</i>) dhe Rregullores së Programit të Studimit MSH-H (<i>Shtojca 2.3</i>), ku parashikohen qartë mënyrat e vlerësimit të studentëve përmes elementëve si: pjesëmarrja dhe aktivizimi gjatë lëndës, detyrat e kursit, esetë, provimet e ndërmjetme dhe provimi përfundimtar. Gjithashtu, përfshihen edhe format praktike të vlerësimit përmes praktikës dhe detyrimeve për temën e diplomës. Hartimi i tezave të provimit përfshin një kombinim të pyetjeve me alternativa, pohime, pyetje shpjeguese, duke i dhënë studentëve mundësinë të demonstrojnë si njohuritë teorike, ashtu edhe kompetencat praktike të fituara gjatë programit. Sipas programeve mësimore të lëndëve të programit të studimit (<i>Shtojca 2.20.1</i>), shpërndarja e pikëve specifikohet në mënyrë të detajuar për çdo lëndë dhe arrin në një total prej 100 pikësh. Bazuar në këto të dhëna, GVJ vlerëson se testimi dhe vlerësimi i njohurive realizohet në mënyrë të shumëllojshme dhe të përshtatur me karakterin e lëndës, duke i mundësuar studentit të shfaqë aftësitë e tij në mënyrë gjithëpërfshirëse. <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2022</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e brendshme e Departamentit të Historisë</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Programit të Studimit, MSH-H</i> <i>Shtojca 2.20.1 Programet mesimore të lëndëve të programit të studimit</i>
Konkluzione	Bazuar në analizën e kryer për të gjitha kriteret dhe dokumentacionin përkatës të vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konstaton se programi i studimit MSH-H respekton në mënyrë të strukturuar dhe të dokumentuar standardet përkatëse në lidhje me vlerësimin e studentëve dhe cilësinë e mësimdhënies. Kriteret dhe mënyrat e vlerësimit janë të qarta, të formalizuara në rregullore dhe të pasqyruara në syllabuset e lëndëve, duke garantuar transparencë dhe informim të studentëve që në fillim të çdo moduli. Vlerësimi i

	<i>njohurive dhe kompetencave realizohet përmes metodash të ndryshme të përshtatura me natyrën e lëndës dhe që nxisin aftësitë praktike e teorike të studentëve. Institucioni demonstroi angazhim të vazhdueshëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes mekanizmave të brendshëm të vlerësimit, përfshirjes së studentëve në këtë proces dhe ofrimit të trajnimeve për stafin akademik. Po ashtu, mbështetja institucionale për përdorimin e metodave bashkëkohore dhe ndërvepruese në mësimdhënie është e dukshme, ashtu si dhe vëmendja ndaj ndërtimit të marrëdhënieve respektuese dhe të hapura pedagog-student.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Programi i studimit MSH-H e ka të strukturuar qartë mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve përgjatë gjithë vitit akademik. Ky proces zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe është i integruar brenda planit mësimor të secilës lëndë. Bazuar në Rregulloren e UT (Shtojca 1.2), por edhe në Rregulloren e programit të studimit (Shtojca 2.3), vlerësimi i studentëve realizohet në mënyrë të kombinuar përmes një sërë komponentësh si pjesëmarrja aktive, detyrat e kursit, esetë, projektet, provimet e ndërmjetme dhe provimi përfundimtar, të cilat pasqyrohen në programet e lëndëve dhe në formatet e kontrollit të njohurive. Këto komponentë kanë peshë të përcaktuar (%), sipas llojit të lëndës, çka kontribuon në një proces më gjithëpërfshirës të vlerësimit. Forma e vlerësimit në çdo lëndë është fleksibël dhe përshtatet me natyrën e përmbajtjes së saj. Ajo mund të realizohet përmes provimeve me shkrim, me gojë, ose të kombinuara, duke lejuar përshtatjen e mënyrës së testimit me objektivat e modulit përkatës. Kjo qasje synon jo vetëm kontrollin e njohurive teorike, por edhe vlerësimin e kompetencave praktike dhe aftësive analitike të studentëve.

	Gjithashtu, është i evidentueshëm përkushtimi për informimin e studentëve për format dhe kriteret e vlerësimit që në fillim të çdo moduli. Kjo realizohet përmes publikimit të syllabus-it në platformën e dedikuar (e – student) apo komunikimit të drejtpërdrejtë nga pedagogu, duke garantuar transparencë dhe akses të vazhdueshëm në informacion. Nëpërmjet përdorimit të një sistemi të shpërndarjes së pikëve (deri në 100 pikë) dhe konvertimit të tyre në nota (5-10), procesi i vlerësimit siguron një standardizim të metodologjisë dhe një reflektim të drejtë të performancës së studentit. GVJ vlerëson se praktika e ndjekur për vlerësimin e vazhdueshëm krijon një mjedis stimulues si për studentët, duke i inkurajuar të angazhohen gjatë gjithë semestrit, ashtu edhe për pedagogët, të cilët kanë liri akademike në organizimin e programeve lëndore me të gjithë komponentët e tyre. <i>Shtojca 2.20.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.31 Tabela e RVB/ Formate kontrollit të njohurive (Tabela 15)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion, GJV konstaton se programi MSH-H është pjesë e një kuadri institucional që parashikon përdorimin e sistemeve elektronike për testimin dhe vlerësimin e njohurive, në funksion të rritjes së transparencës dhe shmangies së subjektivitetit apo abuzimeve në procesin e vlerësimit. Ky informacion mbështetet nga marrëveshja e bashkëpunimit të UT me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), i cili ka vendosur në dispozicion sistemin CleanScore, një teknologji që lejon korrigjimin e provimeve në mënyrë të automatizuar. Referuar RVB rezulton se në periudhën kur mësimi dhe provimet janë zhvendosur në platforma online, është përdorur edhe platforma Office 365 me funksione të e-learning, ku pyetjet e mbyllura të provimit janë vlerësuar automatikisht. Kjo ka ndihmuar në ruajtjen e konfidencialitetit dhe në rritjen e efikasitetit të procesit të vlerësimit në kushte të vecanta. Megjithatë, nga informacioni i paraqitur nuk rezulton në mënyrë të detajuar se në çfarë mase apo në cilat lëndë konkretisht është përdorur sistemi CleanScore në programin

	MSH-H. Po ashtu, nuk jepen të dhëna mbi përfshirjen e platformave të tjera teknologjike ose praktika të qëndrueshme për vlerësimin elektronik në nivel të njësisë bazë. GVJ sugjeron që të forcohet përdorimi i mjeteve elektronike të vlerësimit përtej rasteve të veçanta ose përjashtimore, dhe të dokumentohet më qartë aplikimi i tyre në programet specifike. Shtojca 2.31 Tabela e RVB/ Tabela 5 <i>Shënim: Shtojca 3. Agreement, e cila përmban marrëveshjen e bashkëpunimit mes AADF-UT, e depozituar në ASCAL, mungon si reference për këtë kriter.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ, mbi bazën e dokumentacionit zyrtar të paraqitur nga institucioni dhe në përputhje me informacionin e marrë gjatë takimeve, konstaton se procesi i vlerësimit përfundimtar në MSH-H realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Vlerësimi përfundimtar i studentit për çdo lëndë përbëhet nga komponentë të ndryshëm (sic u përmendën edhe më lart: detyra kursi, prezantime, provim final), të cilët janë të parashikuar në mënyrë të qartë në syllabusin përkatës. Këto vlerësime kryhen vetëm brenda afateve të përcaktuara në strukturën e vitit akademik. Data e zhvillimit të provimeve shpallet jo më vonë se një muaj përpara fillimit të sezonit, në përputhje me rregulloren përkatëse të programit të studimit dhe atë të Universitetit. Në raste të veçanta, siç janë pamundësitë objektive për pjesëmarrje në provim ose në prezantim, përgjegjësi i Departamentit, me miratim të Dekanit, cakton një datë alternative për realizimin e vlerësimit, duke garantuar informimin e studentëve dhe stafit përkatës. Në rastet kur një lëndë zhvillohet nga një pedagog, ai është i vetmi përgjegjës për vlerësimin; ndërsa në rastet kur një lëndë zhvillohet nga më shumë se një pedagog, vlerësimi final jepet si mesatare e vlerësimeve individuale të çdo anëtari të stafit akademik që ka kontribuar në mësimdhënie. Ky mekanizëm vlerësimi është i standardizuar dhe i formalizuar në dokumentacionin e brendshëm. GVJ vlerëson pozitivisht përputhjen e praktikave të vlerësimit me dispozitat e syllabusit dhe rregulloret në fuqi, si dhe funksionimin e mekanizmave të mbikëqyrjes për zbatimin e drejtë të tyre. Shtojca 2.3 Rregullore e Programit të Studimit MSH-H

	<i>Shtojca 2.20.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Gjatë takimeve të realizuara në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit MSH-H parashikon ofrimin e feedback-ut si pjesë përbërëse të vlerësimit akademik, në përputhje me rregulloret përkatëse të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë dhe të vetë programit të studimit. Sipas informacioneve të administruara, në çdo komponent të procesit të kontrollit të njohurive dhe aftësive, pedagogët evidentojnë problematikat e shfaqura nga studentët dhe analizojnë arsyet e këtyre vështirësive. Kjo qasje vlerësimi ka një funksion reflektues dhe formues, duke e ndihmuar studentin të kuptojë mangësitë dhe të orientohet drejt përmirësimit të mëtejshëm. Nga takimi me stafin akademik dhe me pas me studentet konfirmohet se veçanërisht gjatë seminareve dhe punës individuale, studentët marrin komente verbale të drejtpërdrejta nga stafi akademik lidhur me nivelin e përvetësimit të njohurive, cilësinë e përgatitjes dhe të prezantimit që duhet të realizojnë. Ky lloj feedback-u përdoret për të dhënë orientime konkrete mbi përmirësimin e performancës akademike dhe zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave profesionale dhe shkencore. GVJ e vlerëson këtë praktikë në përputhje me parimet e të mësuarit aktiv dhe formues, por sugjeron përdorimin e instrumenteve formalë të feedback-ut të marrë nga studentët. <i>Shtojca 2.3 Rregullore e brendshme e Departamentit të Historisë</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Programit të Studimit (MSH-H)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Institucioni ka vendosur masa të qarta për të shmangur plagjiaturën dhe kopjimin gjatë provimeve dhe detyrave të kursit, duke garantuar integritetin akademik. Mekanizmat parandalues zbatohen gjatë gjithë ciklit të studimeve dhe përfshijnë jo vetëm mënyrën e mbikëqyrjes së provimeve dhe masat ndëshkimore në rast shkeljesh, por edhe vetë përmbajtjen dhe metodologjinë e hartimit të detyrave dhe punimeve të diplomës. Personeli akademik orienton studentët drejt tematikave me karakter praktik dhe kërkimor, të cilat nxisin përdorimin e të dhënave autentike dhe të qasjes kritike në analizë, duke zhvilluar kompetenca të thelluara dhe

	vetëdije etike. GVJ vlerëson pozitivisht qasjen institucionale për të ndërtuar një kulturë akademike që lufton fenomene si plagjiatura dhe kopjimi. <i>Shtojca 1.4 Kodi i Etikës i UT-së</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e brendshme e Departamentit të Historisë</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Programit të Studimit, MSH-H</i> <i>Shtojca 2.20.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimi i studentëve të programit MSH-H realizohet në përputhje me bazën ligjore dhe rregulloret përkatëse, duke u bazuar në parimin e meritokracisë dhe duke respektuar afatet kohore të caktuara për shpalljen e rezultateve. Sipas informacioneve të paraqitura, vlerësimi përfundimtar është i strukturuar mbi një sistem prej dhjetë notash, ku nota 5 është më e ulëta e kalueshme, ndërsa format e testimit dhe përqindjet për secilën komponentë vlerësimi përcaktohen në programin e lëndës dhe komunikohen studentëve që në fillim të kursit, përmes platformës <i>e-student</i> ose drejtpërdrejt. Përdorimi i një shumëllojshmërie formash testimi (me shkrim, me gojë, detyra kursi, projekte) dhe përgatitja e tezave në nivele të ndryshme vështirësie ndihmon në matjen objektivë të kompetencave. Rezultatet e provimeve bëhen publike brenda dhjetë ditëve nga zhvillimi i provimit përmes sistemit elektronik <i>e-student</i>, si dhe komunikohen në fund të çdo semestri nga sekretaria e Departamentit. Për më tepër, studentët kanë të drejtë të ankimojnë vlerësimin mbi bazën e argumenteve të justifikuara dhe provave materiale, duke ndjekur procedurat e përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës. GVJ vlerëson se procedurat e ndjekura për shpalljen e rezultateve dhe trajtimin e ankesave janë të qarta dhe mbështeten në rregulla transparente, duke garantuar një proces vlerësimi të drejtë dhe të paanshëm. <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2022, neni 60</i>

Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Programi MSH-H i ka të përcaktuara qartë të drejtat e studentëve për t'u njohur me rezultatet e vlerësimit si dhe për të ushtruar të drejtën për rishikim të tij. Sipas rregullores së UT-së, si dhe rregulloreve përkatëse të FHF dhe të programit të studimit, studentët kanë të drejtën të kërkojnë ankim për vlerësimin e marrë në provime, nëse mendojnë se ai nuk është i drejtë. Ankimi duhet të bëhet mbi bazën e argumenteve të arsyeshme dhe të shoqërohet me prova materiale të mjaftueshme. Në RVB evidentohet roli i sekretarisë së Departamentit, e cila informon studentët për rezultatet në përfundim të çdo semestri, duke i mundësuar atyre të ushtrojnë këtë të drejtë në kohë. Rregulloret përcaktojnë gjithashtu se çdo ankesë e paraqitur trajtohet në përputhje me hierarkinë institucionale dhe proceduralisht në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UT-së. <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2022, neni 60</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në shqyrtim të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, GVJ konstaton se trajtimi i kërkesave dhe ankimeve të studentëve zhvillohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në rregulloret përkatëse të Universitetit të Tiranës dhe të njësive përbërëse të tij. Ky proces është i formalizuar, i dokumentuar dhe transparent për të gjitha palët e përfshira. Pas shpalljes së rezultateve të provimeve, studentët kanë të drejtë të kërkojnë sqarim lidhur me vlerësimin e marrë. Kjo përfshin të drejtën për t'u njohur me zgjidhjet e tyre, për të kërkuar fotokopje të materialeve të dorëzuara si dhe për të kërkuar rivlerësim. Në rast të një ankimi të mëtejshëm, ngrihet një komision i posaçëm vlerësimi, i autorizuar për të shqyrtuar çështjen dhe për të marrë një vendim përfundimtar. Rezultatet e provimeve dokumentohen përmes Procesverbalit të Vlerësimit dhe Regjistrit të Rezultateve, të cilët gjenerohen përmes sistemit online "e-student". Këto dokumente dorëzohen në sekretari brenda 10 ditëve nga dita e provimit apo prezantimit të detyrës. Rregullorja ndalon rreptësisht çdo korrigjim apo shtesë në procesverbal pas dorëzimit të tij, përveç rasteve kur pranohet zyrtarisht një gabim i dokumentuar me shkrim nga pedagogu dhe i miratuar nga autoriteti drejtues. Në raste specifike kur pedagogu nuk është

	më pjesë e trupës akademike, drejtuesi i departamentit ka të drejtë të ngrejë një komision të posaçëm për trajtimin e rastit. Përgjatë gjithë procesit, transparenca garantohej edhe nga afatet e qarta për trajtimin e kërkesave dhe nga dokumentimi rigoroz i çdo vendimmarrjeje, të cilat arkivohen nga sekretaria mësimore. GVJ vlerëson se procedurat për shqyrtimin e ankimimeve janë të mirëstrukturuara dhe të dokumentuara, duke siguruar integritetin e procesit të vlerësimit dhe të drejtën e studentëve për trajtim të drejtë dhe transparent. Gjatë takimit me stafin akademik, GVJ kërkoi informacion mbi një procedurë të ankimimit, e cila nuk është pjesë e dokumentacionit të dosjes ASCAL. Stafi akademik pohoi se nuk ka patur raste ankimimi, për të cilat të jetë ndjekur një procedurë në të gjitha hallkat e saj. <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2022, neni 60</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe takimet e zhvilluara, GVJ vlerëson se testimi dhe vlerësimi i njohurive në programin MSH-H realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe transparente, në përputhje me syllabus-in dhe aktet rregullative në fuqi. Studentët marrin feedback gjatë procesit mësimor dhe inkurajohen të përmirësojnë performancën akademike. GVJ sugjeron që përveç formularëve tip, të përdorura në rang fakulteti, departamenti të përdorë instrumentet formale të reflektimit nga student (formularë vetëvlerësimi për lëndët) për marrjen e drejtëpërdrejtë të feedbackut nga studentët.</i> <i>Masat për parandalimin e plagjiaturës janë të qarta dhe përforcohen me udhëzime për etikën e kërkimit. Rezultatet komunikohen brenda afateve të përcaktuara, ndërsa procedurat për ankesa dhe rishikim janë transparente, të dokumentuara dhe të zbatueshme. Në lidhje me përdorimin e sistemeve elektronike, si Clean Score dhe Office 365, të përmendura në RVB, GVJ rekomandon përdorimin konkret të tyre për të ndihmuar në shmangien e subjektivitetit, në rritjen e besueshmërisë së procesit, dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi MSH-H paraqet një strukturë të ndërtuar mbi parime të organizimit akademik që synojnë të sigurojnë thellimin konceptual dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të studentëve. Kjo përpjekje vërehet në mënyrën se si është konceptuar ndarja e ngarkesës mësimore sipas grupeve të veprimtarive formuese dhe në larmishmërinë e komponentëve të përfshirë në kurrikul. Struktura përfshin lëndë të detyrueshme të trungut të përbashkët, lëndë me zgjedhje të detyruar, një periudhë praktike dhe detyrimin për përgatitjen e tezës së diplomës, duke synuar të ruajë balancën ndërmjet formimit teorik dhe aplikimit praktik. Shpërndarja e krediteve sipas pesë kategorive formuese (baze, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse) përputhet me kërkesat e VKM-së në fuqi dhe krijon një strukturë të lexueshme akademike. GVJ konstaton përpjekjet për të krijuar një program të balancuar dhe të përputhur me kuadrin ligjor, që në konceptim shfaq synimin për të formuar profesionistë të aftë në fushën e historisë. <i>Shtojca 2.31 Tabela e RVB/ Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10/ Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (Tabela 9)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Referuar informacionit të dorëzuar nga institucioni, GVJ konstaton se programi MSH-H parashikon përfshirjen e elementëve që lidhen me zhvillimin e aftësive të ndërveprimit, të punës kërkimore me ndihmën e teknologjisë së informacionit, si dhe me përdorimin e gjuhës së huaj për akses në burime bashkëkohore. Në mënyrë të veçantë, vërehet një përpjekje për të integruar qasje inovatore përmes metodologjive digjitale të tipit “edu-game”, të nxitura nga një

	projekt ndërkombëtar ku janë përfshirë pedagogë të Departamentit të Historisë. Nga takimi me studentët rezultoi se ata e përdorin teknologjinë gjatë punës kërkimore individuale apo në grup, veçanërisht për qëllime informacioni dhe burime literare, por gjithashtu përmes seminareve ku metodat interaktive dhe digjitale përmenden si pjesë e procesit mësimor. Në këtë aspekt, GVJ vlerëson pozitivisht përfshirjen e iniciativave që synojnë të modernizojnë praktikën tradicionale të mësimdhënies dhe të rrisin angazhimin e studentëve në mënyra më dinamike të përvetësimit të dijes. Megjithatë, duhet theksuar se dokumentacioni i paraqitur nuk ofron të dhëna të strukturuar mbi lëndë specifike që synojnë aftësitë në fushat e teknologjisë së informacionit, komunikimit apo ndërveprimit shoqëror. Megjithatë, qasja në mjetet digjitale për hulumtim dhe prezantim mbështetet në përshkrime të përgjithshme, ndërkohë që nuk dokumentohet në mënyrë të detajuar përmes lëndëve konkrete apo projekteve të integruara në program. Nga takimi me stafin akademik, GVJ mësoi se projekti EDU-Game është në fazën e hershme të zbatimit të tij, ndaj duhet të shohim në vazhdim konkretizimin e këtij kriteri. <i>Shtojca 2.20.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i> <i>Link: Projekti edu-game i Departamentit të Historisë:</i> <i>http://edugameproject.eu</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	GVJ, duke u bazuar në informacionin e paraqitur nga institucioni, vëren se ky program trajton në mënyrë të strukturuar përshkrimin e kompetencave dhe aftësive që studenti duhet të përvetësojë gjatë ciklit të dytë të studimeve. Këto elementë janë të reflektuara në syllabus-et e çdo lënde, ku pasqyrohen objektivat e të nxënësve, përmbajtja, ndarja në veprimtari formuese, ngarkesa në ECTS, si dhe format e vlerësimit. Referuar RVB, në përfundim të çdo lënde, realizohen diskutime përmbledhëse me studentët, në të cilat trajtohen çështjet kyçe të përmbajtjes dhe jepen rekomandime për mënyrën e zbatimit të njohurive në kontekste të tjera akademike apo praktike. Po ashtu, në prag të provimeve përmbyllëse, studentët informohen qartë mbi strukturën dhe natyrën e testimit, duke i ndihmuar të ndërtojnë një strategji më

	të mirë për përmbushjen e detyrimeve të lëndës. Megjithatë, GVJ konstaton mungesën e një informacioni mbi përdorimin e ndonjë instrumenti të formalizuar (p.sh. formular reflektimi, apo analizë përfundimtare e rezultateve të të nxënit), i cili mund të shërbente si mjet për përforsimin e ndërgjegjësimit të studentit mbi ecurinë dhe boshllëqet e mundshme në përvetësimin e kompetencave. <i>Shtojca 2.20.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Departamenti i Historisë i programit MSH-H e mbështet mësimdhënien në një qasje kompetencash, duke përfshirë punën në grup, detyrat studimore dhe trajtimin e rasteve, të cilat udhëhiqen nga personeli akademik. Këto metoda synojnë nxitjen e të menduarit kritik dhe angazhimin aktiv të studentëve në procesin e mësimnxënies. Institucioni ofron një infrastrukturë që mbështet zhvillimin e praktikave mësimore. Kjo infrastrukturë, e konstatuar edhe gjatë vizitës së GVJ në mjediset e FHF përfshin mundësi për zbatimin praktik të njohurive të marra në auditor. Nga ana tjetër, GVJ konstaton se programi MSH-H krijon mundësi për internshipe dhe praktika në bashkëpunim me institucione publike dhe organizata partnere të lidhura me fushën e historisë. Po ashtu, studentët marrin pjesë në aktivitete jashtëkurrikulare dhe kërkimore, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e kompetencave të tyre shkencore dhe profesionale. Në aspektin e mobilitetit, përfshirja në projektin Erasmus përmendet si e realizuar, por pa specifikuar numrin e studentëve të përfshirë, llojin e mobilitetit apo ndikimin në rritjen e cilësisë së formimit. Për rrjedhojë, GVJ vlerëson se programi i studimit është i orientuar drejt përmbushjes së këtij kriteri në mënyrë funksionale. <i>Shtojca 2.20.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.17.1 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2021–2022</i> <i>Shtojca 2.17.2 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2022–2023</i>

	<i>Shtojca 2.17.3 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2023–2024</i> <i>Shtojca 3.20 Dosje e leksioneve/aktiviteteve/konferencave të hapura</i> <i>Shtojca 4.24 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve</i> <i>Shtojca 4.27 Lidhje me aktivitetet kërkimore dhe akademike në kuadër të programit të studimit MSH-H</i> <i>Shtojca: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/ësh studimi për Praktikat profesionale (Tabela 5)</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Referuar të dhënave të grumbulluara, GVJ konstaton se personeli akademik efektiv dhe ndihmës-akademik është i përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në veprimtari trajnuese, seminare dhe leksione të hapura, të cilat zhvillohen si brenda Institucionit të Arsimit të Lartë, por edhe në bashkëpunim me aktorë të jashtëm. Në dokumentacion përmendet angazhimi aktiv i stafit në përmirësimin e teknikave dhe metodave të mësimdhënies, duke marrë pjesë në ëorkshop-e dhe forume profesionale të organizuara nga vetë institucioni apo njësi të tjera, çka dëshmon për një përpjekje të qëndrueshme për përditësimin akademik dhe profesional të stafit. Në RVB thuhet se një pjesë e pedagogëve zhvillojnë veprimtari jashtë strukturës së programit, në bashkëpunim me institucione të tjera, duke e zgjeruar më tej ndikimin e tyre përtej mjedisit të brendshëm universitar. GVJ sugjeron që të hartohet një kalendar vjetor i aktiviteteve, numër orësh, apo listë e kontributeve që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimet e reja shkencore në fushën e historisë apo teknologjive të aplikuara në këtë fushë. Të gjitha këto aktivitete do të ishte mirë të pasqyroheshin jo vetëm në faqen e rrjetit social të Departamentit, por edhe në ëbsite-n e FHF-së. <i>Shtojca 2.17.1 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2021–2022</i> <i>Shtojca 2.17.2 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2022–2023</i>

	<i>Shtojca 2.17.3 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2023–2024</i> <i>Shtojca 2.21 CV e personelit akademik dhe ndihmës akademik për programin e studimit</i> <i>Link: Dokumentim i aktivitetit të Departamentit ndër vite në faqen Facebook:</i> <i><u>https://ëëë.facebook.com/UTHistoryDept/?locale=sq_AL</u></i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UT mbështet veprimtarinë kërkimore dhe nisma akademike ku përfshihen edhe studentët. Kjo mbështetje përfshin ofrimin e granteve të posaçme për projekte të kërkimit shkencor, prezantime në konferenca si dhe organizimin e veprimtarive akademike studentore, përfshirë konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Përfshirja e studentëve në kërkim, si dhe mbulimi financiar i pjesëmarrjes së tyre në këto aktivitete, përbën një praktikë pozitive që kontribuon në zhvillimin e kompetencave kërkimore dhe të mendimit kritik. Konferencat studentore të organizuara periodikisht në nivel universiteti janë një tjetër formë inkurajuese për nxitjen e ideve inovative në radhët e studentëve të ciklit të dytë, duke i integruar ata në komunitetin e studiuesve në fushën e shkencave humane dhe historisë. Megjithatë, GVJ konstaton se nuk është evidentuar në mënyrë të qartë se në çfarë mase studentët e programit MSH-H janë të përfshirë realisht në këto projekte apo konferenca. Mungojnë të dhëna specifike mbi numrin e studentëve përfitues, temat e trajtuara nga ata, raportet e bashkëpunimit me stafin akademik në kërkime të përbashkëta, mbulimi financiar etj. <i>Shtojca 1.13 Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT</i> <i>Link – UT organizon “Konferenca Shkencore Ndërkombëtare Studentore” <u>https://unitir.edu.al/...</u> (link i dhënë nga institucioni, i paplotë)</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e dokumentacionit dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës, konstatohet se UT, FHF dhe Departamenti i Historisë në veçanti kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përmbushur kriteret e vlerësuara, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e kompetencave të studentëve, përfshirjen e tyre në kërkimin shkencor dhe</i>

	<i>mbështetjen financiare të inovacionit. Struktura e programit, rishikimi periodik i kurrikulës dhe bashkëpunimi me institucione të tjera ofrojnë një bazë të qëndrueshme për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konstaton se programi MSH-H ka të përcaktuara qartë procedurat për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, përkatësisht për përgatitjen, dorëzimin dhe mbrojtjen e tezës së diplomës. Në Rregulloren e programit të studimit (Shtojca 2.3) përshkruhen fazat e përzgjedhjes së temës, miratimi nga departamenti, caktimi i drejtuesit shkencor, konsultimi gjatë procesit dhe dorëzimit për mbrojtje. Për më tepër, përcaktohen kriteret e vlerësimit, përbërja e komisionit dhe të drejtat e studentit për të paraqitur ankimim në rast të kontestimit të notës. Gjithashtu, studenti informohet në mënyrë të paracaktuar për të gjitha aspektet procedurale përpara fillimit të punës me tezën e diplomës, çka tregon një nivel të mirë të transparencës dhe parashikueshmërisë institucionale. Vlen të theksohet gjithashtu se programi i njihet autorësia e tezës së diplomës së studentit, si dhe e drejta për publikim apo shpërndarje, në përputhje me standardet akademike dhe etike. Nga ana tjetër, GVJ vëren se dokumentacioni i paraqitur nuk përfshin një udhëzues metodologjik të detajuar për hartimin e tezës, i cili do të shërbente si mjet shtesë për orientimin e studentit në aspektet teorike, strukturore dhe formale të punimit përfundimtar. Shtojca 2.3 Rregullore e programit të studimit
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët,	Departamenti i Historisë dhe koordinatoret e programit janë të ngarkuar me detyrën për të njoftuar studentët në lidhje me udhëzimet dhe afatet kohore për realizimin e punimit të

duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	diplomës. Këto detaje bëhen të njohura për studentët, sipas informacionit të dhënë, në fazën fillestare të përgatitjes së punimit përfundimtar, ndërsa gjithashtu specifikohet se secilit student i caktohet një udhëheqës akademik për ndjekjen e punës kërkimore. Ashtu siç u përmend edhe në kriterin 1, mungon një udhëzues i strukturuar për përgatitjen e tezës së diplomës, që të shërbejë si referencë metodologjike për studentin dhe mjet koordinimi për punën e tij me udhëheqësin shkencor. Megjithatë, bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion GVJ vlerëson se institucioni ka vendosur përgjegjësi institucionale dhe procedura bazike për asistimin e studentëve në detyrimet përfundimtare. <i>Shtojca 2.3 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në përfundim të ciklit të dytë të studimeve në programin MSH-H nuk zhvillohet një provim final në formën klasike, por hartohet dhe mbrohet një tezë kërkimore. Kjo përfaqëson formën e vetme të detyrimit përfundimtar që është teza e diplomës. Procesi i mbrojtjes së tezës administrohet nga një komision i posaçëm, i ngritur nga Departamenti i Historisë, i cili kryen vlerësimin përfundimtar të performancës së studentit mbi bazën e standardeve të përcaktuara në rregullore. Në dokumentacion theksohet se tezat e diplomës duhet të reflektojnë njohuritë e përfituara gjatë gjithë periudhës së studimeve, duke integruar njohuri teorike nga lëndë/modulet e programit, si dhe aftësi të avancuara në kërkimin shkencor. Literatura që studentët përdorin, sipas përshkrimit të dhënë, përfshin burime në gjuhën shqipe dhe të huaj, dhe përzgjedhja e saj synon të orientojë studentin drejt tematikave të debatuar në fushën e shkencave historike. <i>Shtojca 2.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.31 Tabela e RVB/ Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (Tabela 9)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të	Sipas informacionit të paraqitur, udhëheqësi i diplomës luan një rol qendror dhe funksional në orientimin e studentit gjatë gjithë procesit të hartimit të punimit përfundimtar. Mbështetja që ofron është e strukturuar dhe përfshin disa komponentë thelbësorë për arritjen e një standardi të lartë akademik nga

punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	studentët. Konkretisht, udhëheqësi ndihmon në formulimin e titullit të punimit, në përzgjedhjen dhe rekomandimin e metodologjisë së studimit, si dhe në këshillimin për burimet dhe literaturën përkatëse. Ky proces synon që studentët të zhvillojnë një kapacitet të pavarur kërkimor, por gjithmonë nën mbështetjen dhe kujdesin profesional të pedagogut udhëheqës. Referuar informacionit të mbledhur nga takimi me studentët, udhëheqësi ofron konsulencë për organizimin e strukturës së punimit, si dhe për përpunimin dhe interpretimin e rezultateve. Vetëm pas vlerësimit dhe miratimit nga ana e udhëheqësit, punimi konsiderohet i përgatitur për t'u paraqitur për mbrojtje përpara komisionit. <i>Shtojca 2.3. Rregullore e Programit të Studimit</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Bazuar në informacionin e ofruar, GVJ konstaton se institucioni ofron mundësi dhe mbështetje praktike për studentët në realizimin e projekteve kërkimore, në përputhje me kërkesat e temave të diplomës dhe fushën përkatëse të studimit. Gjatë takimit të realizuar me stafin akademik, GVJ konstatoi se Departamenti i Historisë luan një rol aktiv në asistimin e studentëve për kryerjen e punës kërkimore në terren dhe përpunimin e të dhënave të grumbulluara përmes formave të ndryshme të kërkimit. Kjo përfshin jo vetëm aspektin metodologjik, por edhe mbështetjen për zbatimin konkret të kësaj pune kërkimore në ambientet e institucionit ose jashtë tij. Mjediset fizike të FHF vihen në dispozicion të studentëve për përmbylljen e detyrimeve akademike dhe kërkimore (biblioteka e FHF-së dhe zyrat e pedagogëve të pajisura me kompjuterë dhe programe përkatëse për përpunimin e të dhënave). Gjithashtu, sipas të dhënave të raportuara në dokumentacionin vjetor të Departamentit të Historisë për periudhën 2021–2024, rezulton se asistencë për studentët në këtë drejtim është e institucionalizuar dhe ndodh në përputhje me përcaktimet e Rregullores së përgatitjes së diplomës.
	<i>Shtojca 2.3 Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Shtojca 2.17.1 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2021–2022</i> <i>Shtojca 2.17.2 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë</i>

	2022–2023 <i>Shtojca 2.17.3 Raporti vjetor i Departamentit të Historisë 2023–2024</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ konstaton se në përfundim të provimit përfundimtar, i cili në këtë program konkret realizohet në formën e mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë sipas sistemit të notave nga 4 deri në 10. Ky proces është i detajuar dhe i mbështetur në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë MSH – H. Vlerësimi i punimit të diplomës kryhet nga një komision, i cili ka përbërje jo më pak se tre anëtarë, përfshirë edhe udhëheqësin e punimit. Nga informacioni i dhënë rezulton se procedura e vlerësimit është e institucionalizuar dhe e dokumentuar, në përputhje me kërkesat e standardit. Ajo garanton jo vetëm një proces të drejtë dhe të barabartë për të gjithë studentët, por edhe sigurimin e cilësisë akademike përmes aplikimit të kriterëve të qarta dhe të miratuara. <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Programit të Studimit</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Procesi i pajisjes së studentëve me dokumentacionin përfundimtar të studimeve është i strukturuar, i detajuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat institucionale. Në përfundim të studimeve, pas përmbushjes së të gjitha kërkesave të planit mësimor dhe mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti pajiset me diplomën Master i Shkencave në “Histori”, e cila është e miratuar nga Ministria e Arsimit. Diploma shoqërohet me suplementin përkatës të diplomës dhe me listën e notave të fituara gjatë gjithë viteve të studimit. Ajo përmban të gjitha të dhënat përkatëse ligjore dhe akademike dhe nënshkruhet nga autoritetet përkatëse: Përgjegjësi i Departamentit, Dekani dhe Rektori i UT-së. Procesi i tërheqjes së diplomës është personal dhe evidentohet në regjistrin përkatës të universitetit, çka u konstatua nga GVJ edhe gjatë vizitës së realizuar në sekretarinë mësimore të FHF. Nga ky takim u informuam gjithashtu se institucioni vë në dispozicion të studentit një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, e cila është gjithashtu e përfshirë në mënyrë të detajuar në suplementin e diplomës.

	Në rastet kur diploma humbet ose dëmtohet, institucioni nuk lëshon dublikate, por pajis studentin me një vërtetim zyrtar të barasvlefshëm me diplomën, si dhe me listën e notave dhe krediteve të fituara. Këto dokumente nënshkruhen dhe vulosen nga autoritetet drejtuese përkatëse. GVJ konstaton se praktika e ndjekur nga institucioni tregon për një proces të qartë dhe të standardizuar të pajisjes së studentëve me dokumentacionin e diplomimit, të përputhur me kuadrin rregullator të Ministrisë së Arsimit dhe aktet normative të vetë universitetit. <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës 2018, neni 111</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Shtojca 2.22 Modeli i diplomës “Master Shkencor në Histori”</i> <i>Shtojca 2.23 Modeli i suplementit të diplomës për programin e studimit “Master i Shkencave në Histori”</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	GVJ vlerëson se institucioni ka ndërtuar një sistem të formalizuar për ruajtjen dhe menaxhimin e dokumentacionit të studentëve, duke reflektuar përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë dhe mbrojtjen e të dhënave. Struktura administrative përgjegjëse – përkatësisht sekretaria mësimore dhe arkiva e institucionit – menaxhojnë një sërë dokumentesh themelore që shërbejnë për të garantuar integritetin dhe gjurmueshmërinë e të dhënave akademike. Këto përfshijnë regjistrin themeltar të studentit, regjistrin e rezultateve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave, të cilët në përmbajtje dhe funksion përfaqësojnë mekanizma kyç për verifikimin dhe auditimin e historikut studimor të individit. Ajo që GVJ vëren pozitivisht është mbajtja paralelisht e dokumentacionit në format fizik dhe elektronik, çka shton sigurinë arkivore dhe përgatitjen institucionale për t’iu përgjigjur kërkesave administrative apo ligjore në kohë reale. Megjithatë, është me rëndësi që ndjekja e kësaj rruge të shoqërohet me politika të qarta të ruajtjes digjitale dhe procedura të përditësimit të bazës së të dhënave, për të shmangur pasaktësitë ose boshllëqet e mundshme në regjistrime. <i>Shtojca 2.9 Rregullore e sekretarisë mësimore</i>

Konkluzione	Bazuar në analizën e të gjitha kritereve 1–8 dhe dokumentacionin përkatës të siguruar nga Institucioni si dhe nga vizitat e realizuara në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit MSH-H zbaton një qasje të qëndrueshme dhe të dokumentuar për organizimin e detyrimeve përmbyllëse të studentëve. Rregulloret dhe praktikat institucionale mbështesin qartësisht procesin e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës, duke garantuar mbështetje akademike, standarde të përcaktuara të vlerësimit, transparencë procedurale dhe administrim të rregullt të dokumentacionit. Të gjitha etapat — nga përzgjedhja e temës dhe konsulencat metodologjike, deri te vlerësimi, pajisja me diplomë dhe arkivimi i të dhënave — zhvillohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullat e brendshme të Universitetit. Rekomandim: Hartimi i një udhëzuesi metodologjik të detajuar për hartimin e tezës, i cili do të shërbente si mjet shtesë për orientimin e studentit në aspektet teorike, strukturore dhe formale të punimit përfundimtar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	NA
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet,	NA

garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	NA			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë,	Referuar dokumentacionit shoqërues të paraqitur në RVB dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Historisë ka staf të mjaftueshëm akademik dhe ndihmës

personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	akademik për përmbushjen e kriterëve të bazës për realizimin e programit të studimit, në përputhje me kërkesat bashkëkohore për sigurimin e cilësisë së moduleve mësimore.				
	Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024	
		PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr	3	2	2	4
	Prof.As.Dr	4	-	4	1
	Dr	4	2	4	1
	MSc	-	-	-	-
Total	11	4	10	6	
	2.17.1 dhe 2.17.2.				
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Referuar dokumentacionit shoqërues të paraqitur në Raportin Vetëvlerësues të Brendshëm (RVB) dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitës vlerësuese në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se Departamenti i Historisë disponon staf të mjaftueshëm akademik dhe ndihmës akademik për të garantuar zbatimin cilësor të programit të studimit, në përputhje me kërkesat dhe standardet bashkëkohore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Stafi i angazhuar në realizimin e programit përmbush kriteret e përcaktuara për kualifikimet akademike dhe përvojën profesionale, si dhe mbulon me kompetencë të gjitha fushat themelore të parashikuara në planin mësimor. Përveç kësaj, GVJ vëren se struktura dhe shpërndarja e stafit janë të organizuara në mënyrë të tillë që të mbështesin zhvillimin e moduleve mësimore dhe ofrimin e një procesi efektiv mësimor, kërkimor dhe këshillues për studentët. Gjithashtu, dokumentacioni i paraqitur dëshmon për përkushtimin institucional në fuqizimin e kapaciteteve akademike dhe zhvillimin				

	profesional të stafit, si dhe për përfshirjen e tyre në aktivitete bashkëpunuese me institucione të tjera arsimore dhe kërkimore. <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>960</td><td>840</td><td>120</td><td>87.5% / 12.5%</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>960</td><td>840</td><td>120</td><td>87.5% / 12.5%</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table> Dokumentacion mbështetës: • Shtojca 2.21 – Lista dhe profili i stafit akademik të angazhuar • Shtojca 2.17.1 – Vërtetimet e kualifikimeve dhe përvojës së punës • Shtojca 2.17.2 – Orari dhe ngarkesa mësimore e stafit • Shtojca 2.31 – Tabela e Raportit Vetëvlerësues të Brendshëm (RVB) • Tabela 5 – Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese të Fakultetit • Tabela 16 – Mjediset e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë / Njësive Bazë	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	960	840	120	87.5% / 12.5%	2023-2024	960	840	120	87.5% / 12.5%					
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2022-2023	960	840	120	87.5% / 12.5%																	
2023-2024	960	840	120	87.5% / 12.5%																	
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe	Në përputhje me kërkesat e kriterit që lidhet me garantimin e qëndrueshmërisë së personelit akademik përgjatë gjithë periudhës së akreditimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar në kuadër të Raportit Vetëvlerësues të Brendshëm (RVB), si dhe të informacionit të grumbulluar gjatë vizitës institucionale dhe takimeve me zyrat përkatëse administrative, vlerëson se Departamenti i Historisë ka ndërtuar një strukturë të qëndrueshme dhe funksionale të trupës akademike. Personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit rezultojnë kontraktuar në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës në arsimin e lartë. Kontratat e punës janë të përditësuara dhe përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, përfshirë mbulimin me sigurime shoqërore dhe																				

mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	shëndetësore, çka dëshmon seriozitetin dhe angazhimin institucional për respektimin e të drejtave të punës dhe sigurimin e stabilitetit profesional të stafit. Kjo qasje institucionale garanton jo vetëm përputhshmërinë me kornizën ligjore, por edhe krijon kushte të favorshme për një angazhim të vazhdueshëm e cilësor të personelit akademik, duke mbështetur në mënyrë të qëndrueshme zhvillimin dhe zbatimin e programit të studimit gjatë gjithë periudhës së akreditimit.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Në Departamentin e Historisë të Universitetit të Tiranës, procedurat për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë janë të qarta, të standardizuara dhe të harmonizuara me kuadrin rregullator të brendshëm të UT-së. Procesi bazohet në kritere të përcaktuara për përzgjedhjen e kandidatëve, duke përfshirë nivelin e kualifikimit, përputhshmërinë akademike me përmbajtjen e programit të studimit dhe përvojën profesionale apo kërkimore të tyre. Komisionet e rekrutimit, të cilat përbëhen nga 5 anëtarë të caktuar nga njësitë përkatëse akademike, veprojnë në formën e komisioneve ad-hoc, me kompetencë të plotë për të shqyrtuar dhe vlerësuar kandidatët në mënyrë objektive dhe të paanshme. Procedurat janë transparente, pasi shpallja e vendeve të lira dhe kriteret përkatëse publikohen në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe në faqet zyrtare të universitetit, duke garantuar informimin dhe aksesin e gjerë të palëve të interesuara. Shtojca- 1.10. Manuali për punësimin e personelit në UT.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e	GVJ konstaton se Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, përkatësisht Departamenti i Historisë, siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të kualifikuar dhe në numër të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e mjediseve laboratorike, në përputhje me rregulloret dhe aktet nënligjore të Universitetit të Tiranës (UT). Zyra e Burimeve Njerëzore, si një njësi funksionale brenda strukturës organizative të Universitetit të Tiranës, administron dhe arkivon dokumentacionin e personelit ndihmës akademik, duke përfshirë të dhënat e përgjithshme dhe kontratat përkatëse. Përditësimi dhe mirëmbajtja e këtij dokumentacioni kryhet në mënyrë të rregullt nga

mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	specialisti përgjegjës i sektorit të burimeve njerëzore dhe protokoll-arkivit, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe institucionale.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vetëvlerësimit dhe realizimit të vizitës pranë institucionit, GVJ konstaton se Fakulteti i Filologjisë në Universitetin e Tiranës, nën drejtimin e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore, siguron mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit MSH-H për çdo vit akademik. Gjatë verifikimit të disa dosjeve përzgjedhur në mënyrë rastësore, u konstatua se informacioni i raportuar është i saktë, i plotë dhe i harmonizuar me formatin standard të miratuar. Gjithashtu, përgjegjësi i departamentit përkatës është i ngarkuar me detyrën për të mbledhur, përditësuar dhe arkivuar çdo vit CV-të e stafit akademik dhe administrativ të përfshirë në këtë program. Shtojca- 1.10. Manuali per punesimin e personelit ne UT.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të	Institucioni, përmes bashkëpunimeve me universitete të tjera, biznese dhe kompani, siguron personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për të udhëhequr dhe mbikëqyrur studentët gjatë praktikës profesionale, përgatitjes së diplomës dhe aktiviteteve të ngjashme. Ky personel ndihmon studentët në zhvillimin e aftësive profesionale dhe krijon lidhje me tregun e punës, sipas kërkesave të programit. Praktika profesionale zhvillohet në bazë të marrëveshjeve me institucione dhe subjekte të ndryshme dhe është pjesë e programit si lëndë plotësuese , sipas rregullores dhe akteve ligjore në fuqi.

kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Shtojca- 1.10. Manuali per punesimin e personelit ne UT.			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Bazuar në raportin e vetëvlerësimit dhe vizitën në institucion, grupi i vlerësimit konstatoi se personeli akademik i njësisë përkatëse është i angazhuar në mbikëqyrjen e studentëve gjatë zhvillimit të praktikës profesionale në institucionet pritëse, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit. Në përfundim të praktikës, mbikëqyrësi në institucionin pritës përgatit një raport për vlerësimin e punës dhe arritjeve të studentit gjatë praktikës. E gjithë procedura rregullohet nga Rregullorja e njësisë bazë.			
Konkluzione	<i>Grupi i vlerësimit konstaton se institucioni respekton kërkesat për angazhimin e personelit akademik në përputhje me nivelin e nevojshëm të kualifikimit.</i> <i>Ky personel është i përfshirë në mbikëqyrjen e praktikave profesionale të studentëve, në bashkëpunim me institucionet partnere.</i>			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Grupi i vlerësimit konstaton se institucioni ofron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Këto mjedise janë të organizuara në përputhje me numrin e studentëve, ndarjen në grupe dhe natyrën e moduleve të ofruara. Hapësirat janë të pajisura dhe të strukturuar për të përmbushur nevojat e mësimdhënies dhe të të nxënit, duke krijuar kushte që mbështesin zhvillimin e një mësimi cilësor, efektiv dhe të orientuar drejt studentit. Shtojca- Të dhëna për infrastrukturën, Mjediset e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Institucioni ofron mjedise mësimore të përshtatshme dhe të pajisura mirë për zhvillimin e procesit akademik. Klasat, laboratorët, studiot dhe hapësirat e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe teknologji informacioni që mbështesin mësimdhënien moderne Në këto ambiente përdoren kompjuterë, projektorë, pajisje interaktive dhe mjete të tjera që lehtësojnë integrimin e metodave bashkëkohore në procesin mësimor. Institucioni garanton akses të qëndrueshëm në internet, si përmes rrjetit kabllor ashtu edhe ëireless, në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jashtme, duke i mundësuar studentëve dhe stafit një përvojë fleksibile dhe të lidhur me burimet digjitale. Infrastruktura përfshin gjithashtu një Qendër të Formimit të Vazhduar, e pajisur me teknologji bashkëkohore si laptopë, Smart TV, tabela inteligjente dhe pajisje të tjera që mbështesin zhvillimin profesional dhe aktivitetet trajnuese.

	Shtojca- Të dhëna për infrastrukturën, Mjediset e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita në institucion u vlerësua se hapësirat praktike, përfshirë laboratorët, studiot dhe atelietë, janë të përshtatura me karakterin dhe kërkesat e programeve të studimit. Këto mjedise janë të pajisura me teknologji dhe mjete që mundësojnë zhvillimin e moduleve në mënyrë efikase, duke kombinuar përmbajtjen teorike me atë praktike. Pajisjet e përdorura janë moderne dhe të orientuara drejt mbështetjes së studentëve në përvetësimin e aftësive të nevojshme për fushën përkatëse. Struktura dhe funksionaliteti i këtyre ambienteve krijojnë kushte që studentët të ushtrojnë dhe aplikojnë njohuritë e fituara në situata të afërta me realitetin profesional, duke i përgatitur ata në mënyrë të plotë për integrim në tregun e punës. Shtojca- Të dhëna për infrastrukturën, Mjediset e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni ofron ambiente të dedikuara për zhvillimin e aftësive digjitale, përfshirë laboratorë të teknologjisë së informacionit të pajisur me softuerë profesionalë në përputhje me profilin e programeve të studimit. Gjithashtu, mjediset e punës të stafit akademik dhe ndihmës akademik janë të pajisura me mjete të nevojshme teknologjike dhe infrastrukture që mbështesin përmbushjen e funksioneve të tyre në procesin mësimor dhe akademik.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe	Institucioni, në bazë të kapaciteteve që disponon, siguron mjedise të përshtatshme dhe të dedikuara për zhvillimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteve të tjera praktike, në funksion të përmbajtjes dhe objektivave të programeve të studimit. Përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe organizata të jashtme, studentëve u ofrohet mundësia të përfshihen në mjedise reale pune, duke zhvilluar aftësitë praktike dhe profesionale në përputhje me fushën e tyre të studimit. Këto bashkëpunime shërbejnë gjithashtu si burim feedback-u për të reflektuar mbi përmbajtjen e programeve dhe për të identifikuar mundësi për përmirësim të

veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	mëtejshëm.Ndërkohë, strukturat mbështetëse të institucionit, si qendrat e karrierës dhe shërbimet për studentë e alumni, luajnë një rol aktiv në informimin dhe orientimin e studentëve për mundësitë e trajnimit, praktikave dhe punësimit në bashkëpunim me partnerë të jashtëm.			
Konkluzione	Shtojca- 2.17.3. Raport vjetor i Departamentit të Historisë 2023-2024			
	<i>Grupi i vlerësimit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në vëzhgimin gjatë vizitës në institucion, konstaton se Departamenti i Historisë, në kuadër të Universitetit të Tiranës, disponon mjedise të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe administrative.Këto ambiente janë të pajisura me infrastrukturën dhe mjetet teknologjike të nevojshme, duke krijuar kushte të favorshme për një proces akademik profesional dhe efektiv.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi IV.3				
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, grupi i vlerësimit konstatoi se ofrohet literaturë bazë dhe ndihmëse në përputhje me kërkesat e programeve të studimit, duke mbështetur përvetësimin e njohurive teorike dhe praktike nga studentët. Fondi i literaturës është i organizuar sipas moduleve dhe mbulon aspekte të rëndësishme për zhvillimin akademik të studentëve.Institucioni parashikon fonde të dedikuara në buxhetin vjetor për pasurimin e bibliotekave me botime të përzgjedhura nga stafi akademik, të cilat shfrytëzohen për hulumtime, detyra kursi, projekte dhe punime diplome. Studentëve u ofrohet akses në materiale të ndryshme përmes bibliotekave fizike të fakulteteve, bibliotekës shkencore, si dhe burimeve online të rekomanduara nga pedagogët.Gjithashtu, në			

	kuadër të investimeve për përmirësimin e qasjes në literaturë bashkëkohore, biblioteka shkencore përfiton akses në platforma ndërkombëtare të njohura, si p.sh. JSTOR, falë mbështetjes së projekteve partnerë. Shtojca- 2.17.3. Raport vjetor i Departamentit të Historisë 2023-2024
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Grupi i vlerësimit ka vërejtur se njësia përgjegjëse ka vënë në funksion një proces të qëndrueshëm dhe të mirëstrukturuar për përditësimin e literaturës akademike. Kjo siguron që bibliotekat të pajisen rregullisht me botime dhe materiale të reja, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në fushat përkatëse të studimit. Falë këtij mekanizmi, studentët dhe stafi akademik kanë mundësi të qasen në burime të përditësuara dhe relevante, të cilat mbështesin procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Gjithashtu, rishikimi i përmbajtjes mësimore nëpërmjet syllabuseve bëhet në baza vjetore nga personeli përkatës dhe miratohet nga strukturat përkatëse brenda njësive akademike, duke garantuar përputhshmëri me standardet dhe nevojat e programeve.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Grupi i vlerësimit konstaton se institucioni garanton akses të barabartë për studentët në bibliotekën mësimore, e cila është në dispozicion për shfrytëzim nga të gjithë pjesëmarrësit në programet e studimit. Biblioteka është e hapur dhe e aksesueshme në orare të përshtatshme, duke u mundësuar studentëve përdorimin e materialeve shkencore dhe didaktike pa kufizime apo diferencime. Fondi i saj përmban literaturë të përshtatur për nevojat e programeve përkatëse, përfshirë botime shkencore, fjalorë tematikë dhe vepra letrare, të cilat mund të konsultohen në vend ose të huazohen për periudha të përcaktuara. Ky sistem siguron mbështetje të vazhdueshme për procesin e të nxënies dhe kërkimin akademik të studentëve. Shtojca- 2.28. Rregullore e Bibliotekës së FHF
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore	Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se biblioteka disponon një fond të pasur dhe të përshtatshëm me literaturë, i cili përfshin tekste bazë, literaturë ndihmëse, si dhe botime dhe

bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	revista shkencore që mbulojnë të gjitha modulet dhe aktivitetet mësimore të programeve të studimit. Materialet janë të disponueshme si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhë të huaja, duke mbështetur kërkesat akademike dhe specifikat e fushave të ndryshme të studimit. Ky fond siguron akses të gjerë dhe cilësor për studentët dhe stafin akademik, duke krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare që përputhen me zhvillimin e procesit mësimor dhe janë të përshtatura me nevojat e përdoruesve dhe kapacitetet e saj funksionale. Ajo ofron shërbim gjatë ditëve të javës, dhe orari i aksesit është i publikuar në mënyrë të qartë për të gjithë. Përdorimi i bibliotekës organizohet përmes sistemit të regjistrimit dhe kartelave përkatëse, duke u mundësuar studentëve qasje në materiale për studim, kërkime, dhe për realizimin e detyrave dhe projekteve akademike në mënyrë të strukturuar dhe të barabartë.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Grupi i vlerësimit konstaton se institucioni garanton akses të barabartë për studentët në bibliotekën mësimore, e cila është në dispozicion për shfrytëzim nga të gjithë pjesëmarrësit në programet e studimit. Biblioteka është e hapur dhe e aksesueshme në orare të përshtatshme, duke u mundësuar studentëve përdorimin e materialeve shkencore dhe didaktike pa kufizime apo diferencime. Fondi i saj përmban literaturë të përshtatur për nevojat e programeve përkatëse, përfshirë botime shkencore, fjalorë tematikë dhe vepra letrare, të cilat mund të konsultohen në vend ose të huazohen për periudha të përcaktuara. Ky sistem siguron mbështetje të vazhdueshme për procesin e të nxënies dhe kërkimin akademik të studentëve.
Shtojca- 2.28. Rregullore e Bibliotekës së FHF	
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare	Gjatë vizitës në institucion, grupi i vlerësimit konstatoi se biblioteka digjitale e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës ofron akses në disa baza të dhënash

shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	shkencore, ku studentët dhe personeli akademik mund të regjistrohen përmes një llogarie unike. Përveç kësaj, përdoruesit kanë në dispozicion një fond të pasur librash të dhuruar nga institucione ndërkombëtare si Instituti Gëte, si dhe pajisje të teknologjisë së avancuar si Smart-Board, të cilat mbështesin procesin mësimor në mënyrë interaktive. Biblioteka shkencore dhe ajo e fakultetit janë të pajisura me salla studimi dhe kompjuterë të lidhur me internet, duke krijuar mundësi për punë individuale dhe në grup. Kompjuterët janë të pajisur me programe bazë që përdoren në funksion të realizimit të detyrave akademike sipas kërkesave të lëndëve.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Bazuar në raportin e vetëvlerësimit, dokumentacionin përkatës dhe vëzhgimin gjatë vizitës në institucion, grupi i vlerësimit konstatoi se personeli i bibliotekës është i angazhuar në raportimin dhe përditësimin e rregullt të fondit fizik dhe atij elektronik të literaturës. Ky proces siguron që burimet bibliografike të jenë të azhornuara dhe në përputhje me nevojat akademike të studentëve dhe stafit mësimdhënës, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Biblioteka, në bashkëpunim me strukturat përkatëse akademike, monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme cilësinë dhe përmbajtjen e fondit letrar, përfshirë titujt kyç që përmbushin kërkesat e programeve të studimit.
Konkluzione	<i>Grupi i vlerësimit vlerëson se institucioni ka krijuar kushte të përshtatshme për sigurimin e burimeve që mbështesin zhvillimin e procesit mësimor dhe veprimtarinë kërkimore.</i> <i>Biblioteka ofron një fond të pasur materialesh, si në format fizik ashtu edhe elektronik, të cilat janë në përputhje me kërkesat e programeve të studimit dhe janë të aksesueshme në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në bazë të dokumentacionit të ofruar dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se sekretaria mësimore është përgjegjëse për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët, duke mbuluar proceset që fillojnë nga regjistrimi dhe vazhdojnë deri në diplomim. Gjatë takimit në sekretarinë e programit, u shqyrtuan regjistrat e studentëve dhe një dosje e zgjedhur nga programi i studimit, e cila përmbante informacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Institucioni ruan dokumentet si në formë fizike (hard copy), ashtu edhe në mënyrë elektronike, duke garantuar akses të sigurt dhe të qëndrueshëm në të dhënat e studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve. Shtojca- 2.17.3. Raport vjetor i Departamentit të Historisë 2023-2024
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ ka vlerësuar se menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit për personelin akademik, ndihmës akademik, administrativ si dhe për studentët realizohet në mënyrë efikase nga Zyra e Burimeve Njerëzore e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë. Kjo zyrë siguron akses të shpejtë dhe të sigurt në informacion për të gjithë personelin, si dhe ndihmon në përmirësimin e efikasitetit në koordinimin e aktiviteteve të ndryshme akademike. Të dhënat ruhen dhe përditësohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë	Në takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se administrimi i të dhënave nga ana e stafit akademik është efikas dhe studentëve u ofrohet mundësia për të marrë informacion në kohë reale. Janë përmirësuar ndjeshëm shërbimet e sekretarisë, duke u lehtësuar proceset e hedhjes dhe

personelin dhe studentët e programit të studimit.	ruajtjes së të dhënave, si dhe paraqitja online e informacionit lidhur me grafikun e provimeve, rezultatet, kreditet, kurrikulën dhe programet lëndore. Të gjitha këto procese zhvillohen në përputhje me Rregulloren e Universitetit të Tiranës për mbrojtjen e të dhënave.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Universiteti i Tiranës përdor një sistem elektronik të brendshëm, së bashku me platformën Microsoft Teams, për menaxhimin dhe komunikimin efikas me studentët dhe stafin. GVJ ka konstatuar, si nga analiza e dokumentacionit ashtu edhe nga vizita në institucion, se këto mjete ofrojnë një platformë të qëndrueshme dhe interaktive për ruajtjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave të lidhura me stafin dhe studentët. Përveç kësaj, Universiteti i Tiranës publikon informacion në faqen e tij zyrtare, e cila përditësohet rregullisht dhe përfshin Programin e Transparencës. Kjo faqe ofron një gamë të gjerë informacioni, duke përfshirë kornizën ligjore të veprimtarisë së stafit akademik dhe administrativ, të dhënat mbi studentët, si dhe marrëdhëniet me publikun, palët e interesit dhe personat juridikë.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ ka konstatuar se në Universitetin e Tiranës është në funksion një sistem i brendshëm menaxhimi i cili garanton monitorim të detajuar dhe në kohë reale të aktiviteteve akademike dhe administrative. Përmes këtij sistemi dhe kanaleve të komunikimit zyrtar, të dhënat përpunohen dhe janë të disponueshme për organet dhe autoritetet drejtuese, duke ofruar raporte individuale dhe statistika të përditësuara. Kjo qasje siguron që të gjitha aktivitetet akademike dhe administrative të monitorohen dhe menaxhohen në mënyrë efikase, duke garantuar transparencë dhe mundësi për ndërhyrje të shpejta në rast nevojë. Kjo mënyrë administrimi kontribuon në një pasqyrë të qartë dhe të standardizuar të ecurisë së programeve dhe aktiviteteve përkatëse në nivel fakulteti dhe universiteti.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Universiteti i Tiranës publikon informacion të përditësuar në faqen e tij zyrtare, në gjuhën shqipe dhe angleze. Aty pasqyrohen të dhëna mbi fakultetet, departamentet, programet e studimit, stafin akademik dhe aktivitetet kërkimore-shkencore.

Konkluzione	<i>Universiteti i Tiranës përdor një sistem të brendshëm për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre akademik, duke garantuar monitorim në kohë reale dhe menaxhim efikas e transparent. Të gjitha informacionet mbi programet e studimit, stafin akademik dhe aktivitetet përkatëse publikohen në faqen zyrtare të universitetit në gjuhën shqipe dhe angleze.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga takimi i zhvilluar në institucion dhe evidencat e depozituara, konstatohet se njësia bazë funksionon në përbërje të njësisë kryesore, pa pasur buxhet të individualizuar në kuptimin e njësisë shpenzuese. Universiteti i Tiranës siguron një mbështetje të qëndrueshme financiare për zhvillimin e programeve të studimit përmes një kombinimi burimesh financiare. Krahas fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit në formën e transfertës së pakushtëzuar, të ardhurat kryesore për mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike dhe kërkimit shkencor gjenerohen nga tarifat e studentëve. Gjithashtu, sigurohen të ardhura shtesë përmes shërbimeve, bashkëpunimeve me palë të treta, donacioneve dhe pjesëmarrjes në projekte kombëtare e ndërkombëtare. Buxheti financiar fillimisht diskutohet në kuadër të departamentit dhe më pas raportet përkatëse dërgohen në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit të Universitetit të Tiranës për shqyrtim dhe miratim. Shtojca- 2.17.3. Raport vjetor i Departamentit të Historisë 2023-2024

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentacionit se planifikimi financiar në Universitetin e Tiranës bazohet në strukturën buxhetore të shtetit, duke përfshirë shpenzimet nga granti buxhetor dhe të ardhurat e veta. Plani detajon të gjitha kategoritë e shpenzimeve, përfshirë ato operative, për burimet njerëzore dhe investimet në infrastrukturë e pajisje, duke përcaktuar qartë përparësitë për tre vitet në vijim. Universiteti i Tiranës ka ofruar raporte financiare të detajuara, përfshirë specifikimet përkatëse dhe dëshmi nga vitet e mëparshme.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Universiteti i Tiranës i nënshtrohet auditimeve të rregullta financiare. Auditimi i brendshëm kryhet nga strukturat përkatëse brenda institucionit, ndërsa auditimi i jashtëm realizohet në mënyrë periodike nga organet shtetërore përkatëse, përfshirë edhe Kontrollin e Lartë të Shtetit. UT përgatit çdo vit raportin financiar vjetor, i cili hartohet nga administratori dhe përfshin të gjithë elementët në përputhje me kërkesat ligjore për pasqyrat financiare. Ky raport shqyrtohet në analizën vjetore të institucionit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie. Shtojca- 2.32. Raporti Perfundimtar i Auditimit.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në Universitetin e Tiranës, në fund të çdo viti përpilohen pasqyrat financiare dhe rezultatet e auditimit prezantohen në analizat vjetore të punës. Këto takime organizohen me pjesëmarrjen e gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve, duke siguruar transparencë dhe përfshirje të grupeve të interesit.

Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Në përputhje me kuadrin rregullator, burimet financiare të Universitetit të Tiranës përfshijnë buxhetin e shtetit, tarifat e studentëve, të ardhurat nga shërbimet dhe marrëdhëniet me palë të treta, si dhe donacione apo projekte kërkimore. Në rast kërkesash për financim shtesë nga njësitë bazë, me miratimin e organeve drejtuese, mund të bëhen ndërhyrje në buxhetin e shpenzimeve për të garantuar vazhdimësinë dhe cilësinë e veprimtarisë akademike dhe kërkimore. UT gëzon qëndrueshmëri të mjaftueshme akademike dhe financiare.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Si institucion buxhetor, UT siguron qëndrueshmërinë financiare të nevojshme për zhvillimin dhe vijueshmërinë e programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, Statutin dhe Rregulloret e Universitetit të Tiranës, si dhe të dhënat e

procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	publikuara në faqen zyrtare të institucionit, GVJ konstaton se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore. Universiteti i Tiranës përcakton kriteret dhe procedurat për pranimin, transferimin dhe largimin e studentëve në bazë të rregullave të brendshme, të harmonizuara me legjislacionin dhe direktivat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Regjistrimi i studentëve zhvillohet sipas udhëzimeve përkatëse dhe mbi bazën e kuotave të përcaktuara nga Ministria, ndërsa studentët e pranuar pajisen me numër matrikullimi. Shtojca- 2.14. Politika te pranimi te studenteve.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në Statutin e tij, Universiteti i Tiranës zbaton politika të mundësive të barabarta për të gjitha programet e studimit. Institucioni i kushton rëndësi diversitetit dhe siguron pranimin e studentëve pa dallim race, feje, origjine etnike apo statusi personal. UT ka rregullore të posaçme dhe struktura të dedikuara për zbatimin e këtyre politikave, duke ngritur komisione përkatëse dhe duke garantuar kushte të barabarta për të gjithë. Gjithashtu, në nivel universiteti është ngritur Këshilli i Etikës për të mbrojtur të drejtat e studentëve dhe stafit.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Universiteti i Tiranës harton dhe publikon përpara fillimit të çdo viti akademik kriteret specifike për pranimin e studentëve në programet e studimit. Këto kriteret bazohen në rregulloret e brendshme, Statutin dhe vendimet e Senatit Akademik, duke siguruar një proces të qartë, të drejtë dhe të barabartë. Rregulloret përfshijnë gjithashtu dispozita të detajuara për transferimin e studentëve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Shtojca- 2.14. Politika te pranimi te studenteve.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme,	Universiteti i Tiranës ka të përcaktuara qartë kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Transferimi i studentëve realizohet sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret e brendshme dhe në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë. Gjatë takimeve me zyrën e informacionit dhe me studentët, u konfirmua se kandidatëve u bëhet e ditur në mënyrë të qartë

të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	dhe verbale çdo informacion i rëndësishëm për aplikimin dhe transferimin. Të gjitha kriteret janë të publikuara gjithashtu në faqen zyrtare të Universitetit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Universiteti i Tiranës informon publikun për programet e studimit përmes faqes zyrtare të internetit, e cila azhurnohet rregullisht me informacion mbi strukturën akademike, aktivitetet dhe kriteret e pranimit. Informimi plotësohet edhe përmes broshurave, guidës së universitetit dhe njoftimeve në media. Në zbatim të rekomandimeve të MARS, UT ofron mbështetje të veçantë edhe për studentët e huaj, përmes guidave të dedikuara në gjuhë të huaj. Shtojca- 2.16. Politika te mbështetjes, perkrahjes se studenteve dhe struktura e organizimit te tyre.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës parashikon kuota të veçanta pranimi për kategori të caktuara si kandidatë nga trojet, pakicat kombëtare, persona me aftësi të kufizuara dhe shtresa të marginalizuara. Kriteret dhe kuotat përkatëse publikohen çdo fillim viti akademik në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të universitetit.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit zyrtar, konstatohet se Universiteti i Tiranës harton dhe publikon kriteret për pranimin e kandidatëve nga shtete të tjera përpara fillimit të çdo viti akademik. Rregulloret dhe udhëzimet e brendshme përcaktojnë qartë procedurat dhe kushtet që duhet të plotësojnë studentët ndërkombëtarë, përfshirë edhe ata me prejardhje shqiptare jashtë kufijve. Informimi i kandidatëve realizohet përmes Zyrës së Karrierës si dhe publikimeve në faqen zyrtare të universitetit, në përputhje me udhëzimet e MAS.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Universiteti i Tiranës, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, njofton dhe ofron bursa apo përfitime financiare për studentët ekselentë dhe ata që ndjekin programe studimore prioritare në nivel kombëtar. UT ka rregullore të posaçme që përcakton qartë kriteret dhe procedurat për përfitimin e këtyre bursave, duke garantuar transparencë dhe mundësi të barabarta për të gjithë aplikantët e kualifikuar.

	Shtojca- 2.16. Politika te mbeshtetjes, perkrahes se studenteve dhe struktura e organizimit te tyre.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se, në kuadrin rregullator të Universitetit të Tiranës, parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme për pranimin e studentëve në të gjitha programet e studimit, si dhe ecuria e tyre deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e njohurive dhe mundësinë e transferimit nga ose drejt programeve të tjera. UT ka përcaktuar gjithashtu kuota pranimi për kategori të veçanta, si kandidatë nga trojet shqiptare, pakicat kombëtare dhe grupe të tjera në nevojë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në RVB, informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion dhe atë të publikuar në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni siguron akses të plotë për studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, si dhe me njohjen e kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Rregulloret e fakulteteve dhe programeve të studimit përcaktojnë qartë të gjitha aspektet e përparimit akademik dhe transferimit të krediteve, duke garantuar transparencë dhe lehtësim për studentët. Informacioni shpërndahet gjithashtu përmes faqes zyrtare të UT-së, rrjeteve sociale dhe Këshillit Studentor. Shtojca- 1.17. Rregullore e Komisionit te mbarevajtjes se veprimtarise dhe Marredhenieve me studentet.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe gjetjet nga vizita në institucion, GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës, përmes sekretarisë mësimore dhe në bazë të rregulloreve të fakultetit, informon dhe orienton studentët mbi njohjen e krediteve dhe kualifikimeve të mëparshme. Kriteret dhe procedurat për

mëparshme ose studimeve të pjesshme.	njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve përcaktohen në rregulloret përkatëse të njësive bazë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sekretaria e universitetit ka përgjegjësinë për zbatimin e këtyre procedurave dhe ofron informacion të detajuar për studentët në bashkëpunim me Zyrën e Informimit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në Universitetin e Tiranës, procesi i vlerësimit të studentëve është i strukturuar dhe i parashikuar qartë në syllabus-in e çdo lënde. Ky dokument u vihet në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri dhe përmban informacion të detajuar mbi format e vlerësimit, peshën e secilit komponent (si vlerësimi i vazhdueshëm dhe ai përfundimtar), si dhe kriteret e notave. Syllabus-i shërben si udhëzues zyrtar për studentin gjatë gjithë ciklit të lëndës, duke garantuar transparencë dhe pritshmëri të qarta. Përveç kësaj, platforma Microsoft Teams përdoret gjerësisht për komunikimin ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Ajo mundëson shpërndarjen e syllabus-it, materialeve mësimore, njoftimeve administrative, si dhe ndjekjen e progresit akademik. Teams shërben gjithashtu si mjet për konsultime dhe ndarje të vlerësimeve në mënyrë të organizuar dhe të aksesueshme. Shtojca- 1.17. Rregullore e Komisionit të mbarevajtjes së veprimtarisë dhe Marredhenieve me studentet.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në Universitetin e Tiranës, transparenca dhe aksesueshmëria në lidhje me kriteret dhe procedurat e diplomimit sigurohen nga sekretaria mësimore dhe koordinatori i programit të studimit. Informacioni përkatës është i disponueshëm përmes rregulloreve institucionale dhe udhëzimeve të publikuara në faqen zyrtare të universitetit. Rregullorja e programit dhe Udhëzuesi për Punimin e Temës së Diplomës përmbajnë udhëzime të qarta për të gjitha etapat e procesit të diplomimit, përfshirë përzgjedhjen e temës, caktimin e pedagogut udhëheqës, afatet kohore dhe mënyrën e dorëzimit të punimit. UT ofron gjithashtu një guidë të plotë që ndihmon studentët në ndërtimin dhe hartimin e një teme diplome sipas standardeve akademike. Shtojca- 2.22 Diploma Shtojca- 2.23. Suplementi i Diplomes.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Koordinatori i programit luan një rol kyç në informimin dhe promovimin e programit Master i Shkencave në “Histori” për të gjitha kategoritë e kandidatëve. Kjo realizohet përmes strategjive të dedikuara promovuese, të cilat përfshijnë: • Takime informuese me maturantë dhe studentë të viteve të fundit të programeve Bachelor në fusha të ngjashme, duke theksuar përfitimet dhe mundësitë profesionale të programit; • Aktivitete të përbashkëta me shkolla të mesme dhe fakultete të tjera, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe interesimit për programin; • Hartimin dhe shpërndarjen e broshurave informuese në kuadër të prezantimeve dhe fushatave të promovimit. Në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, informimi i studentëve për kriteret dhe procedurat e pranimit mbështetet gjithashtu nga Zyra e Këshillimit në Karrierë, e cila ofron udhëzime të detajuara për kandidatët e interesuar.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës siguron akses të plotë për studentët mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, si dhe mbi procesin e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Studentët kanë gjithashtu në dispozicion informacion të detajuar mbi kriteret e vlerësimit të njohurive në kuadër të programit të studimit dhe mbi procedurat që lidhen me procesin e diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe	Në Universitetin e Tiranës, informimi i studentëve realizohet nëpërmjet Rregullores së Fakultetit, broshurave informuese, materialeve të dedikuara dhe platformës zyrtare të universitetit. Procesi nis që në javën e parë të vitit akademik dhe vijon

kohëzgjatjen e programit të studimit.	përmes takimeve informuese të organizuara nga departamenti dhe Qendra për Këshillim dhe Karrierë. Studentët marrin informacion mbi strukturën e programit dhe mundësitë akademike përmes syllabus-eve të detajuara dhe materialeve shtesë, të cilat janë të disponueshme si në formë fizike, ashtu edhe në mënyrë dixhitale. Përveç kësaj, informacioni publikohet edhe në monitorët dhe stendat e vendosura në ambientet e fakultetit. Për çdo sqarim të mëtejshëm, studentët mund t'i drejtohen Qendrës së Informimit të Studentëve dhe sekretarisë së departamentit përkatës. Shtojca- 2.16. Politika te mbështetjes, perkrahjes se studenteve dhe struktura e organizimit te tyre
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në Universitetin e Tiranës, studentëve u ofrohet gjithë informacioni i nevojshëm që në javën e parë të vitit akademik. Syllabuset dhe materialet orientuese janë të disponueshme si në formë elektronike, ashtu edhe në version të printuar përmes Guidës së Studentit, e cila u shpërndahet studentëve në fillim të studimeve. Ditët e para shërbejnë si javë orientuese, gjatë së cilës çdo pedagog prezanton përmbajtjen dhe organizimin e modulit të tij përpara studentëve. Studentët mund të marrin informacione shtesë edhe përmes takimeve me pedagogët dhe koordinatorin e programit, i cili u sqaron mbi akreditimin e programit, vlefshmërinë e diplomës dhe strukturën e studimeve. Gjithashtu, përmes llogarive të tyre në sistemin elektronik, ata kanë akses në informacion të detajuar mbi kurrikulën, kreditet, modulet, semestret dhe çdo komponent tjetër të rëndësishëm akademik.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në strukturën e Universitetit të Tiranës funksionon Qendra për Këshillim në Karrierë dhe ALUMNI, e cila ka për mision të ofrojë shërbime mbështetëse për studentët, të diplomuarit dhe stafin akademik, me synim përmirësimin e cilësisë së edukimit dhe përgatitjen për tregun e punës pas përfundimit të studimeve. Ndër shërbimet e ofruara përfshihet edhe mentorimi individual, që synon të mbështesë studentët gjatë momenteve kyçe të rrugëtimit akademik, duke ofruar këshillim personal dhe orientim për praktika profesionale. Në ditët e para të vitit akademik, studentët orientohen nga specialistët e Qendrës së Këshillimit në Karrierë, të cilët i informojnë mbi mundësitë për zhvillim profesional dhe

	punësim pas diplomimit. Koordinatorët e programeve japin gjithashtu informacion të detajuar në takimet hyrëse me studentët. Shtojca- 2.25. Aktivitete te Zyres se Keshillimit te Karrieres
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në Universitetin e Tiranës, studentët dhe kandidatët marrin informacion të detajuar për ambientet, logjistikën institucionale dhe shërbimet e ofruara që në fillim të programit, përmes vizitave orientuese dhe materialeve informuese. Këto informacione janë të publikuara gjithashtu në faqen zyrtare të universitetit dhe në stendat informuese të vendosura në departamente. Gjatë javës së parë të vitit akademik, në kuadër të ditëve të hapura, koordinatorët e programeve dhe strukturat mbështetëse akademike prezantojnë përmbajtjen e lëndëve dhe shërbimet që ofrohen për studentët. Studentët informohen rregullisht edhe nga sekretaria e universitetit, e cila është në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm gjatë gjithë vitit akademik.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në Universitetin e Tiranës, të gjithë studentëve të regjistruar u ofrohet një emër përdoruesi dhe fjalëkalim personal, që u mundëson aksesin në sistemin e brendshëm elektronik të menaxhimit akademik. Përmes këtij sistemi, studentët mund të konsultojnë në kohë reale notat, mungesat, dhe situatën e tyre financiare, duke pasur akses të vazhdueshëm kudo ku ka lidhje interneti. Gjithashtu, UT zbaton praktikën e Ditëve të Hapura, ku përfaqësues të strukturave mbështetëse dhe akademike informojnë studentët për përdorimin e platformave digjitale dhe shërbimeve të tjera universitare që lidhen me ecurinë e tyre akademike.
Konkluzione	<i>Në Universitetin e Tiranës, struktura dhe organizimi i programeve të studimit janë të qarta dhe të aksesueshme për studentët në mënyra të ndryshme. Informacioni për ofrimin e programeve dhe përmbajtjen e tyre akademike shpërndahet nëpërmjet faqes zyrtare të fakulteteve, broshurave informuese, si dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me koordinatorët e programeve.</i> <i>Për të lehtësuar integrimin e studentëve dhe për të ndihmuar në zhvillimin e tyre profesional, UT organizon në mënyrë të rregullt ditë informuese, takime orientuese, si dhe veprimtari të</i>

	<i>dedikuara për promovimin e mundësive që ofron programi. Këto iniciativa synojnë të rrisin ndërgjegjësimin e studentëve mbi ecurinë akademike dhe perspektivat pas diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Në Universitetin e Tiranës, të gjitha të dhënat që lidhen me regjistrimin, transferimet dhe diplomimet e studentëve administrohen dhe ruhen në mënyrë të strukturuar nga Zyra e Protokoll-Arkivës dhe sekretaria mësimore. Këto të dhëna janë të dokumentuara si në formë elektronike, përmes sistemit përkatës të menaxhimit akademik, ashtu edhe në formë fizike, duke garantuar ruajtjen dhe aksesueshmërinë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. UT i kushton rëndësi statistikave mbi diplomimin dhe punësimin e studentëve, si tregues të performancës akademike dhe ndikimit të programeve të studimit në tregun e punës. Për këtë qëllim, përpilohet raportim i rregullt mbi ecurinë e të diplomuarve dhe integrimin e tyre profesional, në bashkëpunim me strukturat përkatëse si Qendra për Këshillim në Karrierë. Numri i studentëve të regjistruar për programin e studimit: Master i Shkencave në: "Histori" për dy vite akademike është si më poshtë: V.a 2022-2023: 6 studentë V.a 2023-2024: 15 studentë
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e	Në Universitetin e Tiranës, sekretaria mësimore ka një funksion qendror në administrimin e të gjitha proceseve që lidhen me ciklin e plotë të jetës studentore – që nga regjistrimi fillestar e deri te diplomimi. Ajo është përgjegjëse për

studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	organizimin, mbajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit dhe të dhënave të studentëve, duke garantuar ruajtjen e tyre në mënyrë të sigurt dhe të strukturuar, si në formë fizike ashtu edhe elektronike. Gjithashtu, kjo strukturë siguron që të gjitha informacionet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të jenë të disponueshme për qëllime raportimi institucional apo analiza të brendshme. Ecuria akademike e çdo studenti monitorohet dhe arkivohet që nga momenti i pranimit në universitet, gjatë gjithë viteve të studimit, deri në përfundimin me sukses të programit dhe pajisjen me diplomë. Shtojca- 1.17. Rregullore e Komisionit të mbarevajtjes së veprimtarisë dhe Marredhenieve me studentet.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në Universitetin e Tiranës, ruajtja dhe përpunimi i të dhënave të studentëve realizohet në përputhje të plotë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Të gjitha dokumentet dhe informacionet që lidhen me regjistrimin, ndjekjen e studimeve dhe ecurinë akademike të studentëve ruhen si në format fizik, ashtu edhe në mënyrë elektronike. Sistemi elektronik i menaxhimit akademik, i përdorur nga universiteti, siguron një ndjekje të personalizuar dhe konfidenciale të rezultateve dhe të progresit akademik të çdo studenti. Çdo informacion i ngarkuar në sistem i nënshtrohet standardeve të konfidencialitetit dhe sigurisë, duke garantuar që të dhënat e studentëve të mos jenë të aksesueshme nga persona të paautorizuar.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretarët mësimorë, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Në Universitetin e Tiranës, monitorimi i vazhdueshëm i njësive përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe veprimtarive akademike është pjesë e rëndësishme e sistemit të brendshëm të cilësisë. Struktura përkatëse brenda UT-së, e cila përfshin njësi si Sektori i Kurrikulës, Alumni dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), ndjek në mënyrë të rregullt zbatimin e standardeve dhe planifikon përmirësime të vazhdueshme. Këto struktura hartojnë dhe përditësojnë raporte periodike që përfshijnë të dhëna mbi regjistrimet, ndjekjen akademike dhe nivelin e punësimit të studentëve pas diplomimit. Universiteti i Tiranës evidenton një përqindje të lartë të studentëve që punësohen menjëherë pas përfundimit të studimeve, çka dëshmon për përshtatshmërinë e programeve të tij me kërkesat

	e tregut të punës. Të gjitha të dhënat dhe analizat përfshihen në raporte që shërbejnë si bazë për vendimmarrje institucionale.			
	Shtojca- 1.5. Rregullore per funksionimin e NjSBC			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në Universitetin e Tiranës, përkatësisht në njësitë përbërëse si fakultetet dhe departamentet (si Departamenti i Historisë), realizohet në mënyrë të vazhdueshme hartimi dhe analizimi i raporteve periodike mbi veprimtarinë akademike dhe arritjet studentore. Këto raporte përfshijnë të dhëna analitike për regjistrimet, përparimin dhe diplomimet, duke vlerësuar gjithashtu sfidat dhe mundësitë e punësimit pas diplomimit. Të dhënat e grumbulluara përdoren për të vlerësuar cilësinë e programeve të studimit, për të identifikuar nevojat për përmirësime dhe për të siguruar një përputhje më të mirë me kërkesat e tregut të punës. Për më tepër, Zyra për Këshillim në Karrierë harton raporte specifike mbi fushat e punësimit të studentëve dhe perspektivat profesionale, duke mbështetur kështu vendimmarrjen strategjike në nivel institucional dhe ndihmuar studentët në orientimin e tyre pas studimeve.			
	Shtojca- 2.25. Aktivitete te Zyres se Keshillimit te Karrieres.			
Konkluzione	<i>Departamenti i Historisë në Universitetin e Tiranës harton në mënyrë periodike raporte që përmbajnë statistika vjetore të detajuara mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar dhe atyre që kanë kryer transferime studimore. Të dhënat administrohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, i cili u ofron akses të kontrolluar vetëm personave të autorizuar. Ky sistem garanton ruajtjen dhe përpunimin e informacionit në përputhje të plotë me standardet ligjore për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo praktikë siguron transparencë dhe integritet në menaxhimin e proceseve akademike dhe administrative brenda departamentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Ab.
[Signature]

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në Universitetin e Tiranës, përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese është një aspekt i rëndësishëm i qeverisjes institucionale, i cili realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet normative të brendshme të UT. Studentët kanë përfaqësues të zgjedhur në organet më të larta të universitetit, përfshirë: • Senatin e Universitetit; • Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë; • Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës; • Këshillin e Etikës; • Këshillin e Studentëve. Këshilli i Studentëve është një organizatë e pavarur e përbërë nga studentë të zgjedhur, që përfaqësojnë interesat e studentëve në nivel fakulteti dhe universiteti. Përmes këtij angazhimi, studentët kontribuojnë në mënyrë aktive në hartimin e politikave akademike dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimet institucionale. Shtojca- 1.16. Rregullore per zgjedhjet e para te Keshillave te Studenteve ne UT
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në Universitetin e Tiranës, pjesëmarrja e studentëve në proceset vendimmarrëse, këshilluese dhe vlerësuese është e garantuar dhe e institucionalizuar nëpërmjet akteve rregullatore dhe kuadrit ligjor në fuqi. UT siguron përfaqësimin e studentëve në: • Senatin Akademik, ku kontribuojnë në hartimin e politikave të përgjithshme të universitetit; • Komisionet për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë, ku studentët janë pjesë e grupit të punës për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB); • Këshillin e Etikës, ku përfaqësuesit studentorë ndihmojnë në mbrojtjen e parimeve etike brenda komunitetit akademik.

	Ky përfaqësim garanton që zëri i studentëve të dëgjohej dhe të merret në konsideratë në çdo proces të rëndësishëm institucional, duke fuqizuar rolin e tyre në jetën universitare dhe në sigurimin e cilësisë së arsimit të lartë.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Në Universitetin e Tiranës, studentët janë të përfshirë aktivisht në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve akademike përmes pjesëmarrjes së tyre në struktura të rëndësishme si: • Senati Akademik; • Komisionet për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; • Komisionet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave. Përveç kësaj, përmes pyetësorëve periodikë të organizuar nga Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), të gjithë studentët kontribuojnë në vlerësimin e lëndëve, metodologjisë mësimore dhe performancës së stafit pedagogjik. Këto feedback-e përpunohen dhe analizohen në mënyrë të strukturuar për të nxitur përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përshtatjen e kurrikulave me nevojat e studentëve dhe tregut të punës. Ky bashkëpunim ndërmjet studentëve dhe strukturave të UT-së përforcon një kulturë të vazhdueshme të përmirësimit cilësor dhe pjesëmarrjes së informuar. Shtojca- 1.16. Rregullore për zgjedhjet e para të Keshillave të Studenteve në UT
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësive/pedagogut përgjegjës.	Në Universitetin e Tiranës, studentët kanë të drejtën të shprehin shqetësimet dhe pakënaqësitë e tyre lidhur me procesin e mësimdhënies apo vlerësimit përmes një strukture të qartë ankimi dhe diskutimi. Në përputhje me rregulloren e institucionit, studenti ka mundësinë të paraqesë ankesë me shkrim pranë dekanatit brenda afatit të përcaktuar pas publikimit të notës. Dekani, në bashkëpunim me pedagogun përkatës dhe strukturat akademike, shqyrton objektivistisht kërkesën dhe merr masa të nevojshme nëse konstatohen mangësi apo padrejtësi në vlerësim. Përveç kësaj, përmes forumeve të hapura, diskutimeve me pedagogët dhe pyetësorëve institucionalë, studentët kontribuojnë në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor. Ky mekanizëm i

	hapur dhe i strukturuar garanton transparencë, besueshmëri dhe përfshirje të studentëve në jetën akademike.			
Konkluzione	<i>Departamenti i Historisë në Universitetin e Tiranës parashikon dhe inkurajon përfshirjen e studentëve në proceset vendimmarrëse që lidhen me hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, metodologjisë së mësimdhënies si dhe cilësisë së burimeve dhe shërbimeve të ofruara për studentët. Studentët përfaqësohen në komisione dhe struktura përkatëse, duke pasur mundësinë të kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së arsimit.</i> <i>GVJ konstaton se kjo përfshirje aktive e studentëve është një element thelbësor në funksionimin akademik të Departamentit të Historisë, duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe përshtatshmëri të vazhdueshme të programeve me nevojat e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Departamenti i Historisë në Universitetin e Tiranës, në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Informimit, Këshillimit të Karrierës dhe stafin akademik, ka krijuar një mekanizëm të mirëfunksionues të komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit për studentët. Ky bashkëpunim siguron që studentët të informohen në kohë reale për të gjitha aspektet që lidhen me studimet, zhvillimet akademike dhe mundësitë profesionale. Informacioni ofrohet në mënyrë të qasshme përmes platformave digjitale të UT-së, uebfaqes zyrtare, si dhe materialeve fizike si broshura dhe fletëpalosje. Shtojca- 2.25. Aktivitete te Zyres se Keshillimit te Karrieres
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë	Universiteti i Tiranës ka ndërtuar një sistem të organizuar dhe gjithëpërfshirës për informimin, këshillimin dhe mbështetjen e

funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve. Në nivel qëndror, në Rektoratin e UT-së funksionon një zyrë për komunikimin me publikun, e cila trajton çështje që lidhen me transparencën dhe aksesin në informacion për studentët dhe palët e interesuara. Studentët marrin mbështetje të vazhdueshme nga sekretaritë mësimore dhe stafi akademik në fakultetet përkatëse, të cilët janë të angazhuar për t'i udhëhequr në çdo hap të rrugëtimit të tyre akademik. Kjo përfshin ndihmën për çështje të regjistrimit, programit të studimit, kërkesave akademike si dhe mundësive të zhvillimit personal e profesional. GVJ vlerëson se ky sistem i integruar funksionon në mënyrë efektive, duke ofruar një mjedis mbështetës për studentët, si në aspektin akademik ashtu edhe në orientimin e tyre profesional, dhe përmirëson ndjeshëm përvojën studentore në Universitetin e Tiranës.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë në Universitetin e Tiranës ka të krijuar një mekanizëm funksional për këshillimin e karrierës, duke angazhuar një këshilltar karriere me kohë të plotë, i cili ofron mbështetje të strukturuar dhe të vazhdueshme për studentët. Këshilltari i karrierës është në dispozicion për të ofruar orientim mbi mundësitë për zhvillim profesional, praktika në institucionet partnere dhe këshilla të personalizuar për integrimin në tregun e punës. Ajo bashkëpunon ngushtë me studentët për t'i ndihmuar në përcaktimin e objektivave të tyre afatshkurtra dhe afatgjata dhe në përgatitjen për sfidat profesionale pas diplomimit. GVJ vlerëson se angazhimi i këshilltarit të karrierës në këtë fakultet është një praktikë e mirë që ndihmon ndjeshëm studentët në orientimin profesional, përgatitjen për tregun e punës dhe rritjen e punësueshmërisë së tyre pas përfundimit të studimeve.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion	Në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni mban një bazë të dhënash të detajuar që përfshin statistika dhe raporte vjetore mbi studentët e diplomuar në të gjitha programet e studimit. Këto të dhëna përfshijnë informacion mbi statusin e punësimit të të diplomuarve, fushat përkatëse të punësimit dhe institucionet ku ata janë integruar profesionalisht.

studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Përmes bashkëpunimit me ish-studentët (Alumni), si dhe kontakteve të rregullta me institucione publike e private, zyra arrin të ndjekë rrugëtimin profesional të studentëve dhe të përditësojë vazhdimisht informacionin mbi tregun e punës. Specialistja e karrierës luan një rol kyç në këtë proces, duke ruajtur komunikimin me të diplomuarit përmes e-mail-it, numrave të kontaktit dhe platformave të rrjeteve sociale. Kjo ndihmon në ndërtimin e një urë të qëndrueshme komunikimi dhe bashkëpunimi mes universitetit dhe tregut të punës.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se në Departamentin e Historisë të Universitetit të Tiranës janë ngritur struktura të posaçme për informimin dhe mbështetjen e studentëve. Ndër to, përmendet Zyra e Këshillimit të Karrierës, e cila jo vetëm ofron orientim profesional për studentët, por gjithashtu harton raporte periodike mbi punësimin e të diplomuarve, duke reflektuar ndikimin e programit në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës ka struktura dhe procedura të mirëpërcaktuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjinë institucionale. Në aktet rregullatore të universitetit si Statuti, Rregulloret e Fakulteteve, të Departamenteve dhe të programeve të studimit, përcaktohen qartë metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, si dhe mënyrat për integrimin

fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	e teknologji bashkëkohore. UT ka miratuar një strategji për periudhën 2022–2027 për zhvillimin e procesit mësimor, e cila synon të promovojë metodat inovative dhe studentin në qendër të mësimdhënies, përmes leksioneve interaktive, seminareve, praktikave dhe përdorimit të teknologjisë së informacionit. Shtojca- 1.23. Strategjia institucionale për mesimedhënien 2022-2027
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës zbaton mekanizma të qartë për vlerësimin e performancës dhe sigurimin e cilësisë. GVJ vlerëson se treguesit kryesorë monitorohen nëpërmjet raporteve të vetëvlerësimit, dokumentacionit të rregullt dhe anketave për studentët dhe stafin. Pyetësorët për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies realizohen në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillin Studentor, duke siguruar përfshirjen aktive të studentëve. Vlerësimi i stafit bëhet mbi bazën e angazhimit akademik dhe kërkimeve shkencore, sipas analizave modulare dhe vjetore, të strukturuar sipas manualit të cilësisë. Fakulteti është i angazhuar në promovimin e metodave bashkëkohore dhe inovative të mësimdhënies. Shtojca- 1.5. Rregullore për funksionimin e NjSBC
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies është një praktikë e qëndrueshme dhe e institucionalizuar. GVJ konstaton se studentët angazhohen përmes plotësimit të pyetësorëve të organizuar nga Këshilli i Studentëve dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, duke dhënë sugjerime dhe duke shprehur vërejtjet e tyre mbi procesin mësimor. Po ashtu, studentët kanë të drejtë të ankimojnë notën dhe mënyrën e vlerësimit sipas një procedure të parashikuar nga rregulloret përkatëse. Ata përfaqësohen në organet kryesore të vendimmarrjes si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisionet për Sigurimin e Cilësisë dhe Bordin Administrativ, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin	GVJ konstaton se në Universitetin e Tiranës, raportet e vlerësimit të stafit akademik përmes pyetësorëve të plotësuar

dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	nga studentët diskutohen në mbledhjet e dekanateve dhe në nivel departamenti, me qëllim identifikimin e nevojave për përmirësimin e kurrikulës, metodologjive të mësimdhënies dhe kushteve infrastrukturore. Në fund të çdo viti akademik, rezultatet e auditimeve prezantohen në analizat vjetore të hapura, ku marrin pjesë anëtarët e asamblesë akademike dhe përfaqësuesit e studentëve. Këto raporte dhe rezultate publikohen në faqen zyrtare të UT-së, duke garantuar transparencë dhe akses për të gjithë të interesuarit. Kjo praktikë kontribuon në një mjedis akademik të hapur, llogaridhënës dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm.
	Shtojca- 1.11. Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik në UT.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ vlerëson se, në Universitetin e Tiranës, raportet e vlerësimeve të personelit akademik diskutohen rregullisht në mbledhjet e dekanateve dhe departamenteve, duke nxitur reflektimin dhe shkëmbimin e praktikave të mira për përmirësimin profesional të stafit. UT mbështet zhvillimin akademik të stafit përmes mundësive për pjesëmarrje në studime brenda dhe jashtë vendit, përfshirë vitin sabbatik, dhe përmes përfshirjes në trajnime dhe diskutime shkencore të organizuara brenda kuadrit të projekteve ndërkombëtare. Universiteti inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen aktive të stafit në veprimtari që promovojnë kontributin e tyre akademik dhe kërkimor, si dhe ka krijuar nisma të posaçme, përfshirë Qendrën Virtuale të Trajnimeve, për të fuqizuar zhvillimin profesional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Departamenti i Historisë në Universitetin e Tiranës ka krijuar struktura të mirëorganizuara për të garantuar dhe promovuar cilësinë e mësimdhënies. Departamenti zbaton mekanizma të qartë për monitorimin dhe përmirësimin e performancës akademike të stafit pedagogjik, përmes përdorimit të pyetësorëve të vlerësimit nga studentët, analizave të brendshme periodike, dhe diskutimeve në mbledhjet e departamentit. Këto mekanizma shërbejnë jo vetëm për të evidentuar problematikat, por edhe për të ndarë praktikën e mira që rrisin cilësinë e mësimdhënies dhe të angazhimit akademik.</i>

	<i>Për më tepër, Departamenti inkurajon rritjen profesionale të stafit përmes pjesëmarrjes në trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me objektivat e Strategjisë së Mësimdhënies 2022–2027 të UT. Në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillin e Studentëve, ky departament ndjek rregullisht vlerësimin e moduleve dhe përpaket të integrojë metoda bashkëkohore të mësimdhënies që i vendosin studentët në qendër të procesit mësimor. Kjo qasje garanton një mjedis akademik gjithëpërfshirës dhe të përmirësuar në vazhdimësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Departamenti i Historisë në Universitetin e Tiranës funksionon brenda një strukture të qartë dhe të institucionalizuar për sigurimin e cilësisë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjinë zhvillimore të institucionit. Në këtë kuadër, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) luan një rol qendror në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Departamenti zbaton rregulloret përkatëse të miratuara nga UT, përfshirë Manualin e Cilësisë, Rregulloren për vlerësimin e performancës së personelit ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe Manualin e vlerësimit të performancës për personelin akademik. Këto dokumente përbëjnë bazën rregullatore për një proces transparent dhe objektiv të vlerësimit institucional, i cili kontribuon në zhvillimin profesional të stafit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike. Vlerësimet realizohen periodikisht, përmes analizave vjetore, raporteve të vetëvlerësimit dhe feedback-ut të studentëve, dhe diskutohen në mënyrë të strukturuar në nivel departamenti, duke garantuar reflektim të plotë mbi objektivat strategjike të

	institucionit dhe përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë. Shtojca- 1.5. Rregullore per funksionimin e NJSBC
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Departamenti i Historisë në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, funksionon në përputhje me strukturat dhe mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë që ka ngritur institucioni. Fakulteti ka emëruar persona përgjegjës për çdo departament, të cilët luajnë rol kyç në koordinimin e proceseve të sigurimit të cilësisë së mësimdhënies, vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit. Këta koordinatorë punojnë në bashkëpunim të ngushtë me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në fakultet dhe me strukturat qendrore të UT, duke ndjekur një kalendar të mirëpërcaktuar vjetor për monitorimin e performancës, përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit, organizimin e anketave për studentët dhe vlerësimin e stafit akademik. Proceset për matjen e treguesve të performancës, analizën e rezultateve dhe hartimin e rekomandimeve për përmirësim janë të përshkruara në Manualin e Cilësisë së UT, dhe në dokumentacionin përkatës të fakultetit. Kjo strukturë organizative garanton mbështetje për zhvillimin profesional të stafit akademik dhe për forcimin e cilësisë akademike të programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Historisë.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Departamenti i Historisë në UT funksionon në kuadër të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë së Universitetit, i cili përfshin një paketë të miratuar mekanizmash, dokumentesh rregullatore dhe instrumentesh vlerësimi. Manuali i Cilësisë, i hartuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), është dokumenti themelor që udhëzon proceset e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit në të gjitha ciklet e studimit. Ky sistem bazohet në analiza të rregullta të pyetësorëve të shpërndarë për studentët mbi lëndët, metodologjitë mësimore, kërkimin shkencor dhe kontributin institucional të stafit akademik. Departamenti angazhohet në hartimin e planeve vjetore për përmirësimin e cilësisë, bazuar në këto të dhëna dhe në rekomandimet e marra nga proceset e jashtme të akreditimit. UT ka miratuar një paketë të veçantë për sigurimin e cilësisë, që përfshin jo vetëm vlerësimin e mësimdhënies, por edhe të

	kërkimit shkencor dhe ndikimit institucional të stafit akademik. NJSBC, në bashkëpunim me strukturat e departamentit dhe fakultetit, monitoron zbatimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë dhe siguron përputhshmëri me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë në UT, përmes strukturave të veta përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, harton analiza dhe raporte të rregullta mbi ecurinë akademike dhe institucionale, duke përfshirë vlerësimin periodik të pedagogëve. Këto raporte përmbledhen në Raportin Vjetor të Vlerësimit të Brendshëm, i cili evidenton arritjet gjatë vitit akademik dhe identifikon hapësirat për përmirësim. Për të rritur standardet e cilësisë, stafi akademik i Fakultetit, përveç detyrimeve mësimore, angazhohet në kërkimin shkencor, pjesëmarrjen në njësi akademike, forume shkencore dhe projekte bashkëpunimi ndërkombëtar, si programi Erasmus+. Kjo mbështetje është veçanërisht e rëndësishme për pedagogët e rinj, të cilët inkurajohen dhe ndihmohen për të marrë pjesë në konferenca dhe aktivitete akademike, duke kontribuar kështu në zhvillimin profesional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së institucionit.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës ka zhvilluar dhe zbatuar politika dhe procedura të qarta për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. Këto përfshijnë përdorimin e metodave të ndryshme të monitorimit, si anketat e studentëve për vlerësimin e përvojës mësimore, vlerësimet periodike të performancës së pedagogëve dhe sondazhet e zhvilluara me punëdhënës potencialë të të diplomuarve.</i> <i>Rezultatet e këtyre proceseve përpunohen në raporte të strukturuar dhe përdoren për të identifikuar pikat e forta dhe dobësitë në procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. Në vijim, hartohen masa konkrete për përmirësim të cilësisë, të cilat synojnë rritjen e efektivitetit të programeve të studimit dhe përputhshmërinë e tyre me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet akademike bashkëkohore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Ab.
[Signature]

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ konstaton se Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës përdor procese të formalizuara dhe të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit të ciklit të dytë. Këto përfshijnë vlerësimet e kryera nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), në bashkëpunim me grupet përkatëse të vlerësimit, të cilat analizojnë elementet kryesore të programit, si struktura kurrikulare, rezultatet e të nxënit, përputhshmëria me nevojat e tregut të punës dhe përfshirja e praktikave të mira akademike. Procesi vlerësues mbështetet gjithashtu mbi feedback-un e studentëve dhe të diplomuarve, të mbledhur përmes pyetësorëve periodikë. Rezultatet përmbledhen në Raportet e Vetëvlerësimit dhe Raportet Vjetore të Cilësisë, të cilat përfshijnë rekomandime dhe plane konkrete veprimi, të cilat i përcillen strukturave vendimmarrëse si Dekanati dhe Senati. Këto dokumente publikohen përmes kanaleve zyrtare, duke garantuar transparencë dhe promovuar përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstaton se në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë (FHF) të Universitetit të Tiranës janë të ngritura mekanizma funksionalë për hartimin dhe analizimin e raporteve vjetore mbi proceset e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit shkencor. Këto raporte përfshijnë vlerësimin e performancës së stafit akademik, analizën e arritjeve dhe problematikave, si dhe masat përkatëse për përmirësim. Raportet vjetore përmbajnë gjithashtu pjesë të dedikuara për identifikimin dhe promovimin e praktikave të mira, duke nxjerrë në pah sukseset individuale dhe kolektive të stafit dhe studentëve. Në përmbajtjen e tyre përfshihet edhe një parashikim i objektivave për vitin akademik pasues, duke u fokusuar në rritjen e cilësisë dhe të performancës. Në FHF, procesi i monitorimit të cilësisë realizohet përmes:

	1. Komisionit të përhershëm për sigurimin e cilësisë; 2. Koordinatorëve të programeve të studimit që bëjnë monitorim të vazhdueshëm; 3. Komisioneve të ngritura nga NJSBC në bashkëpunim me Dekanatin; 4. Drejtuesve të programeve të studimit, që analizojnë dhe mbikëqyrin proceset përkatëse. Ky sistem i shumëfishtë monitorimi ndihmon në sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë, në përmirësimin e praktikave akademike dhe në ndërtimin e një kulture reflektimi dhe përmirësimi institucional.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ vlerëson se Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës përdor një shumësi mekanizmesh për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të programeve të studimit. Këta mekanizma përfshijnë vlerësime nga studentët, kolegët, alumni dhe partnerë të jashtëm, me qëllim identifikimin e dobësive dhe promovimin e praktikave të mira. Në FHF, vlerësimi i procesit të mësimdhënies realizohet në disa mënyra: 1. Testime të standardizuara që matin njohuritë dhe përparimin e studentëve; 2. Degjime në auditorë gjatë leksioneve dhe seminareve, për të vëzhguar ndërveprimin dhe cilësinë e ligjërimit; 3. Vlerësime të performancës së studentëve gjatë angazhimeve individuale; 4. Matja e rezultateve përmes sistemit të pikëve dhe notimit; 5. Analizë e rezultateve të detyrave individuale dhe projekteve të zhvilluara nga studentët; 6. Vëzhgim aktiv i studentëve gjatë përmbushjes së detyrave praktike apo kërkimore; 7. Përpunimi i rezultateve të arritura dhe përfshirja e tyre në vlerësimin përfundimtar. Gjithashtu, syllabuset e programeve rishikohen periodikisht, duke marrë parasysh edhe opinionet e studentëve. Organizimi i

	seminareve dhe trajnimeve akademike ndihmon në rritjen e kapaciteteve të stafit dhe cilësisë së mësimdhënies. Koordinatori i Programit dhe Zyra e Karrierës luajnë një rol mbështetës të rëndësishëm, duke krijuar ura lidhëse midis mësimdhënies, zhvillimit personal dhe përgatitjes për tregun e punës. Kjo strukturë mbështetëse ndihmon në integrimin e politikave të cilësisë me nevojat dhe zhvillimin e studentëve.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	GVJ vlerëson se Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës ka ndërtuar dhe zbatuar një proces të strukturuar dhe të dokumentuar për sigurimin dhe vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, përfshirë edhe programet e ciklit të dytë. Këto procese bazohen në instrumente të ndryshme vlerësimi dhe monitorimi që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike. Në FHF përdoren metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta vlerësimi, si: • Sondazhe të strukturuar për studentët e ciklit të parë dhe të dytë, të cilat vlerësojnë performancën e stafit akademik në disa dimensione; ○ Përmbajtja e lëndës; ○ Metodologjia e mësimdhënies; ○ Organizimi dhe drejtimi i mësimdhënies; ○ Lidhja e teorisë me praktikën; ○ Integrimi i mësimin me kërkimin shkencor; ○ Përdorimi i teknologjisë në procesin mësimor; ○ Komunikimi me studentët; ○ Sistemi i vlerësimit të studentëve; ○ Kompetenca dhe profesionalizmi i stafit. • Formulari i Vlerësimit të Performancës së Stafit Akademik, i cili përdoret për të matur aspektet kryesore të cilësisë në mësimdhënie, si dhe për të identifikuar nevojat për trajnime apo përmirësim të mëtejshëm. • Intervista me studentët dhe përfaqësuesit e personelit akademik, të cilat shërbejnë si mjet për të grumbulluar komente cilësore, sugjerime dhe shqetësime lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe përmbajtjen e programeve. • Sistemi i gjurmimit të alumnit dhe anketat me punëdhënësit, për të siguruar informacion mbi përshtatshmërinë e kurrikulave me nevojat e tregut të

	punës dhe ndikimin e studimeve në zhvillimin profesional të të diplomuarve. Të gjitha të dhënat e mbledhura përpunohen dhe inkorporohen në Raportet e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilat përfshihen në raportet vjetore të fakultetit dhe shërbejnë si bazë për planifikimin strategjik dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Shtojca- 2.10.1. Raporti i Vlerësimit të performances së personelit akademik			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës realizon monitorimin dhe vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit përmes Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) dhe strukturave të tjera të brendshme. Ky proces përfshin aktivisht aktorët e brendshëm, si stafi akademik, studentët dhe drejtuesit e programeve, si dhe merr parasysh mendimet e aktorëve të jashtëm, përfshirë alumnin dhe përfaqësues të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë (FHF) në Universitetin e Tiranës siguron përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në procesin e sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë së programeve të studimit, përmes strukturave të mirëorganizuar dhe procedurave të përputhshme me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe objektivat e Planit Strategjik të Zhvillimit të Universitetit të Tiranës. Në FHF, procesi i sigurimit të cilësisë realizohet nëpërmjet: Komisioneve të brendshme për sigurimin e cilësisë, të ngritura për çdo program studimi dhe të mbështetura nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC);

	• Bashkëpunimit me ekspertë të jashtëm, përfshirë përfaqësues të tregut të punës, alumnë dhe përfaqësues nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), për të garantuar integritimin e standardeve të jashtme dhe përshtatjen e kurrikulave me kërkesat aktuale të tregut; • Përdorimit të mjeteve të përcaktuara në Manualin e Cilësisë të UT, për të siguruar ndjekjen e procedurave dhe angazhimin efektiv të burimeve njerëzore në vlerësim dhe përmirësim. FHF i kushton rëndësi të veçantë ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë akademike, duke reflektuar rekomandimet e auditimeve të brendshme dhe të jashtme dhe duke i inkorporuar ato në proceset vendimmarrëse të fakultetit. Shtojca-1.9. Manuali i cilesise.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (FHF), janë përcaktuar qartë strukturat organizative, të drejtat dhe detyrimet e njësive, individëve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës dhe rregulloret përkatëse. Në këtë kontekst, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) në FHF: • Garanton organizimin dhe zbatimin e proceseve të sigurimit të cilësisë përmes komisioneve të brendshme të ngritura nga Dekanati, të cilat gëzojnë një autonomi funksionale në hartimin dhe ndjekjen e aktiviteteve vlerësuese; • Përfshin gjithashtu një Komision të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, i cili mbikëqyr zbatimin e standardeve të cilësisë, koordinon proceset e vlerësimit dhe jep rekomandime për përmirësim të vazhdueshme; • Mbështet rregullisht kontrollin periodik të kurrikulave, syllabuseve dhe praktikave mësimore në të gjitha programet e studimit; • Promovon ndërveprimin me lektorë të jashtëm dhe organizimin e orëve të hapura, për të rritur ndërveprimin akademik dhe qasjen kritike;

	• Angazhohet në përmirësimin e treguesve të performancës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe përputhjen me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin shkencor. Shtojca-1.5. Rregullore për funksionimin e NjSBC
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (FHF), janë përcaktuar qartë strukturat organizative, të drejtat dhe detyrimet e njësive, individëve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës dhe rregulloret përkatëse. Në këtë kuadër, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë luan një rol qendror në monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në FHF. Ky komision angazhohet në hartimin dhe zbatimin e mekanizmave të brendshëm të cilësisë, në përputhje me udhëzimet institucionale dhe rekomandimet e agjencive përkatëse, duke garantuar përmirësim të vazhdueshëm dhe përputhshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë (FHF), Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë përbëhet nga anëtarë që karakterizohen nga integriteti, pavarësia, objektiviteti, profesionalizmi dhe aftësia për të komunikuar dhe informuar në mënyrë të qartë dhe efektive. Këta anëtarë përzgjidhen me kujdes nga organet drejtuese akademike, duke përfaqësuar në mënyrë të drejtë dhe të balancuar njësitë përbërëse të fakultetit, përfshirë edhe përfaqësues nga studentët. Puna e Komisionit zhvillohet në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës, Kodit të Etikës dhe legjislacionit kombëtar për arsimin e lartë, duke garantuar ndershmëri, mosdiskriminim dhe përkushtim ndaj standardeve të cilësisë. Veprimtaria e Komisionit bazohet në pesë shtylla themelore: • Integriteti në çdo proces vlerësimi; • Pavarësia dhe objektiviteti në marrjen e vendimeve; • Profesionalizmi në analizën dhe raportimin e cilësisë;

	• Komunikimi dhe informimi i vazhdueshëm me aktorët e përfshirë; • Përfaqësimi gjithëpërfshirës i njësive akademike dhe studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (FHF), në kuadër të proceseve të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit, janë përfshirë edhe ekspertë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilët kontribuojnë me njohuritë dhe përvojën e tyre. Këta ekspertë – që mund të jenë akademikë, drejtues institucionesh arsimore, ose përfaqësues të sektorit privat – japin sugjerime të vlefshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përputhjen e programeve me kërkesat e tregut të punës. Pjesëmarrja e tyre siguron një perspektivë të jashtme dhe të paanshme në vlerësimin e performancës akademike. FHF bashkëpunon gjithashtu me universitete partnere brenda dhe jashtë vendit, me të cilat ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Në kuadër të këtyre marrëdhënieve, ekspertë të jashtëm nga këto institucione janë angazhuar në vlerësime, rishikime kurrikulare dhe procese trajnimi, në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2022–2027. Kjo qasje ndërinstitutionale dhe ndërkombëtare forcon praktikatat e brendshme të cilësisë dhe nxit shkëmbimin e përvojave në drejtim të standardeve të arsimit të lartë.
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë (FHF) në Universitetin e Tiranës përdor një sërë mekanizmesh për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike, duke përfshirë njësitë akademike, personelin mësimdhënës, studentët, alumnin si dhe partnerë institucionalë publikë dhe privatë. Përmes aktiviteteve të vazhdueshme si leksionet e hapura me përfaqësues të institucioneve të trashëgimisë kulturore, studiues të fushës, si dhe bashkëpunimeve me institucione kërkimore, arsimore dhe mediatike, FHF angazhon ekspertë të jashtëm dhe bashkëpunëtorë për të kontribuar në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Këto forma bashkëpunimi, të mbështetura edhe në marrëveshje formale me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit,</i>

	<i>ndihmojnë në përafrimin e ofertës akademike me zhvillimet bashkëkohore dhe kërkesat e tregut të punës, si dhe në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përgatitjes profesionale të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ vlerëson se politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Universitetin e Tiranës, përfshirë Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, janë të dokumentuara qartë dhe të strukturuar sipas kërkesave të kuadrit ligjor dhe strategjik. Bazat e këtij sistemi përcaktohen në Statutin e UT, në Rregulloren e brendshme, në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, si dhe në Planin Strategjik të institucionit. Këto dokumente ofrojnë një kornizë të qartë për funksionimin e strukturave përgjegjëse për cilësinë dhe janë lehtësisht të aksesueshme për të gjitha palët e interesuara. Universiteti i Tiranës garanton transparencë të plotë duke i publikuar këto dokumente në faqen zyrtare të internetit të institucionit, duke i bërë të disponueshme për studentët, personelin akademik dhe partnerët institucionalë. Kjo praktikë ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së komunitetit universitar në proceset e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë. Shtojca-2.17.3. Raport vjetor i Departamentit të Historisë 2023-2024
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën	GVJ vlerëson se në Universitetin e Tiranës, përfshirë Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, procesi i vlerësimit të pedagogëve nga studentët realizohet në mënyrë të strukturuar dhe transparente, në përputhje me rregulloren e brendshme të institucionit. Të dhënat e mbledhura nga vlerësimet përpunohen

akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe shpërndahen në mënyrë elektronike tek njësitë përkatëse akademike – departamentet dhe dekanati. Komentet dhe rezultatet e vlerësimeve u dërgohen më pas individualisht pedagogëve, duke respektuar parimin e konfidencialitetit. Gjithashtu, në UT hartohen dhe publikohen raporte të përmbledhura të rezultateve të vlerësimit të programeve të studimit, si në version elektronik, ashtu edhe në formë fizike (hard copy), në përputhje me dispozitat e rregullores së institucionit, duke garantuar aksesin e gjerë dhe transparencën ndaj palëve të interesuara. Shtojca-2.17.3. Raport vjetor i Departamentit të Historisë 2023-2024
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Departamenti i Historisë, rezultatet e vlerësimeve të kryera për programin e studimit i pasqyron në Raportin Vjetor të Fakultetit dhe Departamentit. Këto rezultate shoqërohen me një plan veprimi, i cili synon adresimin e gjetjeve të evidentuara gjatë procesit të vlerësimit. Plani përfshin masa konkrete për përmirësimin e cilësisë akademike, zhvillimin e mëtejshëm të përmbajtjes mësimore, forcimin e komponentit të kërkimit shkencor dhe rritjen e mbështetjes për studentët. Rekomandimet që dalin nga ky proces janë të fokusuar në përmbushjen e misionit dhe vizionit të programit të studimit, dhe shërbejnë si udhërrëfyes për strukturat përgjegjëse në Departamentin e Historisë për ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për përmirësim të vazhdueshëm.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Raportet vjetore të përgatitura nga strukturat përkatëse në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë (FHF) pasqyrojnë aktivitetet e ndërmarra për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Raporti Vjetor i Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ofron një panoramë të qartë mbi realizimin e objektivave, progresin në përmbushjen e standardeve akademike, si dhe mbi identifikimin e mangësive. Këto të dhëna përpunohen dhe shërbejnë si bazë për hartimin e masave konkrete për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe mbështetje për studentët.

	Në Universitetin e Tiranës, përveç Raporteve Vjetore, një burim tjetër i rëndësishëm që merret parasysh në procesin e vlerësimit dhe planifikimit strategjik janë rekomandimet e dhëna gjatë procesit të akreditimit, të cilat ndihmojnë në përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programeve. Shtojca-2.17.3. Raport vjetor i Departamentit të Historisë 2023-2024			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, veçanërisht në Departamentin e Historisë, organizohen veprimtari periodike me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe studentëve mbi rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit. Këto aktivitete përfshijnë takime të rregullta, diskutime akademike dhe prezantime, të cilat fokusohen në vlerësimin e ecurisë së programeve dhe në mbledhjen e sugjerimeve për përmirësim. Komunikimi i hapur dhe bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet stafit dhe studentëve janë thelbësorë për garantimin e një procesi të vazhdueshëm të përmirësimit të cilësisë. Në këto veprimtari përfshihen edhe analiza të thelluara të komenteve dhe sugjerimeve që dalin nga vlerësimet periodike, të cilat më pas integrohen në politikat dhe praktikën e monitorimit dhe zhvillimit të programeve.			
Konkluzione	<i>Në Departamentin e Historisë të Universitetit të Tiranës, politikat, proceset dhe aktivitetet e realizuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit janë të dokumentuara, të publikuara dhe transparente. Këto elemente garantojnë një implementim efektiv të standardeve të cilësisë, duke u bërë të aksesueshme për të gjithë aktorët e përfshirë: studentët, stafin akademik dhe publikun e gjerë. Përmes dokumenteve zyrtare, raporteve periodike dhe faqeve informuese të institucionit, sigurohet transparenca në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

AB.
[Signature]

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

AB.


Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Histori” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti i Tiranës

Pikat e forta dhe afirmime

- ✓ Programi reflekton në mënyrë të plotë misionin dhe strategjitë e Universitetit të Tiranës dhe kërkesat e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, duke siguruar integrimin e vlerave kombëtare dhe standardeve europiane në strukturën akademike.
- ✓ Stafi akademik përbëhet nga profesorë të kualifikuar në fushat përkatëse të studimit, të cilët kombinojnë përvojën e gjatë në mësimdhënie me një portofol kërkimor të pasur, duke garantuar nivel të lartë të vazhdueshëm të cilësisë akademike.
- ✓ Programi zbatohet nën mbikëqyrjen e Komisionit të Cilësisë dhe Njësisë Qendrore për Sigurimin e Cilësisë, si dhe përmes koordinimit të rregullt me koordinatorët e programit. Këta mekanizma ofrojnë monitorim të pandërprerë të procesit mësimor, infrastrukturës akademike dhe bashkëpunimeve ndërinstitucionale.
- ✓ Bashkëpunimet strategjike me institucione të rëndësishme si: AIDSSH, ISKK, Muzeu Kombëtar ‘Shtëpia me Gjethe’ dhe Arkivi Qendror krijojnë mundësi praktike për studentët, përfshirë praktika profesionale, projekte kërkimore të përbashkëta dhe programe mobiliteti në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
- ✓ Përmes qendrave të avancuara kërkimore ‘History Lab’ dhe ‘Digital Humanities’ dhe përfshirjes aktive në projekte ndërkombëtare, programi nxit zhvillimin e aftësive kritike, metodologjive digjitale dhe inovacionit shkencor te studentët.

Pika të dobta

- Përdorimi i sistemit CleanScore dhe platformave të tjera të vlerësimit elektronik në programin MSC në : “Histori” mund të pasqyrohet më qartë në dokumentacionin zyrtar, duke shtuar të dhëna të strukturuar mbi mënyrën e përdorimit dhe ndikimin e tyre në procesin mësimor dhe vlerësues. (Standardi III.3, Kriteri 2)
- Instrumentet formalë të reflektimit nga studentët; pavarësisht se formularët e vlerësimit të lëndëve apo përvojës mësimore janë të standartizuara në nivel universiteti, programi/ kurrikula mund të përfitojë nga një strukturim më sistematik, për të siguruar një mbledhje më të rregullt dhe të analizueshme të feedback-ut. (Standardi III.3, Kriteri 4)

- Dokumentimi i përfshirjes së studentëve në kërkime shkencore, konferenca apo mobilitete mund të pasurohet me të dhëna më konkrete dhe të detajuara, për të pasqyruar më qartë shkallën e pjesëmarrjes dhe ndikimin e aktiviteteve në zhvillimin akademik të tyre. (Standardi II.6, Kriteri 3)
- Shpërndarja e informacionit mbi rezultatet e vetëvlerësimeve apo monitorimeve të brendshme mund të rregullohet në mënyrë më të qëndrueshme në nivel departamenti, për të nxitur një përfshirje më të gjerë të stafit në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. (Standardi III.1, Kriteri 5)
- Procesi i hartimit të tezës së diplomës do të fitonte nga hartimi dhe përdorimi i një udhëzuesi metodologjik të detajuar, i cili do të shërbente si orientim i qartë dhe i njëtrajtshëm për studentët dhe mbikëqyrësit gjatë gjithë procesit akademik. (Standardi III.5, Kriteri 1)

Rekomandime

1. Rekomandohet të shqyrtohet mundësia për të forcuar mekanizmat e mbledhjes dhe analizimit të feedback-ut nga studentët.

Krijimi i një strukture të rregullt dhe të dedikuar në nivel programi për grumbullimin periodik të feedback-ut mbi përvojën mësimore mund të ofrojë përfitime të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të programit. Përtej formularëve standard që përdoren në nivel universiteti, përdorimi i instrumenteve plotësuese mund të ndihmojë në sigurimin e të dhënave më të thelluara dhe të dobishme për përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës dhe cilësisë akademike.

2. Rekomandohet të hartohet dhe të vihet në zbatim një udhëzues metodologjik për përgatitjen e tezës së diplomës.

Edhe pse lënda "Shkrim Akademik" ofron njohuri të vlefshme mbi metodologjinë e kërkimit dhe aftësitë e shkrimit, një udhëzues specifik për programin MSH-H mund të shërbejë si mbështetje e mëtejshme për studentët dhe udhëheqësit akademikë. Një material i tillë do të ndihmonte në orientimin e qartë dhe të njëtrajtshëm gjatë gjithë procesit të përgatitjes së tezës, duke lehtësuar punën e të dy palëve dhe duke rritur cilësinë e produktit përfundimtar.

3. Rekomandohet të përmirësohet dokumentimi i pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete akademike.

Përfshirja e studentëve në kërkime, konferenca apo mobilitete është një vlerë e shtuar për zhvillimin e tyre akademik dhe profesional. Mbajtja e një dokumentacioni më të plotë, të organizuar dhe të përditësuar mund të ndihmojë programin të pasqyrojë më qartë shkallën

e përfshirjes dhe ndikimin pozitiv të këtyre përvojave, duke i dhënë gjithashtu më shumë dukshmëri përpjekjeve të vetë studentëve


Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "History" provided by the Higher Education Institution "University of Tirana"

Strengths and affirmations

- ✓ The program fully reflects the mission and strategic objectives of the University of Tirana, as well as the requirements of the Albanian National Qualifications Framework, ensuring the integration of national values and European standards into the academic structure.
- ✓ The academic staff consists of qualified professors in the relevant fields of study, who combine extensive teaching experience with a strong research portfolio, thereby guaranteeing a consistently high level of academic quality.
- ✓ The program is implemented under the supervision of the Faculty Quality Commission and the Central Quality Assurance Unit, and through regular coordination with program coordinators. These mechanisms ensure continuous monitoring of the teaching process, academic infrastructure, and inter-institutional collaborations.
- ✓ Strategic partnerships with key institutions such as AIDSSH, ISKK, the National Museum 'House of Leaves', and the Central State Archive provide students with practical opportunities, including professional internships, joint research projects, and mobility programs at both national and international levels.
- ✓ Through advanced research centers such as the 'History Lab' and 'Digital Humanities', and active participation in international projects, the program fosters the development of students' critical thinking, digital methodologies, and academic innovation.

Weaknesses

- The use of the Clean Score system and other electronic assessment platforms within the MSH-H program could be more clearly reflected in official documentation, by including structured data on their implementation and their impact on the teaching and evaluation process.
- Formal instruments for student reflection, such as course and learning experience evaluation forms, would benefit from a more systematic and standardized structure to ensure consistent and analyzable collection of student feedback.
- The documentation of student participation in research activities, conferences, or mobility programs could be enriched with more specific and detailed data to better reflect the extent of engagement and its impact on students' academic development.
- The dissemination of self-assessment results and internal monitoring findings could be organized more consistently at the departmental level, in order to encourage broader staff involvement in the continuous improvement of quality.



- The thesis development process would benefit from the creation and application of a detailed methodological guide, serving as a clear and consistent reference for both students and supervisors throughout the academic process.

Recommendation

1. It is recommended to develop more structured mechanisms for collecting and analyzing student feedback.

In addition to the standardized university-wide forms, the program could consider introducing complementary tools at the program level. These would support the regular collection of meaningful feedback on the learning experience and help generate useful insights for curriculum improvement and quality enhancement.

2. It is recommended to prepare a dedicated methodological guide for the Master's thesis.

Although the “Academic Writing” course provides a general foundation in research and writing, a tailored guide specific to the MSH-H program could offer additional support. Such a guide would assist both students and supervisors by providing clear, consistent direction throughout all stages of the thesis process.

3. It is recommended to enhance the documentation of student participation in academic activities.

By gathering more detailed and organized information on student involvement in research, conferences, and academic mobility, the program could more clearly demonstrate the value and impact of these experiences on students’ academic and professional development.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

AB.
[Signature]

